




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal

Datë: 15.01.2026

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesueseja e Kuvendit me datë: 15.01.2026 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -I-rë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: **22.01.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.
Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Raportit i punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.
2. Raporti i Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025.
3. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2024.
4. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën Tetor-Dhjetor 2025; (TM4).
5. Të ndryshme.



Arbore BEQIRAJ FERA

Kryesuese e Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIC OF KOSOVO		REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA		KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE			
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS			
SH./Z./S.	02	Nr./B./No.	1383
Nr. llog.	207	Data	15/04
Si. sh.		Drejtim	
No. Pg.		Vite	2026
KAMENICE - KAMENICA			

Raporti i punës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025 (Korrik-Dhjetor)

Hartoi: Zyra e Kryetarit

Shqyrton dhe miraton: Kuvendi Komunal i Kamenicës

Kamenicë, 2025

Grupi punues:

Kryetari i Komunës së Kamenicës-Kadri Rahimaj

Nënkryetari i Komunës së Kamenicës-Faton Jakupi

Zyra e Personelit-U.D.Shuajb Lakna

Zyra Ligjore-U.D.Riad Rahimaj

Zyra e Prokurimit-Urim Thaqi

Zyra e Informimit-Lidiona Marovca, Valdete Berisha

Zyra e Integriteteve Europiane-Zijadin Thaqi

Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme-Arlindë Sejdiu

Drejtoreshë e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet-Ardita Dërnaku

Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit-Afrim Dërvishi

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-Uran Berisha

Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Gretë Kryeziu

Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjence-Zotirum Kastrioti

Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë-Burbuqe Leka

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Shpend Morina

Drejtoreshë e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi-Diana Kryeziu

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Behar Hyseni

Drejtor i Drejtorisë për Investime Kapitale-Blerim Murina

Aktivitetet e Kryetarit:

Ky ka qenë gjashtëmujori i dytë i vitit 2025 si dhe gjashtëmujori i fundit për këtë vit qeverisës. Përgjatë kësaj kohe kemi vazhduar me punë për realizimin e projekteve që kanë qenë në proces dhe gjithnjë duke parë mundësi të reja bashkëpunimi për ide të reja investimesh.

Ky raport paraqet punët e kryera nga kjo qeverisje për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025 (01.07.2025-31.12.2025).

1. Komuna e Kamenicës ka pranuar Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit që është më i miri ndonjëherë, i parrifikuar për pasqyrat financiare,
2. Është nënshkruar marrëveshja me UN Habitat dhe FES për hartimin e Planit të Mobilitetit.
3. Është mbajtur Kamenica Summer Fest, festival me më shumë se 30 aktivitete, që ka bërë bashkë kamenicasit dhe diasporën tonë,
4. Janë angazhuar edhe 19 praktikantë të rinj me pagesë në Komunën e Kamenicës,
5. Do të bëhet rinovimi i stadiumi i qytetit në bashkëpunim me MKRS-në,
6. Për herë të parë, në Kamenicë është mbajtur Dita e Nderit, ku janë nderuar figurat kryesore me kontribut të jashtëzakonshëm për të mirën publike të qytetit tonë,
7. “Kamenica në rrjedha të historisë” është libri me punime shkencore që janë frytë të konferencës së parë shkencore të mbajtur në Kamenicë,
8. Ka përfunduar asfaltimi i 11 rrugëve në fshatin Hogosht (Në vlerë prej 228,893.92 eurosh janë përfunduar së asfaltuari 1947.33 metra infrastrukturë rrugore),
9. Janë asfaltuar edhe 8 rrugë në Karaçevën e Poshtme (Janë asfaltuar edhe 1382 m gjatësi rrugore në Karaçevë të Poshtme në vlerë prej 90,481 eurosh),
10. Janë asfaltuar 11 rrugë në Karaçevën e Epërme (Shuma: 88,555.03 euro),
11. Në vlerë prej 11,890.90 €, këtë vit kemi shpërndarë 23 artikuj të ndryshëm me gjithsej 8,714 materiale dhe mjete didaktike për të gjitha shkollat e komunës sonë,
12. Jemi bërë pjesë e rrejtit botëror Mayors for Peace! (Kjo organizatë globale, me mbi 8,400 qytete anëtare nga 166 shtete dhe rajone, ka për mision ndërtimin e një bote pa armë bërthamore, forcimin e solidaritetit ndërgjyetas dhe promovimin e paqes e zhvillimit të qëndrueshëm),
13. Parku i Aventurave tek Lugu i Verdhë (Shuma: 299,487.00 euro),
14. Shtresa e dytë e asfaltit në Ferigevë:
 1. Rruga "Rruga e fushave" me gjatësi prej 914,16 m,
 2. Rruga "Bejtë Pireva" me gjatësi prej 1846.25 m

Totali i investimit në këto dy rrugë kap shifën e 860,387 eurosh.

15. Është vendosur sinjalistika në qytet në vlerë prej 100,000 eurosh,

16. Janë blerë lodra të reja për të gjithë parashkollorët si dhe të vegjëlit në qerndhe, në vlerë prej 9400 eurosh, me standarde europiane dhe të përshatshme për ta,

17. Parkingu i shkollës “Dëshmorët e Kombit” në Kamenicë (Shuma: 23,277.60 euro),

18. Lumi në Kopërnice do të kthehet në atrakcion për qytetarë (Një projekt në vlerë prej 288,000 eurosh),

19. Kamenica me autoambulancë të re falë bashkëpunimit të Ministrisë Arben Vitia,

20. Kemi nënshkruar marrëveshjen për dhënie në shfrytëzim të vendgjahshites me NPL “Dardana”,

21. Me mbi 750,000.00€ investim po asfaltohen rrugët lokale në Krilevë,

22. 154 përfutues të bursës komunale këtë vit (Gjithsej 154 përfutues e prej tyre 101 vajza dhe 53 djem, një buxhet i ndarë prej 53,400 eurosh për studentët),

23. Komuna e Kamenicës ka shpërblyer nxënësit më të dalluar,

24. Në proces është asfaltimi i 17 rrugëve në Topanicë (347,314,33 euro),

25. Në proces është asfaltimi i rrugëve në lagjen “Malësia” në Qytet (171,720.73 euro),

26. Për vitin 2026 kemi miratuar buxhetin prej 15,606,103 €, buxheti më i madh ndonjëherë dhe 2 milionë euro janë të destinuara për investime kapitale.

27. Drejtimi i kulinarisë i është shtuar IAAP “Andrea Dursaku”.

28. Të gjitha shkollat në Kamenicë kanë sistem vijeshmërie si dhe kamera sigurie,

29. Kemi përmirësuar qerndhen e re në Koretin në vlerë prej 741,000 eurosh,

30. Kemi përmirësuar Kuzhinën Popullore në vlerë prej 500,000 eurosh,

31. Po bëhen përgatitjet e fundit për mësimin gjithëditor,

32. Asfaltimi i dy rrugëve të tjera në Koretin

Rruga “Kallaba” 132m

Rruga “Usharët e UÇKsë” degëzim 83 m

Shuma: 27,867.62 euro

33. Trotuari në Kopërnice e rrethi i ndriçimit publik

34. Rrugët në Muçiverc

Rruga "Ismajl Hashani" 13,988.94€

Rruga "Can Bojku" 17,237.85€

Rruga "Ban Boku" 11,966.07€

Rruga "Hasan Nuhë Spahiu Deg. I" 10,236.15€

Rruga "Rexhep Hashani" 14,152.16€

Rruga "Veteranet e Aismt Degezimi 2" 2,458.10€

Rruga "Hoxhe Hasan Masurica Deg. I" 16,210.03€

Rruga "Hoxhe Hasan Masurica Deg. II" 8,536.40€

Rruga "Alush Spahiu Deg" 4,326.70€

Rruga "Hoxhe Hasan Masurica Deg. 3" 12,391.14€

35. Rrugët në Dajkoc

Rruga "Sylë Ramë Dajkovei" 68,751.81 euro

Rruga "Sylë Ramë Dajkoci" degëzim I 10,658.80€

36. Rruga "Tema" në Busavatë

225.18m

52,326.01€

37. Rrugët në Roganë

Rruga e Dijes deg.1 (L=64m) 8637.10€

Rruga e Dijes deg.2 (L=19m) 3271.86€

Rruga e Dijes deg.3 (L=8m) 10507.60

Rruga "Haxhi Nuhiu" (L=118m) 13291.00€

Rruga "Selver Kryeziu" (L=110m) 7463.00€

- Rruga "Selver Kryeziu" deg.2 (L=45.90m) 4958.11€
- Rruga "Selver Kryeziu" deg.3 (L=48.91m) 5058.94€
- Rruga "Selman Trena" deg.1 (L=24.10m)
2288.69€
- Rruga "Banimi i ri" deg.1 (L=138.60m) 17935.92€
- Rruga "Mergimari" deg.1 (L=85.30m) 10668.40€
- Rruga "Mergimari" deg.2 (L=89.45m) 4244.15€
- Rruga "Selver Kryeziu" deg.6 (L=75.72m) 10067.98€
38. Parkingu i AMF-së në Roganë (L=40m) 7800€
39. Për herë të parë në Kamenicë, Kryesuesja e Kuvendit Komunal është zgjedhur një grua, Arbnore Beqiraj.

Zyra e Informimit:

Zyra e Informimit e cila është pjesë e Zyrës së Kryetarit, gjatë vitit 2025 ka funksionuar sipas Planit të Punës për vitin 2025.

Si fillim vit i vështirë ka qenë kalimi nga ueb-faqja e vjetër në ueb-faqen e re të Komunës, ku shumë dokumente mungonin e kjo si pasojë e migrimit të dokumenteve nga kompani të angazhuara nga niveli qendror.

Pavarësisht kësaj Zyra e Informimit ka vazhduar plasimin e dokumenteve edhe në ueb-faqen e re por edhe në Facebook-un zyrtar të komunës në mënyrë që qytetarët të mos mbesin të painformuar.

Janë ndjekur të gjitha takimet e parapara në Agjendën e Kryetarit e po ashtu edhe të drejtorive sipas rëndësisë, ku nga ato takime janë publikuar lajme dhe informata të rëndësishme për qytetarët.

Janë organizuar konsultimet publike lidhur me aktet dhe Draft-Dokumentet e rëndësishme. Janë publikuar njoftime për konkurse, shpallje, thirrje publike dhe rezultate nga këto. Janë publikuar vendime të kryetarit, materiale për thirrje të seancave të Kuvendit, KPF-së, Komitetit për Komunitete, KKS-së, vendime të Kuvendit, Rregullore, Kontrata të Prokurimit, dhe të tjera.

Zyra e Informimit është e përkushtuar çdoherë në plasimin e informatave dhe gëshjive të tjera, në mënyrë që të ketë transparencë të plotë dhe që qytetarët të jenë të njoftuar për çdo aktivitet.

Të Dhënat Lidhur me Publikimin e Vendimeve/Kontratave

Tabela nr. 1

Drejtoritë/Zyret	Publikimet
Zyra e Kryetarit	219 Vendime 16 Njoftime për Diskutim Publik 14 Raporte dhe procesverbale nga këto diskutime publike 451 Lajme dhe Informata të publikuara në ueb-faqen zyrtare dhe në Facebook-un zyrtar të Komunës së Kamenicës
Zyra e Prokurimit	21 Kontrata të nënshkruara

Kuvendi	14 publikime bashkangjijte të Materialeve të Kuvendit (Thirrje, Propozim vendime, procesverbale) 10 bashkangjijte të vendimeve 7 Draft-dokumente
Zyra e Personelit	69 Konkurse, 226 Shpallje, Njoftime per publikim te rezultateve te konkurseve, shpalljeve, listave, subvencioneve etj.

Kërkesat për Qasje

Tabela nr. 3

Kërkesat e paraqitura	Numri	Kthimi i Përgjigjeve
Gjithsej	36	36
Me postë elektronike	22	
Kopje fizike	14	
Postë elektronike dhe kopje		
Verbalisht		

Zyra e Integrimave Europiane:

I. Aktivitetet e rregullta të Zyrës Komunale për Integrim Evropiane

- Zyra Komunale për Integrim Evropiane ka staf: Zijadin Thaçi – Udhëheqës i Zyrës.
- Siguruar implementimin e PVMISA-së për veprimet që ndërliken me Komunën dhe raportuar sipas kërkesave të MAPL-së.
- Koordinuar aktivitetet e Komunës që lidhen me implementimin e PVMISA-së.
- Mbikëqyrë aktivitetet e institucioneve komunale që burojnë nga PVMISA, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës.

- Mblidëqyrëm hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar përputhshmërinë me standardet evropiane.
- Raportuam te Kryetari i Komunës për aktivitetet e drejtorive për periudhën 6-mujore përmes raportit-matricës.
- Përgatitëm materiale të nevojshme për çështjet që lidhen me integritet evropiane.
- Hulumtuam programe të ndryshme të asistencës së BE-së që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal.
- Ofnuam këshilla lidhur me çështjet evropiane sipas nevojave të Komunës.
- Bashkëpunuam me Zyrtën për Integritet Evropiane në MAPL dhe me Agjencionin për Integritet Evropiane në çështjet e përafërimit të legjislacionit me atë të BE-së.
- Monitoruam punën e Kuvendit Komunal, Komiteteve dhe morëm pjesë në diskutime publike.
- Ishim anëtar i komisionit për hartimin e planit për transport urban.

II. Detyra dhe angazhime shitesë me urdhëresë të Kryetarit të Komunës

- Zyrtar kryesor ndërlidhës për deklarimin e pasurisë në Agjencionin Antikorrupsion.
- Anëtar i Komisionit për Ankesa – shkalla e dytë për Inspeksion, Planifikim Hapësinor dhe Ndërlime pa Leje (në vazhdimësi).
- Zyrtar ndërlidhës mes Komunës dhe Agjencionit Antikorrupsion për konflikt interesi.
- Zyrtar ndërlidhës mes Komunës dhe Agjencionit Antikorrupsion për deklarimin e pasurisë.
- Zyrtar ndërlidhës për çështjen e dhuratave në raport me Agjencionin Antikorrupsion.
- Zyrtar përgjegjës për Zbatimin dhe Monitorimin e Planit të Integritetit.
- Anëtar i Komisionit për hartimin e planit për banim social.
- Anëtar i Komisionit për Riintegrim dhe personat e kthyer nga jashtë.

- Pjesëmarrje në disa komisione për rekrutim.
- Takime me Kolegjin e Zyrtarëve Komunalë për Integritime Evropiane për hartimin e matricës së PVMSA-së.
- Takime me Kolegjin për Diasporë në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- Përgatitja e raportit të “Planit Gjithpërfshirës të Komunave, Qershor–Dhjetor 2025”, për MAPL.
- Kryerja e shumë punëve, këshillimeve dhe rekomandimeve shesë sipas nevojave të Komunës, brenda dhe jashtë saj, në nivel regional dhe qendror.
- Marrëveshja mes Komunës së Kamenicës dhe Mitrovicës së Veriut (koordinator) për rikonstruktimin dhe rekrutimin e personelit, zyrtarëve dhe pozitave udhëheqëse në periudhë dyvjeçare, me përfundim të misionit pas zgjedhjeve lokale.

III. Trajnimet, seminarët dhe punëtoritë e ndjekura

Gjatë kësaj periudhe kam ndjekur këto aktivitete profesionale:

- Themelimi i Kolegjiut për Diasporë.
- Hartimi i planit për Riintegrim, azil dhe refugjatë, si dhe testet psiko-sociale.
- Trajnimet për marrëveshje ndërkomunale, ndërkombëtare dhe binjakëzim etj.
- Iniciativë e Zyrës së Kryeministrit dhe Zyrës Lokale për Integritime Evropiane për themelimin dhe trajnimin e një ekipi të specializuar për analizimin, shkrimin dhe hartimin e projekteve të Komisionit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare, në koordinim dhe me miratimin e Kryetarit të Komunës, për përfundimin e fondeve të BE-së për Komunën e Kamenicës.
- Punëtori në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Konferencë me shefin e zyrës së BE-së në Prishtinë dhe me grupin punues të Kosovës për rrugëtim drejt BE-së.

IV. Konkluzione

Punët e Zyrës Komunale për Integritime Evropiane vazhdojnë në kontinuitet, me fokus në forcimin e proceseve integrituese dhe zbatimin e standardeve evropiane në nivel lokal.

V.Rekomandime

Pasi që zyrtari për Integritime Evropiane është pensionuar të plotësohet vendi vakant me një kuadër profesional në fushën e Integritimeve.

Të fuqizohet bashkëpunimi edhe më tej me Drejtori dhe sektorë në dhënien e informacioneve për PVMS dhe Monitorimin dhe zbatimin e planit të Integritetit.

Zyra e Personelit:

Ky raport përqendret punën e NJMBNJ-së për periudhën (6) mujore, Qershor-Dhjetor 2025. Raporti përmbledhë të gjitha aktiviteteve të Njësise për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u përfshirë në punët dhe detyrat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së NJMBNJ-së të cilat do të paraqiten në mënyrë tabelare.

Per vitin 2025 Komuna e Kamenicës ka këto pozita të autorizuar për Zyrtar Publik, ku përfshihet shërbimi Civil, shërbimi Publik (shëndetësia dhe arsimi), si dhe Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës.

Pozitat e punës sipas sistemit SIMBNJ.

Nr.	Pozita	Njësia	Nr. References
1.	Asistent Administrativ		RN00017984
2.	Zyrtar Ligjor		RN00017985
3.	Zyrtar për Barazime Financiare		RN00017986
4.	Udhëheqës i Njësise për Burime Njerëzore		RN00018033
5.	Zyrtar i lartë për arsimin e mesëm të lartë		RN00018118
6.	Zyrtar për buxhet		RN00018119

Tek kategoria **Sherbimin publik**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet permes sistemit njekohesisht publikimi i konkurseve behet ne eeb faqen zyrtare te komunes.

Nr.	Pozita	Njësia	Nr. References
1	Konkurs për Pranim, Edukatore dhe Motër Edukatore		RN00018129
2	Konkurs për Pranim, Grupi i Arsimit		RN00018132
3	Konkurs për Pranim, Bashkëpunëtor profesional në arsim, Pedagogji dhe Psikologji		RN00018133
4	Konkurs për Pranim, Zyrtar Administrativ në IP		RN00018134
5	Asistent/e për fëmijë me nevoja të veçanta		RN00018167
6	Konkurs për Pranim, Grupi i Arsimit		RN00018197
7	Konkurs për Pranim, Teknik i Radiologjisë		RN00018222
8	Konkurs për Pranim, Zyrtar Administrativ		RN00018320
9	Konkurs për Pranim, Grupi i Arsimit		RN00018329
10	Konkurs për Pranim, Mjek të Përgjithshëm.		RN00018332
11	Konkurs për Pranim, Mjek të Përgjithshëm.		RN00018620
12	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Klarinetit		RN00018742
13	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Pianos (Kohe të caktuar)		RN00018743
14	Konkurs për pranim - Bashkëpunëtor profesional Pedagog/e dhe/apo Psikolog/e.		RN00018807
15	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Violines (Kohe të caktuar)		RN00018869
16	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Flaute (Kohe të caktuar / Zevendësim)		RN00018870
17	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Zyrtar Administrativ		RN00018993
18	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Mësimdhënës/e i/e Violines (Kohe të caktuar)		RN00019056
19	Konkurs për Pranim, Grupi i arsimit - Asistent/e për fëmijë me nevoja të veçanta (Kohe të caktuar)		RN00019067

Tek kategoria **Sherbimi civil (zevendësim/Marrëdhënie kontraktuale)**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet përmes sistemit SMBN/ njëkohsisht publikimi i konkurseve bëhet në ëb faqen zyrtare të komunes:

Nr.			
1.	Zyrtar i lartë për planifikim hapësor – Projekt		RN00018081
2.	Zyrtar i lartë për GIS – Projekt		RN00018082
3.	Zyrtar për regjistrimin e adresave – Projekt		RN00018084
4.	Asistent administrativ		RN00018369
5.	Zyrtar për Ekonomi – Projekt		RN00018367
6.	Zyrtar Administrativ – Projekt		RN00018371
7.	Zyrtar për mbështetje ligjore – Projekt		RN00018368
8.	Asistent administrativ		RN00018631
9.	Zyrtar për mbështetje ligjore – Projekt		RN00018644
10.	Zyrtar për Ekonomi – Projekt		RN00018645
11.	Asistent administrativ		RN00018646
12.	Zyrtar Administrativ – Projekt		RN00018647
13.	Zyrtar i lartë për planifikim hapësor – Projekt		RN00018725

Tek kategoria **Administrativ/Mbështetës**, procedura e rekrutimit, konkursi hapet përmes sistemit SM(BN) njëkohsisht publikimi i konkurseve bëhet në çeb faqen zyrtare te komunes,

Nr.			
1.	Konkurs për Pranim, Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e në IP, Kuzhinierë dhe Punëtor Teknik dhe Mbështetës (Mirëmbajtës dhe Pastues)		RN00018131

Në vazhden e punëve të cilat kanë të bëjnë kryesisht me Zyrën e Njesisë së Burimeve Njerëzore gjatë periudhës 6 muajore janë hartuar aktet si në vijim:

Nr	Emërtimi i Aktit	Të paraqitur në numër
	Vendim për pensionim të nëpunësit shëk	11
	Vendim për pushim të lehonisë	3
	Vendime për kompenzim për Punë Jashtë Orarit në vlerë monetare	5
	Vendime për kompenzim për Punë Jashtë Orarit në ditë pushimi	7
	Vendim për formim të komisionit përzgjedhës	

	34
Vendim lirim nga detyra	17
Vendim per Anullim	4
Vendim per Pushim pa pagese	2
Aktimerim	9
Verifikime paraprake	402
Vendim për aprovim/refuzim aplikacione	1
Kontrata	56
Vendim për plotësim/ndryshim te vendimit	1
Vendim për shfuqizim (të vendimit)	1
Vendim për ndërprerjen e Kontrates së Punës	0
Vendim për Transfer të nëpunësit	1
Vendim për caktim të zyrtarit/delegim i përgjegjësisë	2
Vendim për kthim ne punë (nga pushimi i lehonisë)	1
Konkurse publike	13
Marrëveshje për praktikant	7
Marrëveshje për vëllim të shtuar	1
Transferimi ndër institucional	1
Përgjigje KPMSCHK	1
Lista e pagave (Pranimi, përpunimi, dërgimi) Mujo	6
Vendim për Emërim	4
Vendim për Emërim (ushtrues detyre)	12
Vendim për zëvendësim të përkohshëm	1
Vendim për përjashtim nga procedura	1
Vendim për përjashtim nga procedura përshkak të konfliktit të interesit	1
Vendim për formimin e komisionit të ankesave të nepunësit	1
Vendim për korrigjim të datës konkurruese piano	2
Vendim për transfer të përkohshëm	1
Vendim për lejimin e pushimit pa pagese	1
Vendim për transferim të përhershëm	2
Vendim për ndalesë ne pagë	1
Vendim për korrigjim e pozitës	1
Vendim për sistemin	3
Vendim për ndërprenjen e punës	1
Vendim për lejimin e mjeteve financiare avans për udhëtim jashtë vendit	6
Vendim për kthim ne punë	1

Totali	625
---------------	------------

Gjatë kësaj periudhe dosjet individuale janë përditësuar të dhënat sistemin elektronik në raport me nëpunësit

Si dhe është siguruar që nëpunësit të kenë të gjithë kartela identifikuese (për nëpunësit e rinjë janë siguruar kartelat, ndërsa ato cilët nuk kanë pasur apo e kanë humbur është bërë kërkesa për t'i pajisur), në mënyrë që vijnshëmëria të regjistrohet në sistemin elektronik sipas kartelave identifikuese

Gjithashtu, njësia e burimeve njerzore ka bashkëpunuar me IKAP, dhe organizata tjera lidhur me trajnimet dhe seminarët e organizuar.

Komisionet disiplinore: ka zhvillura procedurat brenda kompetencave lidhur me nepunsi civil dhe shërbimin publik, të cilët kanë bërë shkelje disiplinore.

Zyra Ligjore:

Raporti përfaqëson në formë statistikore shënimet si në vijim:

Raporti statistikor 20 Qershor – 19 Dhjetor 2025		Gjithsej:
Aktivitetet		
Thirrje Publike		0
Kontrata		0
Propozim vendime		6
Grupe Punuese		3
Vendime / Plotësime / Ndryshime / Korigjime / Shfuqizime		18
Vendim Ekipë Menaxhuese		1
Vendim Financiar		19
Vendim Menaxher i Kontratës		62
Vendim Zyrtar Autorizues		22
Vendim për punë shtesë		3
Vendim për Ndryshime në Projekt		2
Vendime të Ndryshime		27

Vendim për Formimin e Komisionit	13
----------------------------------	----

Autorizime	0
Marrëveshje Bashkëpunimi	4
Urdhëresa	4
Person Kontaktues	0
Mbikëqyrës së Kontratës	0
Delegimë	3

Gjithsej:	186
-----------	-----

Nga aktivitetet e hartshënuara po veçojmë disa më të rëndësishme:

- Asistimi në punën e komisioneve të ndryshme.
- Takim pune me drejtor/zzyrtar brenda institucioneve.
- Pjesëmarrja në mbledhjet e kolegjiunit të zyrtarëve ligjor të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
- Opinione ligjore me poste elektronike për ekzekutivin e komunës.

Drejtoria për Investime Kapitale:

AKTIVITETET I PARAPARË	REZULTATET E ARRITURA	KOHA E FILLIMIT	A ËSHTË MBYLLUR AKTIVITETI?	PERSONI/AT PËRGJEGJËS	MBËSHTETJA E NEVOJITUR
Nisja e procedurave të prokurimit për investimet kapitale që janë të planifikuara për muajt Korrik – Dhjetor.	Inicimi i procedurave të prokurimit si dhe projektet e përfunduara.	01.07.2025	PO	Blerim Murina	ZKA, ZP
Inicimi i procedurave të prokurimit: Asfaltimi i rrugëve lokale në Koretin Rendi 2	Është përfunduar kjo procedurë dhe ende është në prokurim në fazën e vlersimit.	14.08.2025	PO	Blerim Murina	ZKA, ZP, DBF.
Inicimi i procedurave të prokurimit: Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm [zbatues/ kryesor], të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për rekonfigurimin dhe renovimin e Stadiumit të qytetit- 'Agush Isufi', në Kamenicë, në përputhje me Kategorinë I të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadimeve, të miratuara nga UEFA.	Është përfunduar kjo procedurë dhe ende është në fazën e tenderimit.	03.09.2025	PO	Blerim Murina	ZKA, ZP, DBF.

Inicimi i procedurave të prokurimit:	Janë përfunduar projektet dhe jemi në fazën përfundimtare të procedurave të tenderimit.	04.09.2025	PO	Blerim Murina	ZKA, DBF.
Ndërtimi i zveshtores në stadiumin e fshatit Shipashnicë e Eperme					
Inicimi i procedurave të prokurimit:	Janë përfunduar projektet dhe jemi në fazën përfundimtare të procedurave të tenderimit.	23.09.2025	PO	Blerim Murina	ZKA, DBF.
Ndërtimi i varrezave në fshatin Hodonoc					
Inicimi i procedurave të prokurimit:	Është përfunduar projekti dhe jemi në fazën përfundimtare të procedurave të tenderimit.	30.10.2025	JO	Blerim Murina	ZKA, DBF.
Hartimi i projekteve					

PËRSHKRIM I SHKURTËR I PUNËS PËRGJATË PERIUDHËS SË RAPORTIMIT

2.1 Në Drejtorinë për Investime K kapitale, menaxherët e kontratave gjatë kësaj periudhe kohore kanë qenë të angazhuar në këto aktivitete:

Menaxhimi-Mbikëqyrja e projekteve të ndërtimit, riparimit të infrastrukturës dhe objekteve tjera publike në tërë territorin e Komunës së Kamenicës, investime nga buxheti Vërtanok, Organizata tjera buxhetore dhe Donatorë të ndryshëm,

Pjesëmarrja në komisionet për vlerësimin e ofertave në zyrën e prokurimit,

Takime me qëllim të informimit rreth projekteve të Investimeve Kapitale etj.

Konsultime të ndryshme me palë etj.

1. SHQYRTIMI I KËRKESAVE TË PALËVE

Në këtë periudhë kohore **Korrik - Dhjetor 2025**, në Drejtorinë për Investime Kapitale janë pranuar gjithësej (97) kërkesa, ankesa dhe parashitresa të ndryshme:

- Kërkesë për rregullim të infrastrukturës (rrugë, trotuar etj) - 97

- Ankesa gjatë punimeve të punëve në infrastrukturë rrugore në asfaltime ...

- Kërkesa të ndryshme

Për kërkesat e shqyrtuara është vendosur:

-Pozitive-13

-Negative

-Në procedurë për shqyrtim - 84

2. KONTRATAT QË MENAXHOHEN NGA MENAXHERET E INVESTIMEVE KAPITALE

Imran Morina menaxhori/mbikëqyr kërto projekte:

- Menaxher i kontratës “Hartimi i projekteve-ritenderim LOT 1 “
- Menaxher i kontratës “Hartimi i projekteve-ritenderim LOT 2”
- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i Rrugëve Komunale LOT 2”
- Menaxher i kontratës “LOT 2 Lisoçë- Shahiq- Zhnjë”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i stadiumit në Hogosht, Kamenicë-Ritenderim”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i trohareve në Kamenicë-Shipashnicë e Ulët, Hodonoc dhe Karaçevë e Poshtme dhe Busavatë
- Menaxher i kontratës “Rregullimi i infrastrukturës në rrugën kryesore dhe tranziti i qytetit-Kamenicë”
- Menaxher i kontratës “Krahu 1, Rruga Korga-Gmice dhe Koretin-Berivojë,
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i Bulevardit të Qytetit në Kamenicë-punët e mbetura-Ritenderim-3”
- Menaxher i kontratës “Asfaltimet e rrugëve në Shipashnicë të Epërme”
- Menaxher i kontratës “Mirëmbajtja e kanalizimit dhe infrastrukturës komunale”
- Menaxher i kontratës “LOT 3 Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë dhe Topanicë”
- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i rrugëve “Livaxhet”, “Zajqeci”, “Mahmuti” dhe “Ahmeti”
- Menaxher i kontratës “LOT 1 Kapi – Sifcë”
- Menaxher i kontratës “Rregullimi i infrastrukturës në rrugën kryesore dhe tranzitin në qytetin e Kamenicës dhe asfaltimi i rrugës “Mihail Grameno” në Kamenicë - Ritenderim”
- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i rrugëve lokale në Koretin rendi 2 “
- Menaxher i kontratës “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë”.

Amire Rexha menaxhon-mbikëqyr këtë projekte:

- Menaxher i kontratës “Participimi me donatorë-Ndërtimi i Llugut të Verdhë-Ritenderim”
- Menaxher i kontratës “LOT 3 Shahiq-Sifrcë”
- Menaxher i kontratës “Participimi me donatorë-Asfaltimi i rrugëve në Karagjevë të Epërme”
- Menaxher i kontratës “LOT 1 Poliqë-Desivojcë-Vriçec”
- Menaxher i kontratës “Furnizim me lodra për parqe”
- Menaxher i kontratës “LOT 2 – Ndërtimi i rrugës qarkore në Kamenicë Krahut 2”
- Menaxher i kontratës “LOT 2 – Asfaltimi i rrugëve në Hodonoc, Roganë dhe Muqivërcë”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i qendrave Viejë Point dhe mbuloja për Zip Line-Ritenderim”
- Vlonë Matoshi menaxhon-mbikëqyrë këto projekte:
 - Menaxhere e kontratës “Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë, Topanicë, Koretin,Karagjevë, Busavatë, Hodonoc, Çerdhja në Kamenicë-Ritenderim”
 - Menaxhere e kontratës “Ndërtimi i pritoreve të autobusëve-Ritenderim 3”
 - Menaxhere e kontratës “Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale”
 - Menaxhere e kontratës “LOT-1-Ndërtimi i Çerdhës në Roganë-Kamenicë”
 - Menaxhere e kontratës “LOT-1-Ndërtimi i Çerdhës në Roganë-Kamenicë”
 - Menaxhere e kontratës “Ndërtimi i tezgave per tregje mobile”
 - Menaxher i kontratës “Participimi me donatorë – Parku i Aventurave-Ritenderim”
 - Menaxher i kontratës “Ndërtimi i varrezave në Hodonoc”

Leotrim Spahiu menaxhon-mbikëqyr këto projekte:

- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra Shipashnicë, Karagevë, Busavatë, Kopërmicë, Koretin dhe Topanicë-Rienderim 2 KM653-23-7865-5-2-1/C465
- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i Rrugëve Komunale LOT 2”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i parkut në qendër e vjetër të qytetit Kamenicë”

Vjollca Krvezin menaxhon-mbikëqyr këto projekte:

- Menaxher i kontratës “Rehabilitimi i rruges Kolloleq-Dajkoc-Muqivërcë”
- Menaxher i kontratës “Mërmëntja e tereneve sportive të hapura dhe të mbyllura”
- Menaxher i kontratës “Parku tek ish qendra”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i zhveshtoreve në Stadiumin e Shipashnices së Eperme”
- Menaxher i kontratës “Lumi Astrit”
- Menaxher i kontratës “LOT 1 – Kamenicë-Muqivërcë-Berivojcë”.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë:

1. HYRJE

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë funksionon në kuadër të Komunës së Kamenicës nga data 31.03.2014 sipas vendimit për amandamentimin e statutit 01. Nr. 005/26.09.2008 si dhe vendimit nr.01. nr.15 dt. 31.05.2010 për plotësimin dhe ndryshimin e statutit të Kuvendit Komunal.

Aktualisht ka një përbërje prej:

- Qendra Komunale e Biznesit
- Qendra për Zhvillim Ekonomik

Në kuadër të QKB vepron:

1. Udhëheqësi i QKB
2. Zyrtari i QKB

Në Kuadër të Zhvillimit Ekonomik vepron:

1. Zyrtari për Zhvillim
2. Zyrtari për Turizëm
3. Zyrtari për mbrojtjen e konsumatorëve

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

2.1 Qëllimi

“Ndërtimi i kapaciteteve ekonomike të zonës lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët, njëherit duke pasur një Diasporë shumë të fuqishme të shërbej në krijimin e urave lidhëse, përmes investimeve të Diasporës, me Komunën dhe qytetarët e saj”

2.2 Objektivat:

2.2.1 Përmirësimi i ambientit biznesor dhe tërheqja e investimeve të reja

2.2.2 Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe promovimi i prioriteteteve dhe potencialeve e pasurive natyrore/nëntokësore të komunës.

2.2.3 Diaspora e Kamenicës do të investojë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik

2.2.1 Përmirësimi i ambientit biznesor dhe tërheqja e investimeve të reja

- 1.1. Shpejtësi dhe efikasitet për gjatë procedurave të rregullimit të dokumentacionit për biznese
- 1.2. Shqyrtimi i kërkesave si: regjistrime, çregjistrime, ndryshime dhe kërkesa për informata
- 1.3. Inventarizimi i pronës së paluajtshme komunale
- 1.4. Planifikimi i pronës së paluajtshme të komunës për dhënie në shfrytëzim
- 1.5. Promovimi i politikave për pronat që jepen në shfrytëzim

- 1.6. Themelimi i Zonës Ekonomike në komunën e Kamenicës
- 1.7. Krijimi i kushteve për hapjen e NMTV-e e sidomos atyre prodhuese
- 1.8. Mbështetja e bizneseve ekzistuese
- 1.9. Rritja e Punsueshmërisë.

2.2.2 Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe promovimi i prioritetëve dhe potencialeve e pasurive natyrore/nëntokësore të komunës.

- 1.10. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në komunën e Kamenicës
 - 1.11. Krijimi i një identiteti të Komunës së Kamenicës
 - 1.12. Identifikimi dhe shfrytëzimi i potencialeve për energji ripërtëritëse
- Rritja e kapaciteteve për tërheqjen e investimeve nga jashtë / thithja e granteve nga donatorë të ndryshëm

2.2.3 Diaspora e Kamenicës do të investojë në zhvillimin e qëndrueshëm socio ekonomik

- 1.13. Identifikimi i personave/ndërmarrjeve me potencial investimi në Kamenicë
- 1.14. Krijimi i data bazës me personat/ndërmarrjet e identifikuara
- 1.15. Bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të përvojave
- 1.16. Aktivitete të përbashkëta, konferenca, forume

3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në objektivat e parapara, DZHEHJ-ja, duke vepruar drejt realizimit të tyre, gjatë periudhës Korrik - Nëntor 2025, ka mundur të realizimin e disa aktiviteteve dhe nën aktiviteteve të parapara në kuadër të objektivave.

4. Aktivitetet e realizuara

4.1 Takime të rregullta me kolegiumin e Drejtorëve të Zhvillimit Ekonomik- Diskutime lidhur me sfidat, vështirësitë, nevoja për plotësim të legjislativioneve në fuqi etj.

4.1 Vizitë bizneseve lokale

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës, ka organizuar vizita të vazhdueshme në biznese, përfshirë edhe përfituesit e granteve të ndara nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe MINT-it, duke parë nga afër angazhimin e tyre në zhvillimin ekonomik.

Gjatë vizitave janë dëgjuar nevojat dhe sfidat me të cilat përballen. Këto biznese janë shembull dhe dëshmi e qartë e potencialit që kemi për të ecur përpara, me punë të ndershme dhe vizion të qartë.

4.2 Punë praktike për të rinjë- 4.590

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë në bashkëpunim me APRK-në në kuadër të programit Kosovo Generation Unlimited ka angazhuar 27 praktikantë me pagesë në institucione publike.

Infermierë, studiues shkencash natyrore e shoqërore, po angazhohen në komunë për tre muaj, për të mësuar nga afër punën si dhe për të parë se si funksionon institucioni përmes kësaj praktike.

Në kuadër të programit Kosovo Generation Unlimited është hera e pestë që komuna hap thirrje për angazhim të praktikantëve.

4.3 Panairi i prodhimeve lokale

Panairi i prodhimeve vendore promovoi bizneset lokale në Kamenicë

Panairi i prodhimeve vendore u organizua në sheshin e qytetit ku bizneset lokale patën mundësinë të prezantojnë produktet e tyre. Në këtë aktivitet qytetarët kishin mundësi që të informoheshin për produktet e bëra në Kamenicë dhe region.

Në këtë panairi i cili u organizua në kuadër të Kamënica Summer Fest bizneset që morën pjesë kanë ekspozuar produkte të ndryshme, nga ushqimet tradicionale deri tek artizanatet dhe produkte të tjera që pasqyrojnë kreativitetin dhe pasurinë e Kamënices.

Ky panair është një mundësi e shkëlqyer për të promovuar produktet që krijohen nga pasioni dhe puna e palodhur e bizneseve tona.

Panairët e tilla janë mundësi për të afruar konsumatorët me produktet që janë të prodhuara pranë tyre dhe të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së qytetit.

4.4 Takim me Odën Ekonomike

Drejtoresha Leka pret në takim Drejtoreshën e Odës Ekonomike të Kosovës për Rajonin e Anamoravës

Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Burbuqe Leka, ka pritur në takim Drejtoreshën e Odës Ekonomike të Kosovës për rajonin e Anamoravës, Erleta Halimi.

Gjatë takimit është diskutuar për disa projekte me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe mbështetjen e bizneseve lokale, u dakorduan që implementimi i këtyre projekteve të ketë për qëllim fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit të biznesit.

4.5 Bashkëpunimi me OIQ Liza-R

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë në bashkëpunim me Organizatën LIZA-R për disa programe të reja

Këto programe janë:

- Programi për Mbështetje me Sera Bujqësore (15 sera për komunën e Kamenicës). Në kuadër të këtij bashkëpunimi do të ofrojmë mbështetje për fermerët dhe bujqit në komunën Kamenicës, duke synuar rritjen e prodhimit bujqësor, përmirësimin e kushteve të punës dhe forcimin e ekonomisë familjare. Përfshesit do të jenë pjesë e një programi monitorimi trevjeçar për të garantuar përdorimin e qëndrueshëm dhe efektiv të serave.
- Bursa për Studentë të Dalluar në Kamenicë (5 bursa për studentët e dalluar të Komunës tonë). Falë bashkëpunimit tonë do të mbështesim të rinjtë me rezultate të larta akademike, të cilët përballen me sfida sociale dhe ekonomike. Vlera e bursës është 450 € (e ndarë në tri kështe gjatë vitit akademik).
- Kurs Profesional Falas në Robaqepësi dhe Qëndisje.

Ky kurs gjashtëmuor është i dedikuar grave, vajzave dhe të rinjve që dëshirojnë të zhvillojnë aftësi kreative dhe praktike në fushën e modës. Kursi përfshin robfaqepësi moderne, qëndisje artistike dhe rikrijim të robave të vjetra në stil unik. Përfshesit e kursit do të certifikohen zyrtarisht në përfundim, duke fituar mundësi të reja për punësim apo hapjen e një biznesi të tyre.

4.6 Parku i aventurave-30,000.00 Euro

Nis ndërtimi i Parkut të Aventurave tek Lugu i Verdhë

Ky projekt do të sjellë hapësira të reja për argëtim, sport dhe rekreacion, duke kontribuar në cilësinë e jetës për qytetarët dhe duke e bërë Kamenicën një destinacion gjithnjë e më tërheqës për vizitorët.

4.7 Bashkëpunim me GIZ-in për projekte të diasporës

Bashkëpunim i ri mes Komunës së Kamenicës dhe GIZ-it për forcimin e shërbitimeve për diasporën

Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Burbuqe Leka, është takuar me përfaqësuesin e GIZ-it, koordinatorin për bashkëpunim me diasporë, Z. Xhelal Dergut, për të diskutuar mbi hapat e ardhshëm në fuqizimin e shërbitimeve komunale ndaj mërkatës.

Ky takim shënon një vazhdimësi të angazhimit të Komunës së Kamenicës në përshtatjen e diasporës në proceset e zhvillimit lokal, duke u bazuar në hulumtimin e realizuar nga Instituti GAP dhe duke kaluar tashmë drejt projekteve konkrete me mbështetjen e GIZ-it.

4.8 Tezgat për tregje mobile 30,000.00 euro

Komuna pajiset me tezgja për tregjet mobile-30,000.00 euro

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës ka përfunduar me sukses projektin e tezgave për tregjet mobile.

Ky projekt synon mbështetjen e ekonomisë lokale dhe promovimin e prodhimeve vendore, duke krijuar kushte më të mira për shitjen e produkteve bujqësore.

Drejtoria do të kujdeset që këto tezgja t'u jepen bujqve në nevojë dhe se në ditët në vazhdim do të njoftohen procedurat për shpërndarjen e tyre, në mënyrë transparente.

4.8 Hartat turistike 1750 Euro

Investimet e fundit nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë janë hartat turistike të cilat tashmë janë vendosur në qytet, tek Lugu i Verdhë dhe Roganë, duke ofruar orientim të qartë për vizitorët dhe dashamirësit e natyrës.

4.9 Shenjëzmi i tre shtigjeve malore për ecje:

Vlera: 3100 Euro

Shtegu 'Astrit Dehari'

Shtegu 'Nuh Berisha'

Shtegu i 'Kranidellit'

4.10 Projektet të cilat janë inicuar në prokurim publik

- Vieë point dhe mbulojat e Zip linë në proces në vlerë prej 30,000.00 euro

4.11 Hartimi i boroshurave informative për Komunën tonë.

4.12 Organizimi i javës së Arsimit në Kamenicë

Bashkë me përfqësues të DVV-së International, Instituti për bashkëpunim Ndërkombëtar I Shogatës Gjermane për Arsimin e rriturve (DVV) Ramadan Aliji, Granit Brajsori nga KEC dhe Ryve Prekurogja nga Masht, u dakorduan që bashkë me DKA-në dhe DKRS-së ta organizojmë Javën e Arsimit në Kamenicë

4.13Dekorimi i sheshit- 1200 Euro

4 QENDRA KOMUNALE E BIZNESVE

Në Qendrën Komunale të Bizneseve për periudhën janar – Nëntor 2025 janë pranuar 351 kërkesa ku të gjitha janë shqyrtuar brenda afatit të caktuar.

Tabela 1. Numri i kërkesave të bizneseve

Kërkesa	Regjistrim	Ndryshime +Informata	Shuarje	Duplikat	Çertifikata të reja RKS	Vërtetimet
Numri	113	48+142	17	9	20	1

STRUKTURAE BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Tabela 2. Struktura e bizneseve të regjistruara

Emërtimet	Janar- Nëntor 2025				
	Prodhuese	Tregtare	Shërbypese	Ndërtimore	Gjithsej
Biznese të regjistruara	29	14	57	13	113
Biznese Individuale					67
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar					46
Tjera	0	00	00	00	0
Struktura Gjimore	Femra 26		Meshkuj 87		113

STRUKTURA E BIZNESEVE TË ÇREGJISTRUARA

Tabela 3. Struktura e bizneseve të çregjistruara

Emërtimet	Janar- Nëntor 2025			
	Prodhuese	Tregtare	Shërbyese	Ndërtimore
Biznese e çregjistruara	3	2	12	0
Biznese Individuale				
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar				0
Struktura Gjimore	Femra 4		Meshkuj 13	
				17

KRAHASIMI NË MES TË BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DHE TË ÇREGJISTRUARA PËR MUAJT JANAR- NËNTOR 2025

Tabela 4. Krahasimi i bizneseve të regjistruara dhe të çregjistruara

Emërtimet	Janar- Nëntor 2025	
	Te regjistruara	Të çregjistruara
Prodhuese	29	3
Tregtare	14	2
Shërbyese	57	12
Ndërtimore	13	0
Gjithsej	113	17

KËRKESAT PËR NDRYSHIME TË BIZNESEVE

Janar- Nëntor 2025					
Emërtimet	Prodhuese	Tregtare	Shërbuese	Ndërtimore	Gjithsej
Ndryshime të bizneseve	17	10	17	4	48
Biznese Individuale					24
SH.P.K.					22
Të tjera					2
Struktura	Femra		Meshkuj		48
Gjinore	9		39		

Kjo qendër ka përfunduar raporte mujore financiare dhe të punës për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe atë:

- raporte tremujore
- gjashtëmujore
- nëntëmuajore dhe
- njëvjeçare

Përveç kësaj, OKB ka ofruar ndihmë, informata dhe këshilla rreth aplikimit për regjistrim të biznesit.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka kryer punët, obligimet dhe detyrat e veta sipas planit të punës të planifikuar, konform Ligjeve dhe Akteve tjera nënligjore, Rregulloreve Komunale dhe Vendimit për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorive të Administratës Komunale.

Raporti i punës për gjashtëmuajorin e dytë, ka të bëjë me përshkrimin e të gjitha punëve në tërësi që janë kryer që nga muaji Korrik deri në fund të muajit Dhjetor në DBPZHR.

Raportin e gjashtëmuajorit të dytë e kemi filluar me mbajtjen e temave trajnuese në kuadër të MBPZHR. në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe KDC-në (Kosova Development Center),pastaj me kontrollimin teknik të auto kombajnave nga komisioni për Korrje-Shirje, hapjen zyrtare të fushatës së Korrje – Shirjeve, përcejelja e procesit të korrje -shirjeve nga komisioni, dalje në teren për vlerësime dëmi, faza e aplikimit për qumësht sipas klasave nga MBPZHR. dhe Komuna për 6 M -1, qumësht për litër (Janar – Qershor), mbajtje të sesioneve informuese, projekti i qumësht për litër nga Komuna etj.

Të gjitha punët që janë kryer gjatë këtij gjashtëmuajori të dytë po i paraqesim radhazi.

1.1 - Mbatja e temave trajnuese me MBPZHR. – DBPZHR. – KDC;

- Me fillimin e muajit korrik që nga data **04.07.2025**, kemi vazhduar me mbajtjen e temave trajnuese në bashkëpunim me MBPZHR./ KDC.- në për sektor të ndryshëm. Me këtë datë kemi mbajtur temën e radhës me titull „ Të ushqyerit e kafshëve të imta, Dele dhe Dhi qumështore me trajner Mentor Azemi.

- Me datë **19.09.2025**, kemi vazhduar me mbajtjen e temës trajnuese me titull „ Higjiena në stallë dhe dezinfektimi i thundrave “ në blegtori me trajner Sadulla Ahmeti.

1.2. Procesi i fushatës së Korrje – Shirjeve;

- **Kontrollimi teknik i auto kombajnave nga komisioni komunal për Korrje – Shirje;**
- Pas formimit të komisionit komunal për procesin e korrje – shirjeve për 2025, komisioni i ka filluar punët për përgatitjen e fushatës së korrje – shirjeve.

Me fillim të datës **07.07.2025**, komisioni ka filluar punën me dalje në teren për të bërë kontrollimin teknik të auto kombajnave, pas kontrollit palën e kemi pajisur me procesverbale si dhe njoftimin për çmimin e caktuar nga Ministria e Bujqësisë. Të gjithë Kombajnerët janë informuar nga komisioni për detyrat dhe obligimet që duhet t'i respektojnë secili kombajner.

- **Hapja zyrtare e fushatës së Korrje – shirjeve;**

- Për çdo vit DBPZHR organizon dhe përcjell fushatën e Korje – shirjeve në komunën tonë, kështu që në Komunën e Kamënicës, procesi i korje-shirjeve ka filluar më datë 05.07.2025, duke filluar me korjen e parcelave të mbjella me kulturën e Elbit, pastaj më datë 09.07.2025 ka filluar edhe korje – shirja e sipërfaqeve të mbjella me kulturën e Grurit.

- Më datë 11.07.2025 është bërë hapja zyrtare e fushatës së korje-shirjeve në komunën tonë dhe ka përfunduar procesi më datë 05.08.2025. Sipërfaqet për korje për këtë vit kanë qenë me sa vijon : Grurë 1,500 ha., Tërshërë 80 ha. dhe Trojikal 50 ha. Rendimenti mesatar për këtë vit ka qenë me sa vijon: Te Gruri ka qenë 4,000 kg./ha. kurse te Elbi ka qenë 3,200 kg./ha. dhe gjithë sipërfaqet e korrura me këto kultura i takojnë sektorit privat.

Gjatë procesit të Korje-shirjeve këtë vit në komunën tonë, kanë qenë të përfshirë 33 Autokombajna.

- **Përcjellja e procesit të Korje-shirjeve nga komisioni;**

- Gjatë tërë procesit të Korje-shirjeve, që nga fillimi e deri në përfundimin e saj, komisioni ka bërë përcjelljen e saj duke dalë në teren. Komisioni ka bërë përcjelljen e kombajnave në teren duke kontrolluar që të mos bëjnë dërdhjen e drithërave në tokë, respektimin e ngastrave të fermerëve e kështu me radhë.

1.3. Informatat për zyrën e Kryetarit, zyrën e informimit dhe MBPZHR, për fushatën e Korje-Shirjeve;

Pas fillimit të fushatës së korje-shirjeve në komunën tonë, komisioni ka bërë disa informata për të informuar Ministrinë e Bujqësisë, Kryetarin e Komunës, zyrën e informimit dhe Kuvendin Komunal për procesin e fushatës së korje – shirjeve.

- Më datë 14.07.2025, është bërë informata e parë nga komisioni dhe ju është dërguar Ministrisë së Bujqësisë, Kryetarit të komunës dhe zyrës së informimit;
- Më datë 21.07.2025, është bërë informata e dytë nga komisioni dhe ju është dërguar Ministrisë së Bujqësisë, Kryetarit të komunës dhe zyrës së informimit;
- Më datë 05.08.2025, është bërë informata përfundimtare për përfundimin e procesit të korje-shirjeve nga komisioni dhe ju është dërguar Ministrisë së Bujqësisë, Kryetarit të komunës dhe zyrës së informimit;
- Më datë 18.08.2025, është bërë informata përfundimtare për përfundimin e procesit të korje-shirjeve nga komisioni dhe ju është dërguar Kryesuesit të Kuvendit;

1.4. Faza e aplikimit për subvencionim të qumështit, therjeve të raportuara, majmëria e viçave, dëshmitë e grurit / kg. – Paga – Direkte / Subvencione -MBPZHR.;

- Që nga data 01.08.2025 e deri më datë 01.09.2025, kemi pasur afatin e aplikimit për subvencionim të qumështit për litër, majmëri të viçave, therje të raportuara, dëshmitë për sasi të grurit të dorëzuar në pikat grumbulluese për Kg. nga MBPZHR. / AZHB – ja.
- Të gjitha këto aplikime bëhen dy herë për çdo 6 muaj të vitit kalendarik, subvencionimi i qumështit bëhet për litër të qumështit të dorëzuar dhe sipas klasave në qumështore të licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrata me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë edhe atë sipas kategorive që po i japim më poshtë :

1. Ekstra Klasë - 0.07 €./ litër.
2. Klasa e parë – 0.04 €./ litër.
3. Klasa e dytë – 0.02 €./ litër.

- Në formë tabelore po i paraqesim gjitha aplikimet :

Emërtimi i aplikimit;	Nr. Aplikuesve ;	Sasitë e dorëzuara për – 6 M – 1 / 2025;
Qumësht për/ lit.	73	1,247,688 / litra
Majmëri të viçave	10	184/ krerë
Therje të viçave	1	19 / krerë
Dëshmi për sasinë e grurit të dorëzuar / kg.	104	2,418,868 Kg.

1.5. Projektet e realizuara nga DBPZHR./ Komuna;

- Drejtoria e Bujqësisë këtë vit në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar këto projekte:
 - a) „ Subvencionimi i fermerëve për Qumësht / litër – 6 M -1 / 2025;
 - b) „ Trajtimi i qenëve endacakë ”.
- Projektet e realizuara nga drejtoria e bujqësisë për këtë gjashtë mujor të dytë, po i paraqesim edhe në formë tabelore, për nr. e aplikuesve dhe përfutjesve.

Nr.	Projektet e realizuara;	Nr. i Aplikuesve	Gjithsejt, sasia e litrave;	Nr. i Përfutjesve	Gjithsejt, sasia e litrave;
1	Subvencionim i fermerëve prodhues të Qumësht / litër; - 6 M -1 / 2025;	85	1,314,953	85	1,213,424
2	„ Trajtimi i qenëve endacak ”;	-	-	-	-

1.6. Mbatja e sesioneve informuese nga DBPZHR./ Komuna;

- Me datë 18.08.2025, kemi mbajtur sesionin informues me fermerët e komunës tonë, për t'i informuar rreth programit dhe fazës së aplikimit për grande për LOT -1 dhe LOT -2, nga GIZI – Gjerman, që është projekt në kuadër të MBPZHR. në marrëveshje me GIZ-in gjerman „ Skema e Granteve për Investime, LOT 1 dhe LOT 2.

- Më datë 29.09.2025, kemi mbajtur sesionin e parë informues me grupin punues me fermer të sektorëve të ndryshëm bujqësor. Në këtë sesion është bërë informimi rreth ndërtimit të pikës grumbulluese për grumbullimin e mbeturinave të gjelbërta nga Auditoria sociale Ardita Rizvanolli.

- Më datë 16.10.2025, kemi mbajtur sesionin e dytë informues me grupin punues me fermer të sektorëve të ndryshëm bujqësor. Gjatë këtyre sesioneve po bëhet prezantimi rreth funksionimit se si do të krijohen hallkat zingjyrore për grumbullimin e mbeturinave të gjelbërta. Këtë sesion e kanë drejtuar Bekim Ermani Agronom dhe Auditorja sociale Ardita Rizvanolli.

- Më datë 20.11.2025, kemi mbajtur sesionin e tretë informues me grupin punues me fermer të sektorëve të ndryshëm bujqësor. Pas këtij takimi në mënyrë të organizuar kemi bërë vizitën në fshatin Kopërmicë ku edhe është duke u ndërtuar pika grumbulluese për deponimin e mbeturinave të gjelbërta bujqësore.

- Në këtë vizitë prezent ka qenë edhe Menaxheri i projektit ku në pika të shkurtra na prezantoj punët që janë kryer dhe që po vazhdojnë akoma deri në përfundimin e saj. Takimin e grupit punues është duke e udhëhequr Auditorja sociale Ardita Rizvanolli. Disa foto nga ky takim i mbajtur me këtë datë;

1.7. Vlerësimet e dëmeve në teren;

- Gjatë këtij gjashtë mujori të dytë kemi pasur disa kërkesa për vlerësim dëmi nga fermerët, andaj drejtorja e bujqësisë pas pranimit të kërkesave nga fermerët për vlerësim të dëmeve, komisionet e caktuara nga drejtorja kanë dalë në teren dhe kanë kryer vlerësimet e tyre për sektorë të ndryshëm.
- Po ashtu gjatë muajit Nëntor, në komunën tonë kemi pasur disa vërshime nga të reshurat atmosferike të shiut, po ashtu edhe në sektorin e bujqësisë janë shkaktuar dëme nëpër disa ngastra të mbjella me kultura të ndryshme. Ne po i paraqesim edhe disa foto edhe nga këto vërshime.

Përmes tabelës po i paraqesim numrin e vlerësimeve të dëmeve sipas sektorëve:

Nr.	Sektorët;	Nr. Vlerësimeve të dëmeve;
1	Blegtori;	1 vlerësim;
2	Pemëtarë;	2 vlerësime;
3	Lavërtari e perimekulturrë, etj;	6 vlerësime;

1.8. Ndërrimi i kulturës pyjlore në atë bujqësore;

Më datë 29.10.2025, komisioni nga drejtoria e bujqësisë ka dal në teren sipas kërkesës së palës për ndërrimin e kulturës nga pyjore në atë bujqësore dhe kërkesa është shqyrtuar nga ne.

1.9. Mbjellja e kulturës së grurit në tokën publike (Komunale);

- Këtë vit për herë parë Drejtoria e bujqësisë me Komunën kemi bërë mbjelljen e kulturës së grurit në tokën publike (komunale) për t'i plotësuar nevojat e kuzhinës popullore me ushqime bio.

2.0. Disa takime punuese të Drejtorit;

- Gjatë këtij gjashtë muaji të dytë të këtij viti, po i paraqesim disa nga punët e kryera të drejtorit, si dhe disa takime të ndryshme.

2.1. Përzgjedhja e fermerëve Lider për sektorët e bujqësisë, për MBPZHR.;

- Zyrtarët e drejtorisë së bujqësisë kanë dal në teren dhe gjatë punës disa ditore i kanë kontaktuar të gjithë fermerët pretendentë për Lider nëpër sektor të ndryshëm, që është në kuadër të MBPZHR. Sipas programit të MBPZHR. duhej të përzgjidhen rreth 40 fermer Lider për sektorët: Lavëtar, Blegtori, Bletari, Perimekulturrë, Pemëtar, Hortikulturrë, Shpezëtar.

2.2. Drejtoria e Bujqësisë në vazhdim e punëve ka kryer edhe këto punë për Korrik – Dhjetor, të paraqitura në tabelë si më poshtë:

Nr.	Emërtimet e aktivitetëve;	Gjithsejtë nr. i lëndëve;
1	Kryerja e akteve administrative;	51
2	Lëshuarja e Certifikatave të NIF-it;	86
3	Lëshuarja e vërtetimeve;	1
4	Vlerësimi i dëmeve;	3
5	Numri i përfutjesve nga projektet e DBPZHR.;	85
6	Lëshuarje të Referencës;	1

2.3. Të hyrat buxhetore nga Bujqësia për gjashtë muajorin e dytë :

Nr.	Të hyrat buxhetore	Shuma në /€,
1	Korrik - Dhjetor	0.00 /€.

Dreitoria për Rinë, Kulturë dhe Sport:

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kamenicë edhe në gjashtëmuajorin e dytë vazhdoi me punët intensive në përgatitjen e manifestimeve e aktiviteteve sa më atraktive për qytetarët rezident të komunës, por në mënyrë të veçantë edhe për bashkatdhetarët tanë nga diaspora, të cilët kalojnë pushimet në vendlindjen e tyre.

Gjashtëmuajori i dytë filloi me Manifestimin Tradicional “Summer Fest”, i cili këtë vit ishte edhe më madhështorë se vitin e kaluar. Gjatë periudhës korrik – gusht , qytetarët përcollën aktivitete të shumta kulturore e sportive. Disa nga aktivitetet e realizuara ishin risi për qytetarët, gjë që ndikoi dukshëm në rritjen e shikueshmërisë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Agjenda e vendosur më poshtë, tregon volumnin e aktiviteteve, ndërsa fotografi të tregojnë panje madhështore nga aktivitetet.

Aktiviteti më atraktiv i këtij manifestimi ishte Moto-Crossi . Ky aktivitet planifikohet të jetë tradicional. Nga fotot e vendosura në vijim mund të shihet që vërtetë ky aktivitet ishte i veçantë dhe shumë atraktiv.

Aktivitetet e interesant dhe atraktiv, ishte edhe performanca “ Living Statues” e realizuar nga grupi unik artistik “Teatros K” nga Maqedonia e Veriut .

Aktivitetet tejet i rëndësishëm ishte edhe Festivali i Kulturave , në të cilin morën pjesë dhjetëra ansamble nga vende të ndryshme të botës. Valltarë e këngëtarë nga , Qipro, Italia, Meksika, Spanja, Turqia, Bullgaria, Brazili etj, që artinin numrin mbi 220 , kaluan gjithë ditën Kamenicë, me q’rast bënë vizita të institucione e defiluan në shesh, duke i dhënë , qytetit ngjyra e laramani kulturash të ndryshme .

✦ Në kuadër të manifestimit për Festën e Flamurit, me 28 Nëntor, u organizuan aktivitete të shumta kulturore e sportive. Qytetarët për gjatë një jave ishin pjesë e festës dhe aktiviteteve tejatraktive.

✦ Përveç organizimit të manifestimeve tradicionale kulturore e sportive, DKRS, ka subvencionuar organizata kulturore e rinore, klube sportive e individ, përmes thirrjeve publike:

- Shpallja e thirrjes publike për mbështetje financiare për OJQ-të kulturore; (vlera e përgjithshme e thirrjes 30000 euro)
- Shpallja e thirrjes publike për mbështetje financiare për klube sportive; (vlera e përgjithshme e thirrjes 45000 euro)
- Shpallja e thirrjes publike për mbështetje financiare për projekte rinore (vlera e përgjithshme e thirrjes 7000 euro)

✦ Botimi i katalogut “Trashëgimia Kulturore e Komunës së Kamenicës”

Sipas Memorandumit të lidhur me QRTK-në, është botuar katalogu “ Trashëgimia Kulturore e Komunës së Kamenicës” .

Avancimi i kulturës është bërë edhe me pjesëmarrjen në projekte e programe të ndryshme;

- Inicimi i procedurave për shenjëzimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore sipas Udhëzimit Administrativ nga MKRS-ja, ku sqarohen specifikat e tabelave orientuese për asetet e trashëgimisë kulturore, por edhe për institucione tjera si: muzetë, bibliotekat, teatrot, stadiumet etj.;
- Bashkëpunimi me Qendërën Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjilan;
- Intervenime në objekte të trashëgimisë kulturore:
- Restaurimi i Xhamisë së Meshines (QRTK),
- Vazhdimi i punimeve në Stadiumin e Kikës, në Hogosh;
- Inicimi i procedurave në MKRS për mbështetje financiare për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës, në Roganë-Novosellë;
- Koordinimi me Federatën e Atletikës për hartimin e projektit të Stadiumit të Atletikës
- Pjesëmarrje në takimet e organizuara nga MKRS për hartimin e draft koncept-dokumentit për strategjinë e sportit
- Pjesëmarrje në takimet e organizuara nga MKRS për draftin e konceptit për sportin shkollor;
- Takime me Komitetin Olimpik të Kosovës, Federata respektive të Kosovës dhe faktorë të rëndësishëm në fushën e kulturës dhe sportit;
- Koordinim me Baletin Kombëtar për të shfaqur një pikë baleti në Teatrin e Qytetit;
- Koordinim me organizimi i koncertit të mbajtur në Komunën e Kamenicës, në muajin janar;
- Inicimi i formimit të Korit të Fëmijëve, në bashkëpunim me Shkollën e Muzikës;

- Vizitë koleksionistit privat të trashëgimisë kulturore Shefki Thaqi nga fshati Muqivërc, i cili posedon rreth 700 arte fakte

Problemet e identifikuara brenda DKRS që përbejnë vështrësi për realizimin e punëve

- Mungesa e stafit të shtëpisë së kulturës menaxherit të objektit, rojës, recepsionistit, dhe kujdestarisë gjatë vikendit
- Mungesa e stafit të palestës së sportit, menaxherit të objektit, rojës dhe kujdestarisë gjatë vikendit
- Probleme të sistematizimit të stafit në bibliotekë
- Probleme dhe mungesë e stafit në Arkivin Historik Komunal
- Mungesa e një strategjie të përgjithshme zhvillimore për sektorët e kulturës, të rinisë dhe të sportit në Komunën e Kamenicës;
- Kapacitetet e pamjaftueshme profesionale dhe mungesa e shpërndarjes së informacionit mbi aktivitetet e realizuara;

Punët/projekte të planifikuara për 2026

- Angazhimi rreth themelimit të Muzeut të qytetit dhe gjeçja e fondeve për restaurimin e objektit ekzistues, ose ndërtimin e objektit të ri.
- Inicimi i procedurave për rregullimin e rrethojës të vendi i caktuar për piknik “Te pishat”,
- Inicimi i rregullimit të ujësjellësit dhe kanalizimit “Te pishat”.
- Rregullimi i vendit për ndezjen e zjarrit te Varrezat e Dëshmorëve”.
- Rregullimi i Flakadanëve te Shtëpië Muze “Kadri Zeka” “Nuh Berisha” dhe Rexhap Mala”.
- Rregullimi i ujësjellësit te Shtëpia Muze “Kadri Zeka” dhe angazhimi i një mirëmbajtësi të Shtëpiave Muze.
- Përkrahja e koleksionistëve privat të trashëgimisë kulturore .
- Adaptimi i ambientit në Kalanë e Kulinë, Kamenicë
 - Rregullimi i ndriçimit, shtigjeve, tabelave informuese etj.;
 - Inicimi i procedurave për shpronësin të rrugës lidhëse me kalanë. Projektin për ndriçimin e kemi realizuar. Jemi duke punuar për planifikimin e shtigjeve dhe tabelave informuese. Ndërsa rruga lidhëse rezulton që është pronë e një qytetari. Në këtë rast do të mundohemi të vëmë kontakt me të për të biseduar rreth mundësisë së shpronësimit, ndërtimit me një pronë tjetër, apo edhe për blerjen e pronës.
- Ndërtimi i Stadiumit të Atletikës (me kritere evropiane), mbështetur nga MKRS;
- Fugizimi i të rinjve të Kamenicës, sipas udhëzimeve të Strategjisë për Rini e cila është duke u hartuar nga MKRS;
- Organizimi i Panairit të Librit në Komunën e Kamenicës;

- Organizimi i një tryeze shkencore lidhur me veçoritë etnokulturore të Komunës së Kamenicës;
- Iniciimi i formimit të ansambllit të këngëve dhe valleve në kuadër të DKRS (me kërkesë në Kuvendin Komunal);
- Iniciimi i zgjidhjes së statusit të Qendrës Rinore , si Institucion Rinor Komunal
- Shpallja e thirrjes publike për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e Manifestimeve Tradicionale;
- Thirrja publike për mbështetje për Klubet Sportive;
- Thirrja publike për mbështetje për individë.

Drejitoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi:

Drejitoria për PKGJ-së si organ i administratës komunale në Kamenicë, ka vepruar dhe vepron në zhvillimin e procedurave dhe detyrave konform kompetencave lëndore të parapara në statutin komunal, rregulloret dhe ligjet në fuqi, bazuar në evidencën-bazën tekstuale përmes fletëve poseduese, ku janë paraqitur të gjitha informacionet e pronarit dhe pronës, të cilat identifikohen përmes planeve gjeodezike, etani në formën digjitale – ortofotot që posedon Drejitoria.

Në mënyrë permanente jemi angazhuar dhe u kemi ofruar shërbime efikase të mundshme qytetarëve konform kërkesave të tyre dhe realizimin në afate sa më të shpejta.

Angazhimi i jonë është orientuar në një organizim të mirëfilltë në bazë të sistemit të avancuar gjyqësor duke aplikuar Ligjin Kundër Diskriminimit në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve, si nga tereni ashtu edhe në zyrë.

Stafi i Drejtorisë tonë është me një përvojë nga e kaluara dhe për çdo lëndë të komplikuar tubohet, analizon dhe propozon zgjidhje meritorë.

Drejitoria për PGJK përbëhet prej tre sektorëve:

➤ Sektori i Pronësisë.

➤ Sektori i Kadastrit

➤ Sektori i Gjeodezisë

Është evidente se në DPK/GJ ka punë të pa ndëprerë dhe numër të konsideruar të lëndëve e që për shqyrtim lypet edhe zënia e afatëve ligjore, por duke pasur parasysh numrin e stafit të pakët, na paraqiten edhe vonesa të shqyrtimit të lëndëve.

Sa i përket numrit të përgjithshëm të kërkesave që kanë arrit për këtë periudhë pran kësaj drejtorie, të regjistruara dhe të realizuara.

Këto kërkesa të realizuara kanë gjeneruar të hyra për komunën si më poshtë:

Drejtoria për Pronë Kadashtë dhe Gjeodezi numri i përgjithshëm i kërkesave për këtë Gjashtë mujor është:

Ne fushën e Kadastrit:

Ne fushën e kadastrit nr. i kërkesave (Trashëgimi, Dhurim, Shitblejë, Parcelime, Bashkime, Ndarje fizike , Vendosja e Bartës Talmore, Vendosja e Masës se Sigurisë, Servitute, Mbatje e përjetshme ,Hipoteka, Regjistrime Çregjistrime)

Numri i lendeve te kryera për këtë gjashtë mujor ne fushën e Kadastrat është; 1330 Lëndë.

Kërkesat për Gjashtë mujorin e fundit (Fleta poseduese, Vërtetime për palujtëshmëri, Çartefikat qe nuk posedon paligjshmëri është:

4367 kërkesa

Në fushën e Gjeodezisë:

Numri I kërkesave të dorëzuara për këtë Gjashtë mujor (Kopje plani, Parcelim Bashkim, Modifikim, Ndryshim kufijsh ,koordinata , Identifikim) etj, 1821 Lëndë.

Në fushën e Pronës:

Numri I kërkesave të dorëzuara për këtë Gjashtë mujor (Uzupim, Ekspedicion, Procesverbale, Propozim vendime) etj. është:

28 kërkesa

Kërkesa –përgjigjeje për:

Për Zyren e Kryetarit, Kuvendin Komunal, Drejtoritë, Gjykatë, Prokurori, Polici, AKK, Hetuesi, Shërbimi inteligjent, Noter, Përmbarues , Vlerësues , Ndërmjetësues , Akp, etje:
 Numri I kërkesave-përgjigjejeve të dorëzuara për këtë Gjashë mujor për institucionet zyrtar është:
 135 kërkesa.

Mund te shihni me poshtë tabelat me nr. te kërkesave:

50011 Trashëgimitë									
Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total	
01	Ndarje parcelash	12	22	29	31	22	19	123	
02	Bashkim parcelash	11	18	31	29	32	20	130	
03	Regjistrimi i ndërtesave	6	01	00	00	00	00	01	
04	Ndarja - Bashkimi e ndërtesave	05	00	00	00	00	01	01	
05	Modifikime	22	18	11	18	16	22	85	
06	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	03	00	01	02	01	00	04	
07	Ndarja - Bashkimi e pjesëve të ndërtesave	03	01	02	01	00	00	04	
08	Vërtetim Identiteti	32	28	11	29	20	22	110	
09	Regjistrimi i hipotekave	03	02	02	02	00	01	07	
10	Çregjistrimi i hipotekave	01	01	01	01	02	01	06	
11	Regjistrimi i shtitjeve	45	28	33	45	33	22	161	
12	Regjistrimi i trashëgimive	53	39	36	32	29	26	162	

13	-/-/- i faljeve të pronës së paluajtshme	56	19	22	23	25	22	111
14	-/-/- i ndërrimit të pronës së paluajtshme	03	04	02	03	00	00	09
15	-/-/- i shëputjes së bashkësisë familjare	03	00	01	01	01	00	03

16	-/- i përkujdesjes së përjetshme	02	02	01	01	00	00	04
17	-/-/- i pronave të ekspropriuar	02	01	00	01	00	00	02
18	-/-/- i servitutit	00	00	00	00	00	00	00
19	Çregjistrimi i servitutit	00	00	00	00	00	00	00
22	Regjistrimi i barrës tatimore	02	00	01	02	01	00	04
23	Çregjistrimi i barrës tatimore	00	00	00	01	00	00	01
24	Regjistrimi i ngarkesave tjera	00	00	00	03	01	01	05
25	Çregjistrimi i ngarkesave tjera	00	00	00	00	00	00	00
26	Regjistrimi i qira mbajtjeve (mbi 3 vjet)	02	00	00	02	00	01	03
27	Çregjistrimi i qira mbajtjeve (mbi 3 vjet)	00	00	00	00	00	00	00
28	Regjistrimi i korrigjimeve në regjister	14	00	02	01	01	01	05
29	Regjistrimi i rregullimit të kufiri	11	06	01	03	03	05	18
30	Regjistrimi i ndërrimit të shfrytëzimit akt	06	01	00	01	00	00	02
31	Regjistrimi i shërbimeve tjera	09	06	18	11	11	08	63
Total i kërkesave		315	197	205	243	198	172	1330

Tabela Nr. 2. Punët e realizuara në fushën e matjeve:

50504 Matjet									
Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total	
01	Azhurnim	283	21	22	33	32	29	166	
02	Parcelim – parcele	12	22	29	31	22	19	135	
03	Bashkim- parcelash	11	18	31	29	32	20	141	
04	Kopje plani	66	72	81	65	54	50	388	
05	Matje ndërtesash	00	00	00	00	00	00	00	
06	Koordinata	70	59	61	58	65	41	354	
07	Identifikim	84	85	94	73	96	84	516	
08	Ndarje	00	00	00	00	00	00	00	
09	Rregullim kufijsh	11	25	12	23	28	22	121	
10	Të tjera-Aplikacione	00	00	00	00	00	00	00	
Totali		283	302	330	312	329	265	1821	

Tabela Nr. 3. Certifikatat e lëshuara:

50019 Certifikata									
Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total	
01	Certifikata pronësie, (fleta poseduese)	334	330	423	231	345	245	1908	
02	Kopje plani	303	297	400	223	322	233	1778	
03	Vërtetime të ndryshme	23	45	179	156	169	109	681	
Totali		660	672	1002	610	836	587	4367	

Tabela Nr. 4. Punët e realizuara në fushën e pronësisë:

Pronësi									
Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total	
01	Shpronësim								
02	Uzurpim								
03	Të ndryshme - Takime								
04	Ekspedicion								
06	Procesverbale								

07	Të Bartura								
	Total		11	02	01	00	14	00	28

Drejtoria Komunale e Arsimit:

Data	Aktiviteti	per:
03,06,2025	Festa e Abetares	Nxensit e klaseve te para
10,06,2025	Konkurs per regjistrim te femijeve ne shkollen e muzikes	Te gjitha shkollat
12,06,2025	Planifikimi i klaseve te X-ta	Drejtoret e SHML
13,06,2025	Planifikimi i klaseve te para	Drejtoret e SHFEMU
19,06,2025	Planifikimi i profileve te IAAP	Drejtoret e SHML
20,06,2025	Realizimi i plote i kontrollave sistematike shendetesore	Te gjitha SHFEMU
23,06,2025	Konkurs per regjistrim ne IP	Drejtoria e IP "Filizat"
24,06,2025	Furnizim i 3 shkollave me tituj te rinje lekytrash	A.Krashnica, M. Krasniqi, Skenderbeu
27,06,2025	Furnizimi i shkollave me pelet	Te gjitha shkollat
30,06,2025	Furnizimi me tepi dhe perde	Te gjitha shkollat
01,07,2025	Trajnim per Politikat e mbrojtjes se femijeve	Te gjitha shkollat
08,07,2025	Konkurs per regjistrim te nx ne klasen e X	Te gjitha SHML
14,07,2025	Konkurs per mesimdhenes te Muzikes	Zyreja e burimeve njerezore
15,07,2025	Konkurs per Mesimdhenes ne SHFEMU dhe SHML	Zyreja e burimeve njerezore
02,08,2025	Planifikimi i tekseteve shkollore 2025-26	Te gjitha SHFEMU
19,08,2025	Shperndarja e mjeteve didaktike	Te gjitha IA
20,08,2025	Kontraktimi i transportit te nxenesve	Te gjitha IA
21,08,2025	Trajnimi per mesim inkluziv	Te gjitha SHFEMU
27,08,2025	Informata te plota per CODIM	Te gjitha SHFEMU
03,09,2025	Pranojme Inventar donacion ne vlere 10 mije eruo	3 shkolle

12,09,2025	Furnizimi me materiale higjienike	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
15,09,2025	Fillon projekti per SHFMMU "Siguria rrugore"	Te gjitha SHFMMU
18,09,2025	Kompletimi i Kuzhines Qendrore me pajisje profesionale	Kuzhina qendrore
20,09,2025	Ekskursioni i maturanteve	SHML
23,09,2025	Pajisja e cerdhes me lodra dhe materiale didaktike	IP "Filizat"
24,09,2025	Llogaritje e reja per te gjitha nxenesit	Te gjitha SHFMMU
30,09,2025	Furnizimi i bibliotekes se SHFMMU "Rexhep Mala" me 320 libra	SHFMMU "Rexhep Mala" Topenice
01,10,2025	Pajisja e te gjitha nxenesve fillor me jelek Floroshent	Te gjitha SHFMMU
24,10,2025	Ndarja e subvensioneve per nxenesit e suksesshem	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
30,10,2025	Instalimi i kamerave dhe pajisjeve te vijueshmerise	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
31,10,2025	Themelimi i Ekipes per vleresim te FNV arsimore	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
03,11,2025	Shperndarja e kartelave per evidentim te vijueshmerise	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
07,11,2025	Inicim i procedurave per kontrolla shendetesore	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
18,11,2025	Vendimi per themelimin e grupit punues per hartimi e programit komunal per femijet me aftesi te jashtezakonshme, dhunti, talent	
20,11,2025	Ndarja e bursave per studente	Studentet ne universitetet pub
21,11,2025	Furnizimi i shkollave me dru per ngrohje	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
13,12,2025	Olimpiada e Matematikes	Te gjitha SHFMMU dhe SHML
16,12,2025	Pajisja e SHFMMU "Deshmoret e Kombit" me Inventar	SHFMMU "Deshmoret e Kombit"
21,12,2025	Instalimi i kaldase se re ne SHMLM "Sejdi Kryeziu"	SHMLM "Sejdi Kryeziu" Rogane

Palet qe u jane drejtua DKA-se		Ndryshimet ne listat e pagave
	janar - dhjetor 2025	Janar -dhjetor 2025

Jane pranuar	1006 kerkesa/ankesa	Te rinj ne liste 52
miratuar	937	Ndryshime ne liste 40
refuzuar	42	Largime nga lista 27
ne proces	24	
anuluar	4	

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencat:

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambientit Inspektorat dhe Emergjencat, sipas kompetencave dhe përgjegjësi bazuar në Ligje dhe Akte tjera nënligjore, Rregulloret Komunalet si dhe, rregulloret për organizimin e brendshëm të Administratës Komunale në Komunën e Kamenicës Ai ka kryer obligimet dhe detyrat e veta. Kjo drejtori në kuadër të saj i ka 4 (katër) sektorë.

- Sektori i Shërbimeve Publike;
- Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit;
- Sektori i Inspektoratit, dhe
- Sektori i Emergjencave.

1. STAFI I DREJTORISË SIPAS SEKTORËVE

❖ Staf i Drejtorisë sipas Sektorëve përbëhet nga:

- Udhëheqës i sektorit të SHP, (zyrtar juridik), 1

- Udhëheqës i sektorit për MMA, (zyrtar i Qarkullimit rrugor),	1
- Zyrtar i ambientit,	1
- Zyrtar i lartë hidroprojekt,	1
- Zyrtar për KEK dhe PTK,	1
- Zyrtar administrativ,	1
- Mirëmbajtës të ambientit,	3
- Udhëheqës i sektorit të Inspektoratit,	1
- Inspektor i Mjedisit,	1
- Inspektor i Tregut,	1
- Inspektor i Komunikacionit,	1
- Zyrtar Juridik, në sektorin e Inspektoratit,	1
- Udhëheqës i Sektorit për siguri dhe Emergjencia,	1
- Zyrtar për vlerësimin e rezultatit,	1
- Zyrtar i planifikimit të rezultatit,	1
- Inspektor për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera,	1
- Komandant i batalionit,	1
- Zv. Komandant i batalionit,	1
- Udhëheqës i skuadrës,	4
- Zv. Udhëheqës i skuadrës,	4

- Udhëheqës grupi, 8
- Zjarrfikës, 14

Përveç stafit të shënuar më lartë nga muaji shtator, përkatësisht muaji nëntor janë të angazhuar edhe 2 (dy) asistentë administrativ me kontrata tri vjeçare.

Në vijim do të paragesim të dhëna të detajuara për punët të cilat janë zhvilluar në këtë periudhë.

❖ Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra publike

Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra publike bëhet nga NPL “Dardana” sh.a. Në këtë kontratë përveç mirëmbajtjes intensive të hapësirave publike, kemi po ashtu edhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, pastrimin e shtrait të lumit në qytet, mirëmbajtjen e zip-line, mirëmbajtjen e hapësirave të lugu i verdhë, pastrimin e varrezave të lokaliteteve të ndryshme sipas kërkesave të pranuar nga këshillat lokale si dhe hapësira tjera publike brenda territorit të Komunës së Kamenicës. Në vijim do të paragesim në mënyrë tabelare sipërfaqen e cila mirëmbahet nga NPL “Dardana” sh.a.

Tabela Nr. 1; Mirëmbajtja e Hapësirave të gjelbra publike

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja (m ²)
1	Mirëmbajtja intensive e hapësirave gjelbëruese	92,994.00
2	Varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët	59,500.00
3	Pastrimi i lumit të qyteit	31,886.00
Sipërfaqja e përgjithshme (m²)		184,380.00 m²

Përveç hapësirave të cekura më lartë, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia, mirëmban edhe hapësira të tjera publike të cilat nuk janë të shënuara në këtë kontratë. Përveç punëve të mirëmbajtjes së këtyre hapësirave nga NPL "Dardana", në mënyrë të rregullt mirëmbahen edhe hapësira tjera publike, përmes tre punëtorëve të mirëmbajtjes së ambientit nga drejtoria, të cilët vazhdimisht sipas nevojës bëjnë edhe pastrimin e depozitave ilegale të mbeturinave nëpër lokalitete të ndryshme.

❖ Projektet dhe fushatat e pastrimit të mjedisit

Në periudhën e dytë të këtij viti janë planifikuar disa aksione për pastrimin e ambientit, ku sipas planifikimit edhe janë realizuar si në vijim:

- **Me 5 Qershor me rastin e ditës botërore të mjedisit** është mbajtur aksioni për pastrimin e ambientit në të gjithë territorin e komunës së Kamenicës. Aksioni ka filluar nga rruga Tahir Sinani, duke përfshirë qytetin e Kamenicës. Në këtë aksion përveç punëtorëve të drejtonisë së shërbimeve publike, kanë marrë pjesë edhe punëtorët nga NPL Dardana, dhe disa vullnetar nga KL. Thasët e mbushur me mbeturina janë bartur nga kompania Ecobigjiena e cila i ka transportuar në depozitë për mbeturina. Gjithashtu me ngarkuesin e komunës janë pastruar disa depozita ilegale.
- **Me 19 shtator në kuadër të ditës botërore të pastrimit është mbajtur aksioni "Ta pastrojmë Kamenicën"**. Aksioni është mbajtur në të gjitha lokalitetet e komunës duke u pastruar hapësirat për rreth objekteve publike, shkollave dhe institucioneve tjera. Në aksion kanë marrë pjesë punëtorët e administratës nga DSHP AIE, policia e Kosovës, nxënësit e shkollave, punëtorët e NPL "Dardana" sh.a. KL, dhe qytetarë vullnetarë. Pas grumbullimit të mbeturinave, kompania Ecobigjiena e ka bërë grumbullimin e thasëve me mbeturina, dhe të njëjtit i ka depozituar në depozitë qendrore në Velekinë. Është bërë edhe pastrimi i disa depozitave ilegale në disa lokalitete (në Berivojë, Muqiverc, në, Berivojë, në qytetin e Kamenicës te pishat, në Mogaqare te ura, si dhe disa vende në qytet ku janë eliminuar disa depozita të vogla). Aksioni për pastrim të depozitave ka vazhduar edhe ditëve tjera në vijim, ku me ngarkuesin e komunës është bërë pastrimi i depozitave tjera.

❖ Projektet në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizime, infrastrukture dhe të tjera

- **Pastrimi i lumenjve dhe i proçkave**, projekti e ka vlerën 150,000.00 €, është për periudhën tri vjeçare, punët kanë filluar në korrik të vitit 2025, ku janë kryer rreth 80 % të punëve pasi është vlerësuar se realizimi i këtij projekti është nevojë urgjente për pastrimin e lumenjve dhe proçkave, Pagesa deri më tani janë kryer 20,000.00 € ;

- **Ndërtimi i kanaleve të ujërave atmosferike – ri tenderim**. Vlera e projektit është 138,687.42€, e financuar nga Komuna. Punët janë kryer sipas planit dinamik, ku është kryer edhe pranimi teknik. Nga totali i pagesës janë edhe 13,712.42 € për pagesë;

- **Shpërndarja e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisoçkë**, projekti është i bashkë financuar nga ambasada Japoneze me 150,000.00€ dhe komuna e Kamenicës me 70,000€. Vlera totale e projektit është 220,000.00 €. Projekti është realizuar në tersi, ku kanë mbetur pa paguar edhe 35,000.00 €;

- **Mirëmbajtja e Kanalizimit**, Vlera e kësaj kontrate është 150,000.00 €, dhe është për një periudhë dy vjeçare. Për shkak të kërkesave që kanë të bëjnë me problemet e kanalizimit, sidomos në lokalitetet ku nuk është menaxhuar nga KRU “Hidromorava”, deri më tani është intervenuar në këto vende për rregullimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimit:

- **Te ShMLP “Andrea Durrsaku”**, vlera e pagesës 2,704.00 €;

- **Lagja Prekorogja në Busavatë**, vlera e pagesës 4,570.00 €;

- **Karagëvë e Epërme, rruga Fitorija**, vlera e pagesës 32,305.50 €;

- **Kamenicë, rruga “Dëshmorët e Kombit”**, vlera e pagesës 1,115.00 €;

- **Shkolla “Xhelal Sopi” në Petroc**, vlera e pagesës 14,702.50 €;

- **Busavatë, rruga “Guri i Busavatës”**, vlera e pagesës 4,500.00 €;

- **Koretin, te Stadiumi i fshatit**, vlera e pagesës 16,582.00 €;

- **Koretin, rruga “Lulishnja”**, lagja e Kovani, vlera e pagesës 7,580.00 €; dhe

- Në Rubroc të Lugu i Verdhë, vlera e pagesës 19,260.00 €;

Shuma totale e investimeve – realizimit të punëve nga kjo kontratë është 103,319.00 €. Pagesa është kryer në vlerë prej 1,000.00 €.

- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.** Vlera e këtij projekti është 23,992.33 €, projekti është realizuar sipas planit dinamik ku janë kryer edhe pagesat;
- **Projekti për Mirëmbajtjen e Ndriçimit Publik,** - kjo kontratë është mbyllur në qershor, ndërsa tani jemi në procedurë të prokurimit për nënshkrimin e kontratës së re. Vlera e këtij projekti është 30,000.00 €;
- **Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal,** projekti ka vlerën 100,000.00 € dhe është për periudhën dy vjeçare, për vitin 2025 dhe 2026. Në këtë vit është kryer sinjalizimi vertikal dhe horizontal në qytet dhe disa lokalitete tjera të komunës ku është vlerësuar nga komisioni përkatës. Vlen të ceket se në qytet janë vendosur shumë tabela informuese për të gjitha rrugët që hyjnë dhe dalin nga qyteti, si dhe është vendosur sinjalizimi horizontal në shumicën e rrugëve të qytetit. Nga 100,000.00€ sa është vlera e projektit deri më tani janë shpenzuar mbi 60 % e mjeteve, ndërsa nga punët e kryera janë pa paguar edhe rreth 22,000.00 €;

Tabela Nr. 2; Ndriçimi publik në territorin e Komunës së Kamenicës, sipas lokaliteteve

Nr.	Shtrirja e rrjetit të Ndriçimit publik sipas lokaliteteve		
	Lokalitetet	Trupa ndriçues (copë)	Gjatësia e rrjetit në (m)
1	Berivojë	126	5040
2	Bosçë	35	1400
3	Billatë	11	440
4	Busavatë	89	3560

5	Dajkoc	44	1760
6	Hajnoc	42	1680
7	Hodonoc	227	9080
8	Hogosht	163	6520
9	Kamenicë	898	35920
10	Karaqevë e Epërme	154	6160
11	Karaqevë e Poshtme	191	7640
12	Kolloleq	21	840
13	Kopernicë	110	4400
14	Koretin	301	12040
15	Krilevë	34	1360
16	Moçar	19	760
17	Muçiverc	221	8840
18	Novosellë	31	1240
19	Petroc	91	3640
20	Rogaçicë	304	12160
21	Ruboc	82	3280
22	Strezoc	67	2680

23	Shipashnicë e Epërme	124	4960
24	Shipashnicë e Poshtme	70	2800
25	Topanicë	319	12760
T O T A L I		3774 trupa	150,960.00 m

❖ Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve lokale

Kontrata e ka vlerën 750,000.00€, dhe është për një periudhë tri vjeçare. Kjo kontratë menaxhohet nga Drejtoria për Investime Kapitale, ku kërkesat e pranuar që kanë të bëjnë me këtë kontratë, procedohen te kjo drejtori për trajtimin e tyre.

❖ Transporti lokal, linjat urbane dhe urbane-periferike, dhënia e lejeve për Taxi

Në këtë periudhë të vitit nga muaji Korrik kemi dhënë vetëm rendin e udhëtimit për operatorët transportues të cilët bëjnë bartjen e ngrënësve ndërsa të tjerat janë dhënë në muajt paraprak. Sa i përket dhënies së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë për taksi, pas aprovimit të rregullores së re për taksa, tarifa dhe gjoha komunale ushtrimi i veprimtarisë për operatorët e Taksive është pa pagesë, andaj edhe nuk kemi pasur të hyra nga kjo fushë. Në këtë periudhë janë dhënë 12 leje për Taksi. Në tabelën në vijim do t'i paragesim të hyrat për secilin muaj për dhënien e rendit të udhëtimit për operatorët transportues:

Tabela nr. 3; Të hyrat nga harmonizimi i vijave për periudhën Korrik-Dhjetor.

Nr.	Numri i vijave të lëshuara dhe rendi i udhëtimit		Pagesa e rendit të udhëtimit në €
	Muaji	Numri i kërkesave	
1	Korrik	2	42.00
2	Gusht	/	/
3	Shtator	3	22.00

4	Tetor	/	/
5	Nëntor	/	/
6	Dhjetor	/	/
TOTALI		5	64.00 €

❖ **Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve**

Të hyrat nga regjistrimi i veturave për periudhën Korrik – Dhjetor 2024 dhe 2025, janë paraqitur në tabelën Nr.4. Përveç këtyre të hyrave, që do të paraqiten në tabelën e më poshtme ka edhe pagesa tjera ku bëhet shkarkimi i formularit drejtpërdrejtë nga kompanitë e sigurimeve gjatë regjistrimit të automjeteve, për të cilat ne nuk kemi të dhëna.

Tabela Nr. 4: Të hyrat nga regjistrimi i veturave (Korrik-Dhjetor 2024 dhe 2025)

Nr.	Muaji	Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve (EUR)			
		2024		2025	
		Nr. i Automjeteve	Pagesa në (€)	Nr. i Automjeteve	Pagesa në (€)
1	Korrik	947	9,490.00	1010	10,130.00
2	Gusht	754	7,550.00	725	7,265.00
3	Shtator	639	6,635.00	659	6,780.00
4	Tetor	735	7,535.00	764	7,870.00

5	Nëntor	599	6,100.00	/	/
6	Dhjetor	/	/	/	/
TOTALI		3674	37,310.00	3158	32,045.00€

Shënim: Të hyrat për muajin Nëntor dhe Dhjetor nuk janë të llogaritura.

❖ **Dhënia e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave tjera publike më pak se një vit**

Për dhënie e hapësirave publike Komunale është formuar komisioni përkatës për dhënie e pronave komunale më pak se një vit, ku bartës i komisionit është nga kjo drejtori. Në periudhën prej muajit korrik kemi pasur vetëm një kërkesë, e cila është trajtuar dhe është lëshuar leja përkatëse. Pagesa ka vlerën 345.00 €.

❖ **Kërkesat për ndërhyrje në infrastrukturë**

Përveç kërkesave të paraqitura në tabelën e më poshtme, ku kemi pasur të hyra nga lejet e lëshuara, kemi pasur edhe kërkesa tjera nga KRU Hidromorava dhe menaxherët e projekteve të Komunës, por të cilat sipas rregullores dhe marrëveshjes që ka komuna me KRU Hidromorava, të njëjtat nuk paguhen, andaj në tabelën e më poshtme do ti paragesim vetëm ato leje për të cilat kemi të hyra.

Tabela nr.5: Aplikimet dhe të hyrat në infrastrukturë

Nr.	Muaji	2025	
		Aplikacione	Të hyra në €
1	Korrik	1	71.50

2	Gusht	1	20.00
3	Shtator	/	/
4	Tetor	1	30.00
5	Nëntor	1	60.00
6	Dhjetor	/	/
TOTALI		4	181.50 €

❖ **Të hyrat nga Lejet Mjedisore komunale (LMK)**

Në periudhën Korrik – Dhjetor janë pranuar dhe trajtuar dy kërkesa për pajisje me LMK, ku njëra është e parashtruar nga institucionet komunale, dhe është pa pagesë, ndërsa tjetra e pranuar në muajin Nëntor është duke u trajtuar- në procedura të lëshuarjes së lejes. Në tab. e më poshtme do ti paraqesim këto të dhëna:

Tabela nr. 6; Aplikimet dhe të hyrat për LMK

Nr.	Muaji	2025	
		Aplikacione	Të hyra në €
1	Korrik	/	/
2	Gusht	/	/
3	Shtator	1	/
4	Tetor	/	/
5	Nëntor	1	/

6	Dhjetor	/	/
TOTALI		2	€

Shënim: Muaji dhjetor nuk është llogaritur.

❖ Të hyrat e përgjithshme

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia për periudhën Korrik – Nëntor 2025, ka arritur të inkasoj të hyrat nga shërbimet e ndryshme, si në tabelën e mëposhtme.

Tabela Nr. 7: Të hyrat nga shërbimet e DSHPAIE për periudhën Korrik – Nëntor

Nr.	Pagesat sipas kategorive të caktuara	2025
1	Harmonizim i vijave	64.00
2	Taksat për regjistrimin e automjeteve	32,045.00
3	Shfrytëzimi i hapësirave publike	345.00
4	Leje Mjedisore Komunale (LMK)	0.00
5	Të hyra nga kioskat dhe garazhet	0.00
6	Lejet për ndërhyrje në infrastrukturë dhe të tjera	181.50
Totali		32,635.50

Shënim: Ka edhe të hyra tjera te regjistrimi i automjeteve, por që ne nuk kemi të dhëna deri në përfundim të vitit pasi që formularët për pagesën e taksës komunale për regjistrim të automjeteve bëhet drejtpërdrejtë nga kompanitë e sigurimeve, andaj për rastet e tilla nuk kemi të dhëna.

❖ Menaxhimi i shpenzimeve komunale: energjisë elektrike, ndriçimi publik, ujësjellës, mbeturina dhe telefoni fikse

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit ka menaxhuar harxhimet e shërbimeve komunale, të cilat për periudhën raportuese Korrik – Dhjetor 2025, do ti paragesim në tabelën Nr: 8.

Tabela Nr. 8; Shpenzimet komunale (Korrik - Dhjetor 2025)

Muaji	Rryma Administrata	Ndriçimi Publik	Uji	Telefonia fikse	Mbeturinat	Totali
Korrik	2,769.12	8,840.48	123.44	118.33	207.00	12,058.37
Gusht	2,599.56	7,466.90	317.06	116.93	176.00	10,676.45
Shtator	2,352.18	10,244.03	281.91	116.94	331.00	13,326.06
Tetor	4,383.43	12,305.50	406.73	117.90	331.00	17,544.56
Nëntor	/	/	/	/	/	/
Dhjetor	/	/	/	/	/	/
TOTALI	12,104.29	38,856.91	1,129.14	470.10	1,045.00	53,605.44

Të dhënat për muajin Nëntor dhe Dhjetor nuk janë pranuar akoma, pasi ato vijnë pas përfundimit të muajit.

❖ Menaxhimi i mbeturinave dhe zgjerimi i rrjetit të mbeturinave nëpër lokalitete

Barja dhe transporti i mbeturinave bëhet nga ndërmarrjes “Ecohigjiena”. Në kuadër të realizimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave kemi vazhduar zgjerimin e rrjetit duke i furnizuar qytetarët me kontejner 120 L, ku secili qytetar pas pranimit të kontejnerit ka nënshkruar kontratë me kompaninë Ecohigjiena, e cila e bën grumbullimin e mbeturinave. Sa i përket zgjerimit të rrjetit të

mbeturinave, kemi planifikuar disa veprime lidhur me menaxhimin e mbeturinave, konkretisht zgjerimin e rrejtë të shërbimit ku kemi pasur një koordinim dhe bashkëpunim me kryetarët e KL, të cilët na kanë përkrahur si në finalizimin e listave ashtu edhe në organizimin e takimeve me qytetarët, ku ata janë njoftuar me PKMM, dhe Rregulloren Komunale për MM.

Në tabelën e më poshtme do të paraqesin veprimet e planifikuara, si dhe ato të realizuara lidhur me menaxhimin e mbeturinave:

Tabela Nr. 9; Veprimet e Planifikuara dhe të realizuara për menaxhimin e mbeturinave, sipas Lokaliteteve në vitin 2025

Nr.	Veprimet e planifikuara për MM	Numri i veprimeve të realizuara për periudhën Janar-Tetor 2025		
	Lokali	Lokali	Data e mbyjtes së aktivitetit	Nr. i konsumatorëve të rinj
1	Petroc	Petroc, shkolla	03.02.2025	11
2	Mugivërc	Mugivërc, shkolla	06.03.2025	20
3	Kamenicë	Gjinnazi, Kamenicë	07.04.2025	100
4	Karagëvë e Po.	Karagëvë e Poshtme	11.04.2025	10
5	Karagëvë e Ep.	Karagëvë e Ep.	11.04.2025	5
6	Berivojë	Shkolla, Berivojë	11.06.2025	17
7	Rogaqicë	Rogaqicë	13.06.2025	29
8	Topanicë	Shkolla, Topanicë	04.07.2025	31
9	Grizime	Grizime	07.07.2025	1
10	Shipashnicë e Po.	Shkolla, Shipashnicë e Po.	08.07.2025	27
11	Shipashnicë e Ep.	Shkolla, Shipashnicë e Ep.	08.07.2025	18

12	Krilevë	Shkolla, Krilevë	11.07.2025	1
13	Hogosht	Shkolla, Hogosht	14.07.2025	15
14	Koretin	Shkolla, Koretin	15.07.2025	37
15	Kopërmicë	Shkolla, Kopërmicë	20.07.2025	18
16	Dajkoc	Shkolla, Dajkoc	07.08.2025	4
17	Hodonoc	Shkolla, Hodonoc	05.10.2025	39
18	Busavatë	Shkolla, Busavatë	19.10.2025	3
19	Regane	Regan	16.06.2025	8
20	Tugjiec	Tugjiec	09.05.2025	1
21	Novosellë	Novosellë	06.08.2025	5
TOTALI				400

Nga tabela me të dhëna duket se në këtë periudhë të vitit 2025 i kemi planifikuar **21** veprime për menaxhimin e mbeturinave, ku janë realizuar të gjitha **21** veprimet për menaxhimin e mbeturinave. Rrjeti i grumbullimit të mbeturinave në këtë vit është zgjeruar për **400** klient të ri, ku prej tyre **386** janë **EF** (ekonomi familjare), ndërsa **14** janë biznese.

Tabela Nr.10; Numri i EF, Bizneseve dhe Institucioneve të përfshira në Sistemin e grumbullimit të mbeturinave nga viti 2019 deri në 2025

Nr	Lokaliteti	Numri i konsumatorëve sipas lokaliteteve dhe viteve						
		2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
.								

1	Berivojë	173	217	224	255	262	266	283
2	Bosë	2	2	31	31	31	30	30
3	Busavatë	23	21	24	41	58	62	65
4	Dajkoc	15	17	20	20	81	82	86
5	Hajnoc	57	104	104	104	104	103	103
6	Hodonc	151	158	174	183	194	210	249
7	Hogosh	54	306	311	313	345	349	364
8	Kamenicë	1470	1445	1529	1555	1591	1678	1778
9	Karagëvë e Ep.	4	304	308	308	309	310	315
10	Karagëvë e Po.	67	87	95	122	151	155	165
11	Kolloleq	2	2	48	51	54	54	54
12	Kopërmicë	115	104	108	117	126	136	154
13	Koretin	367	449	463	481	501	509	546
14	Krilevë	11	19	20	23	26	27	28
15	Muqivërc	82	200	214	219	270	277	297
16	Novosellë	28	21	23	23	24	24	25
17	Petroc	147	115	121	131	147	148	159
18	Poliqkë	/	2	2	2	2	2	2

19	Rogaqicë	262	317	343	360	370	399	428
20	Ruboc	59	95	95	101	103	103	107
21	Strezoc	8	8	8	15	17	17	18
22	Shipashnicë e Ep.	218	190	194	202	210	210	228
23	Shipashnicë e Po.	4	110	117	122	127	129	156
24	Topanicë	142	262	307	337	352	364	395
25	Mogarë	/	/	32	33	34	34	34
26	Billatë	/	/	/	/	6	6	6
27	Gmicë	/	/	/	/	/	1	1
28	Zajqec	/	/	/	/	/	1	1
29	Velegllav	/	/	/	/	/	1	1
30	Grizime	/	/	/	/	/	1	1
31	Regan							8
32	Tugjcc							1
TOTALI		3461	4555	4915	5149	5495	5688	6088

Në vitin 2025 janë planifikuar **254** ditë për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa në fund të muajit Dhjetor do të bëjmë llogaritjen totale për vitin 2025. Në komunën e Kamenicës sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024 janë **22868** banorë, apo **5940** ekonomi familjare. Numri i bizneseve të regjistruara është **1077** biznese, prej tyre **602** ekonomi biznesi janë aktive, dhe **59** institucione publike.

Nga shuma totale e klientëve që pranojnë sistemin e mbeturinave, nga **6088** konsumatorë, prej tyre janë **5505 EF** (ekonomi familjare), **524** ekonomi biznesi dhe **59** janë institucione publike. Në këtë vit deri në periudhën Janar-Tetor 2025 janë deponuar **3,749.37** ton mbeturina.

Në tabelën e më poshtme do të parqesim sasinë e grumbullimit të mbeturinave për vitin 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025.

Tabela Nr. 11: Sasia e mbeturinave të grumbulluara gjatë viteve 2021- 2025

Nr.	Muaji	Sasia e mbeturinave të grumbulluara (t)				
		2021	2022	2023	2024	2025
1	Janar	379.36	371.08	377.16	399,1	273,72
2	Shkurt	349.95	352.79	251.12	304,06	304,14
3	Mars	417.76	398.24	299.46	356,02	394,44
4	Prill	383.14	397.90	298.40	411,18	455,38
5	Maj	458.64	455.80	464.10	448,64	444,40
6	Qershor	470.58	644.08	523.30	404,6	428,22
7	Korrik	564.98	518.44	515.10	641,84	555,40
8	Gusht	637.86	592.68	631.92	631,96	450,66
9	Shtator	527.66	551.86	459.58	553,19	443,01
10	Tetor	449.82	462.42	449.43	618,64	-----

11	Nëntor	443.26	427.86	422.72	378,18	-----
12	Dhjetor	410.54	381.78	368.52	396,63	-----
T o t a l i (t)		5,493.55 t	5,554.93 t	5,060.81 t	5,544,04	3,749,37

Vërejtje: Sasia e mbeturinave për muajin Tetor, Nëntor dhe Dhjetor do të llogaritet në fund të muajit Dhjetor.

❖ Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza

Furnizimi me ujë bëhet nga KRU “Hidromorava”, e cila deri më tani i ka menaxhuar shumicën e ujësjellësve, ndërsa menaxhimi i kanalizimeve është bërë vetëm në qytetin e Kamenicës dhe në Berivojë dhe Ruboc. Tani në muajin Tetor të këtij viti është nënshkruar marrëveshja në mes kompanisë KRU “Hidromorava” dhe kryetarit të Komunës për marrje në menaxhim edhe të ujësjellësve dhe kanalizimeve në disa lokalitete tjera, në Koretin, Kopernicë, Shpashnicë e Epërme, Topanicë, Karagëvë e Poshme dhe Kololeq janë marrë nën menaxhim kanalizimet pasi ujësjellësit i ka menaxhuar KRU “Hidromorava”, ndërsa në lokalitetet Muqiverc, Dajkoc, Rogaqicë, Shpashnicë e Poshme, Novosellë dhe hodonoc, janë marrë në menaxhim edhe ujësjellësit edhe kanalizimi. Në tabelën e më poshtme do të paraqesim të dhënat sipas lokaliteteve të ujësjellësve dhe kanalizimeve që menaxhohen nga KRU Hidromorava.

Tabela Nr. 12; Lokalizimet e furnizuara me ujë nga KRU. “Hidromorava”

Lokalizimet që menaxhohen nga KRU “Hidromorava”			
Nr.	Ujësjiellësit	Kanalizimet	
1	Kamenicë	Kamenicë	
2	Berivojë	Berivojë	
3	Ruboc	Ruboc	

4	Koretin	Koretin
5	Topanicë	Topanicë
6	Kopernicë	Kopernicë
7	Kolloleq	Kolloleq
8	Shipashnicë e Epërme	Karaçevë e Epërme
9	Karaçevë e Poshtme	Karaçevë e Poshtme
10	Rogaqicë	Rogaqicë
11	Muqiverc	Muqiverc
12	Dajkoc	Dajkoc
13	Shipashnicë e Poshtme	Shipashnicë e Poshtme
14	Novosellë	Novosellë
15	Hodonoc	Hodonoc

Në vazhdim do të paragesim tabelat në lidhje me ecurinë e furnizimit dhe inkasimit të ujit për secilin lokalitet i cili menaxhohet nga KRU “Hidromorava” .

Tabela nr. 13; Ujësjetësi në Fshatin Topanicë

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve e/defekt
KORRIK	10209	7621	3,878.67	3,783.21	25.35	97.54	2

GUSHT	8370	5906	3128	3,570.15	29.44	114.14	4
SHTATOR	6580	5397	2,852.61	3,094.59	17.98	108.48	4
TETOR	5330	3836	2,672.24	2,463.95	28.03	92.21	0
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/
Totali:	30489 m³	22760 m³	12,531.52 €	12,911.9 €	/	/	10

**Tab. Nr.14; Ujësjetësi në Fshatin
Karagjevë e Poshtme**

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve e/defekt
KORRIK	3548	1372	812.8	1,046.56	61.33	128.76	6
GUSHT	3234	2012	1,112.78	1,173.66	37.79	105.47	6
SHTATOR	2476	1719	961.51	1,007.31	30.57	104.76	10
TETOR	1883	1131	856.9	876	39.94	102.23	1
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/
Totali:	11141 m³	6234 m³	3,743.99 €	4,103.53 €	/	/	23

Tab. Nr.15; Ujësjetësi në Kopernicë dhe Kolloleq

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve/defekt
KORRIK	7050	2588	1,427.25	1,723.98	63.29	120.79	8
GUSHT	5790	2075	1,234.38	1,201.86	64.16	97.37	3
SHTATOR	5380	2365	1,339.75	1,058.05	56.04	78.97	4
TETOR	2210	2019	1,487.67	1,036.57	8.64	69.68	3
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/
Totali:	20430 m³	9047 m³	5,489.05 €	5,020.46 €	/	/	18

**Tab.Nr.16;Ujësjetësi
Koretin**

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve/defekt
KORRIK	13044	3851	2,163.18	2,965.56	70.48	137.09	3

GUSHT	7440	4382	2,507.1	2,858.13	41.10	114.00	6
SHTATOR	6790	3898	2,124.98	1,763.24	42.59	82.98	2
TETOR	5400	2646	2,246.71	1,926.52	51.00	85.75	2
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/
Totali:	32674 m³	14777 m³	9,041.97 €	9,513.45 €	/	/	13

Tab. Nr.17; Ujësjetësi në Shpashnicë e Epërme

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve/defekt
KORRIK	4380	2733	1,537.39	1,608.99	37.60	104.66	2
GUSHT	11540	2167	1,207.71	1,047.74	81.22	86.75	2
SHTATOR	10700	2330	1,379.53	1,236.47	78.22	89.63	1
TETOR	8308	2391	1,642.15	1,097.78	71.22	66.85	2
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/

Totali:	34928 m³	9621 m³	5,766.78 €	4,990.98 €	/	/	7
----------------	----------------------------	---------------------------	-------------------	-------------------	----------	----------	----------

Tab. Nr.18; Ujësillësi në Qytetin e Kamenicës

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në %	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve/defekteve
KORRIK	67888	28682	19,524.34	19,601.08	57.75	100.39	24
GUSHT	64305	31473	23,689.37	21,932.76	51.06	92.58	13
SHTATOR	57721	28332	19,335.84	15,482.15	50.92	80.07	18
TETOR	47996	25592	18,136.23	17,159.12	46.68	94.61	23
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/
Totali:	237910 m³	114079 m³	80,685.78 €	74,175.11 €	/	/	78

Tab. Nr.19; Ujësillësi në Fshatra dhe Qytetin e Kamenicës sipas muajve

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbje t e Ujit në %	Inkasimi në %	Evitimi i rrjedhjeve/defekteve
KORRIK	106119	46847	29,343.63	30,729.38	55.85	104.72	45
GUSHT	100679	48015	32,879.34	31,784.3	52.31	96.67	34
SHTATOR	89647	44041	27,994.22	23,641.81	50.87	84.45	39
TETOR	71127	37615	27,041.9	24,559.94	47.12	90.82	31
NËNTOR	/	/	/	/	/	/	/
DHJETOR	/	/	/	/	/	/	/
Totali:	367572 m³	176518 m³	117,259.09 €	110,715.43 €	/	/	149

Tab. nr.20, Rekapitullimi i Ujësjetësve në fshatra dhe Qytetin e Kamenicës

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në %	Inkasimi në %
Janar-Dhjetor	367572 m³	176518 m³	117,259.09 €	110,715.43 €	51.98 %	94.42 %

2. SEKTORI I EMERGJENCAVE

Sektori i Emergjencave gjatë kësaj periudhe ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e Komunës së Kamenicës dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët vartës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas Planit të Punës për vitin 2025, në përputhshmëri me ligjin 04/L-027 “Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera”, udhëzimet administrative dhe rregulloret që janë në fuqi. Të gjithë sektorët e kësaj drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e parapara me kohë dhe me sukses.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur situatë Emergjente për të cilat ka pasur nevojë aktivizimi i Shtabit Emergjent Komunal.

Kjo periudhë karakterizohet me Raste Emergjente apo Fatkeqësitë Natyrore, përhapja e zjarreve, vërshimeve dhe erërave të forta(stuhi) që mund të kenë goditur territorin e Komunës së Kamenicës.

- ✦ Menaxhimi i përhapjes së zjarrit dhe ekipeve të terrenit;
- ✦ Përgjegjëse e ndreqe.com;
- ✦ Shqyrtuese e kërkesave dhe qasjes në intranet;
- ✦ Menaxhimi i performancës komunale për Sektorin e Emergjencave;
- ✦ Menaxhimi i kontratave të Air-Energy dhe SGE;
- ✦ Anëtare e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- ✦ Kryesuese e komisionit për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
- ✦ Inspektrimin e Rasteve Emergjente si dhe hulumtimin e shkaktarëve të rreziqeve nga FNFT.
- ✦ Vlerësimi i shtrretëve të humenive;
- ✦ Evidentimi dhe planifikimi i rrezikut pas vlerësimit të rrezikut nga plepat/drujtë;

- ✚ Intervenim me ngarkues në Roganë, Hogosht, Bujnoc, Vriqec, Sedllar, Hogosht, Karagevë, Strezoc, Firiqevë, Sifrcë, Ruboc, Gregjenik, Rahoviqë, Topanicë, Busavat, Zajqec, Krenidell, Novosellë, Tuxhec, Shipashnicë e Poshtme dhe Shipashnicë e Eperme, Veleglavë, Gmicë po edhe ne lokalitete tjera,
- ✚ Shpërndarja e njoftimeve kundër zjarrit;
- ✚ Vlerësimin e objekteve të dëmtuara, të rrezikuara për banim;
- ✚ Zyrtaret e Vlerësimit dhe Planifikimit Emergjente edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shkatarrëve të rezikut, evidentimin dhe parandalimin e tyre, si dhe hartimin e planeve relevante operative Emergjente.

Vlen të ceket se në këtë sektor është si një sfidë, mungesa e Fondit Emergjent.

➤ Kërkesat e qytetarëve

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia – ka pranuar kërkesa përmes qendrës për shërbime me qytetar, nga qytetarët ku duke u bazuar në ligjet aplikueshme, aktet tjera nënligjore, rregulloret komunale dhe vendimit mbi kompetencat e drejtorive të administratës komunale ka trajtuar kërkesat e pranuar si në vijim:

Tabela Nr. 21: Aktivitetet e DSHPAI sipas kërkesave të qytetarëve Korrik - Dhjetor

Nr.	Aktiviteti	2025
1	Kërkesa të pranuar	214
2	Kërkesa me përgjigje pozitive	96

3	Kërkesa me përgjigje negative	62
4	Kërkesa të hartura në institucione tjera	20
5	Kërkesa në procedurë	36

Shtatën Kërkesat janë vetëm për periudhën Korrik – Nëntor

Përveç kërkesave të pranuarra përmes qendrës së shërbimit për qytetar, drejtoritë ka pranuar edhe kërkesa tjera përmes emailit, si dhe gjatë takimeve që kemi pasur në formë të ndryshme, nga këshillat lokale, shkollat, kuvendi Komunal, policia e Kosovës, dhe institucione tjera Komonale dhe qendrore, ku janë të trajnuara të gjitha sipas ligjit. Në drejtorinë tonë janë menaxhuar edhe kontratat që kanë të bëjnë me fushat tona përkatëse. Nga zyrtari i lartë hidroprojekt janë menaxhuar projektet në fushën e ujësjellësit dhe kanalizimit, ku është bërë përcjellja e përditshme e punëve të këto projekte. Gjithashtu edhe zyrtarët tjerë të caktuar me vendim të kryetarit në cilësinë e menaxherit të kontratave, i kanë kryer të gjitha detyrat e caktuara deri në përfundimin e projekteve.

Në këtë periudhë jemi duke hartuar edhe PNMIM (Plani Ndër komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturisë), për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Për këtë planë përveç takimeve dhe punëtorive që janë mbajtur në vende të ndryshme në komunat e këtij rajoni, zyrtarët nga kjo drejtori, z. Hysen Jerliu dhe z. Sami Morina kanë marrë pjesë edhe në një vizitë studimore në republikën e Sllovenisë, në Lubjanë ku janë vizituar Komuna e Lubjanës, Ministria për ambient, dhe ndërmarrje tjera publike të cilat kanë lidhshmëri me planin përkatës. Gjithashtu këta zyrtarë kanë marrë pjesë edhe në konferencën ndërkombëtare për Ekonomi Qarkore, e mbajtur në Lubjanë. Kjo vizitë është organizuar nga GIZ, nga data 8 deri më 12 shtator 2025. Pas kësaj vizite në Lubjanë, z. Hysen Jerliu ka marrë pjesë në një punëtori tri ditore për hartimin e këtij plani, më datë 18 deri 20 Nëntor që është mbajtur në Pejë.

Në kuadër të hartimit të rregulloreve nga kjo drejtori janë punuar disa rregullore komunale, ku stafi jonë ka është caktuar kryesues i këtyre ekipeve për finalizimin e tyre, ne po i cekim disa nga to:

Plotësim ndryshimi e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe gjoha, kryesues është z. Hysen Jerliu. Kjo rregullore i ka kryer të gjitha procedurat dhe tani pritet që ajo të kalojë në asambleenë komunale për aprovim.

Rregullorja për Mbrojtje nga Ndojtja Akustike në sektorin e gastronomisë, kryesues i komisionit është z. Sami Morina. Kjo rregullore është në fazën e finalizimit, dhe pas kryerjes së procedurave, do të shkojë në kuvend për aprovim.

Rregullorja për Shërbime Publike, kryesues është z. Zotrim Kastrioti. Kjo rregullore është finalizuar, dhe pritet që të aprovohet në kuvend.

Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, në përkatje të UN Habitatit është duke u përgatitur drafti, kryesues i komisionit është z.Besim Morina. Zyrtarët e drejtorisë z.Hysen Jerihu, dhe z.Besim Morina kanë marrë pjesë në një vizitë në komunën e Vushtrisë, ku janë njoftuar nga afër me përvojën e kësaj komune për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban. Takimi është organizuar nga UN Habitat, dhe Komuna e Vushtrisë.

Përveç këtyre rregulloreve dhe detyrave tjera, zyrtarët e drejtorisë janë të caktuar me vendim nga kryetari i Komunës për Intervistimin e staffit sipas konkurseve të shpallura. Gjithashtu përveç konkurseve të Komunës zyrtari nga kjo drejtori në shumicën e rasteve merre pjesë në intervistimin e staffit të NPL “Dardana” sh.a.

Edhe në komisione për hapjen dhe vlerësimin e ofertave nga zyra e prokurimit, zyrtarët nga kjo drejtori marrin pjesë sipas vendimeve të caktuara nga kryetari i komunës.

3. SEKTORI I INSPEKTORIATIT

Inspektori i Mjedisit

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me inspektimet në fushën e Inspektorit të Mjedisit, si dhe inspektimet tjera grupe për Gjashtë mujin e Dytë - 01.07-2025- 30.11.2025

Lloji i veprimtarisë	Periudha kohore	Shuma në € të paguara
Inspektime ne fushën e mjedisit	72	
Inspektime grupe me Inspektorët Komunal – Ndërtimit, Tregut , Komunikacionit etj.	64	
Procesverbale	16	

Vendime-Aktvendime	06	
Gjoha mandatorë dhe administrative	06	
Vlera e mjeteve nga këto gjoha	740	
Fletëparaqitje te përmbanesi privat	00	
Kërkesa të shqyrtuara	16	
Urdhëresa për pajisje me Leje për shfrytëzimin e Hapësirës Publike .	08	

Pjesa më e madhe e inspektimeve kanë të bëjnë me zbatimin e masave ne baze te Rregulloreve Komunale ne bashkëpunim me inspektorin e Ndërtimit, Tregut, Komunikacionit etj.

Inspektori i Komunikacionit

Në këtë periudhë tremujore, përveç punëve dhe detyrave që kanë të bëjnë me fushën e komunikacionit, kemi kryer edhe detyra tjera në kuadër të drejtorisë, në mungesë të stafi përkatës. Gjithashtu për veç në fushën e komunikacionit, kemi kryer edhe inspektime tjera të përbashkëta – grupe me inspektorët e fushave tjera, si në fushën e mjedisit, tregut dhe në fushën e ndërtimit.

Kryejtja e punëve në fushën e komunikacionit.

Në këtë fushë kemi kryer detyrat tona të përditshme duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret të cilat janë në fuqi.

Kemi inspektuar operatorët të cilët e zhvillojnë veprimtarinë e Taksive duke mbuluar të gjithë territorin e komunës së Kamenicës. Përveq qytetit të Kamenicës kemi pasur edhe inspektime në Rogajicë, Hogsot, Karageve, dhe vende tjera , ku edhe kemi pasur ankesa nga qytetarët për ushtrimin e veprimtarisë së Taksive në mënyrë ilegale. Gjatë kësaj kohe kemi arritur që një numër të konsiderueshëm të taksive ilegale të i rekomandojmë pajisje me leje përkatëse. Personat që nuk kanë pasë leje, janë njoftuar me procedurat dhe kriteret për marrjen e lejes, e cila është pa pagesë, dhe të njëjtit kanë filluar të pajisen me leje përkatëse. Gjatë kësaj periudhe janë pajisur me leje për Taksi 12 operator.

Përveç fushës së inspektorit të komunikacionit, kemi shqërtuar edhe inspektorët e fushave tjera në inspektime të përbashkëta me inspektorin e mjedisit dhe inspektorin e tregut, ku i njëjti e ka mbuluar edhe fushën e inspektorit të ndërtimit. Gjithashtu të gjithë operatorëve që janë pajisur me leje të Taksive janë kontrolluar dhe verifikuar për posedimin e aparatit të zjarrfikësve dhe taksimetrit, ku pas verifikimit janë pajisur me procesverbal për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë Taksi. Edhe operatorët transportues për mbulimin e vijave për transportin e udhëtarëve, dhe bartjen e nxënësve gjithashtu janë kontrolluar dhe të njëjtit janë pajisur me procesverbale për pajisje me leje.

Për veç këtyre, në koordinim edhe me policinë e Kosovës, stacioni në Kamenicë, kemi pasur inspektime të operatorëve që bëjnë bartjen e nxënësve në shkolla, që të funksionojnë sipas ligjeve dhe të verifikohet numri nxënësve, dhe kushtet me të cilat bëhet transporti. Pas inspektimeve nuk është vërejtur ndonjë shkelje te operatorët transportues.

Gjatë periudhës 11 Shtator deri më 10 tetor kamë kryer edhe detyrat e inspektorit të Tregut dhe Ndërtimit, pasi i njëjti ishte në pushim vijtor. Kemi pasur inspektimi në disa lokalitete, ku në dy raste kemi hasur në ndërtime pa leje, ku përmes procesverbalit kemi ndërpre punimet dhe kemi marrë masat ligjore ku qytetarët janë rekomanduar të pajisen me leje përkatëse të ndërtimit. Po ashtu në këtë fushë janë shqiptuar dy gjopa mandatorë. Mbulimi i kësaj fushë ka përfunduar me 10 Tetor, ku pas përfundimit të pushimit nga inspektorit përkatës, të njëjtit i janë dorëzuar procesverbalet dhe dokumentacioni tjetër përkatës.

Nga data 12.09, deri më 3.10, gjithashtu jam autorizuar ti kryej detyrat e inspektorit të mjedisit pasi i njëjti ka shkuar në pushim vijtor. Gjatë kësaj periudhe në bazë të kërkesave të qytetarëve kemi dalë në terren dhe kemi inspektuar lokalitete të ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kam asistuar kolegun Hysen Jerliu, në caktimin e vendeve për vendosjen e signalizimit vertikal dhe horizontal, që edhe tani jemi duke finalizuar këtë projekt. Kemi pasur edhe një kërkesë nga policia e Kosovës për largimin e një druri në Berivojë i cili shkaktonte probleme në komunikacion, ku pas kryejtes së procedurave dhe nën vëzhgimin e policisë së Kosovës i njëjti është larguar me ndihmën e NPL "Dardana" sh.a.

Gjatë periudhës kemi pasur edhe dy trajnime në zyrën e inspektorit të përgjithshëm në Prishtinë, ku është trajtuar tema për digjitalizimin e procesverbaleve dhe gjobave mandatorë për të gjitha kategoritë e Inspektorëve.

Në tabelën e më poshtme do të paragesim në mënyrë tabelare numrin e procesverbaleve dhe gjobave mandatorë sipas fushave përkatëse në fushën e komunikacionit, si dhe inspektimet tjera grupore për pesë mujorin e dytë - 01.07/2025 - 30.11/2025.

Lloji i veprimtarisë	Periudha kohore Korrik - Nëntor
Inspektime ne fushën e Komunikacionit	18
Procesverbale për pajisje me leje - Auto taksi	15
Vendime - Aktivendime për gjoba	4
Inspektime grupore në fushën e Nderimit, Tregut , Mjedisit etj.	38
Gjوبا mandatore dhe administrative në komunikacion	4
Gjوبا mandatore në fushën e nderimit	2
Procesverbale mbi Pranimin Teknik të Automjeteve për pajisje me Leje për Veprimtarinë Taxi të Udhëtarëve	15
Vlera e mjeteve nga gjობat mandatore	1350 euro
Kërkesa të shqyrtuara	09

Përveç punëve të cekura më lartë kemi trajtuar edhe kërkesa të ndryshme të paraqitura përmes emailit dhe kërkesa gojore të kërkuara nga drejtori, dhe udhëheqësi i Inspektoratit të cilat janë trajtuar.

Gjithashtu jam edhe mbikëqyrës i menaxherit të kontratës “Nderimi i impiantit për trajtimin e mbeturinave organike – Kamenicë (Qendra e Kompostimit për menaxhimin garkor të mbeturinave organike në Kamenicë”, si dhe në projektin “Pastrimi i lumenjve dhe proçkave”.

Një ashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur dy takime punuese për hartimin e planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban në Qytetin e Kamenicës un si Kryesues i komisionit së bashku me kolegë si dhe së bashku me UN-Habitat KOSOVA.

Inspektori i Tregut dhe i ndërtimit

Nr.	Aktiviteti, punët e kryera për muajin Qershor-Nëntor 2025	Apikimet për Pëlqime-Vendim		Pëlqime të lëshuara		Vlera totale (€)	Personi përgjegjës
		Nr. aplikimeve	Të refuzuara	Nr. i Pëlqimeve, Vendimeve të lëshuara	Vlera në €		
1	Kerkesat e OE për Pëlqim-Vendim	3		3	60.00€	60.00€	Enver Ismajli
2	Urdhëres për regjistrim të subjektit afarist. Ndajm i përkohshëm i veprimtarisë.	1 2		1 2			Enver Ismajli
3	Ankesa per mbrojtje te Konsumatoreve						
4	1. Gjyba mandatorë me Vendim.	4=1500.00€		4	3=1250.00 €x50%=625.00€	3=625.00€	

	2. Kallzim penal.	3. Kallzime Penal Prokurori	3 Gjoha te paguara. 1 gjoha te papaguara.	1=250.00		Enver Ismajli
	3. Përmbaruesi Privat					
5	Vendimet e Ndërtimit	8	8			1.Enver Ismajli
	Totali				685.00€	Enver Ismajli

- Me datë; 21.05.2025 jam caktuar në kryerjen e punëve dhe detyrave inspektor i ndërtimit, me kërkesë të Drejtorit të DSHPAIE z. Zotrim Kasirati, përkundrazi që jam caktuar në këtë detyrë përkohësisht, një herit nga ana profesionale nuk jam as i përafërt për kryerjen e punëve dhe detyrave të inspektorit të ndërtimit.
- Nga kërkesa e Operatorëve Ekonomik janë inkasuar gjithsejtë 60.00€ të cilat janë pajisur me Vendim-Pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë.

- Gjobat janë shqiptuar në kuadër të parregullsive të Operatorëve Ekonomik dhe Ndërtimore, ku janë realizuar të hyra 625.00€ dhe kam bërë tri(3) kallëzime penale në Prokurorin Themelore në Gjilan, ndërsa 1 gjoba nuk janë paguar ende në vlerë prej 250.00€

- **Njoftim:** Vendimi Sh. 10 nr.20414 dt. 31.07.2025. Afat 30 ditë për tërënim vullnetar në fshatin Topanice në pronë publike.
- Kërkesë; Sh. 09 nr.20415 dt. 31.07.2025. Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronësi.

Për verifikim të pronës publike, ende nuk kam përgjigjeje.

Një herit në koordinim me kolegët kemi bërë inspektime të ndryshme në kuadër të detyrave dhe kompetencave ligjore.

➤ **Bashkëpunimi i Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambientit, Inspektoratit dhe Emergjencia me Institucione tjera**

Bashkëpunimi me institucione tjera Qendrore dhe Lokale gjithashtu ka një rëndësi të veçantë për DSHPALE, pasi kjo ndikon në përmirësimin e jetës së qytetarit dhe po ashtu e bën më të lehtë funksionimin dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet tjera, mundë ti cekim bashkëpunimet si në vijim:

- Takime me nivelin qendror, Ministri të linjës së Republikës së Kosovës;
- Takime të rregullta me AKK;
- Takime të rregullta me KRU “Hidromorava”;
- Takime me ndërmarrjen “Ecoligjiena”, ku kemi kërkuar edhe shtirjen e rjetës së grumbullimit të mbeturinave edhe nëpër lokalitete tjera, si dhe çështje tjera me interes të qytetarëve të Komunës së Kamenicës;
- Takime me Policinë e Kosovës, stacioni në Kamenicë, ku kemi kërkuar bashkëpunim në mes institucioneve tona si dhe përkatëje në inspektime të ndryshme në terren;
- Disa takime me përfaqësuesit e KEDS,
- Takime me GIZ, në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbeturinave, hartimin e PINKMM, etj.

- Kemi edhe kontakte të drejtpërdrejta me qytetar, të cilët priten në zyrat tona nga drejtori dhe udhëheqësit e sektorëve për trajtimin e kërkesave të tyre, dhe zgjidhjen e problemeve të fushave të ndryshme.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor:

Në këtë periudhë kohore **Janar - Dhjetor 2025**, në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor janë zhvilluar keto aktivitete:

- **Takime të rregullta pune** me tërë stafin e drejtorisë, me qëllim të organizimit, planifikimit dhe koordinimit të punëve dhe detyrave.
- **Mbikëqyrja e ndërtimit të projekteve të infrastrukturës në Komunën e Kamenicës**, investime nga buxheti komunal dhe donacione të ndryshme.
- **Pjesëmarrja në komisionet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për ndërtimin e objekteve me interes të përgjithshëm.**
- **Pjesëmarrja në komisionin për kontrollin dhe pranimin teknik të objekteve të ndërtuara dhe objekteve me interes të përgjithshëm.**
- **Puna në Komisionin Komunal për shqyrtimin e ankesave për taksat komunale.**
- **Angazhimi në ekipin planifikues (Planerët Urbanë), Ekipa Komunale për Planifikim Urban, si dhe hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).**
- **Pjesëmarrja në komisione për përgatitjen e akteve komunale – Rregulloreve komunale.**
- **Konsultime të ndryshme me palët, etj**
- **Shqyrtimi i çdo kërkesë për ndërtim në procedurë të rregullt administrative, ku janë pranuar gjithësej 253 kërkesa, ankesa dhe parashtrësa të ndryshme si në vijim:**

- Kërkesa për leje ndërtimore (ndërtim, renovim)	39
- Kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimore	57
- Kërkesa për certifikatë të përdorimit të objektit	4
- Kërkesa për leje rënimi të objektit	3
- Kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje	28
- Kërkesa për Ekstrakt, verifikim të parcelës kadastrale në raport me planet urbanistike në fuqi (PZHK, PZHU, PRtU, PDU)	116

- Kërkesa për vlersimi i danave te shkaktuara ne objekte (Objekte të vjetra etj.) të dëmtuara nga zjarri, reshjet e shiut3
- Ankesa kunder vendimet të organit të shkallë së I-rë3

- Përgatitja/hxjerrja e akteve juridike dhe shkresave të ndryshme administrative, si në vijim.

Lloji i aktit – administrativ Korrik-Dhjetor 2025	Numri i akteve administrative
Vendim / Leje ndërtimore	34
Vendim / për Caktimin e Kushteve Ndërtimore për Ndërtim.	32
Vendime / Leje te perdorimit të objekteve te cilat jan pajisur me leje ndërtimore	0
Shkresa – Letërinformatë lidhur me kërkesat për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënuimi .	52
Vendim / Leje rrënuimi	2
Vendime / Certifikata per legalizim të ndërtimeve pa leje ndërtimore	27
Vendime , per futje ne Listë të pritjes të objekteve-ndërtimeve pa leje	6
Vendime / Refuzim të kërkesave	5
Vërtetime /	0
Gjithësej	158

në buxhetin Komunal janë inkasuar të hyra buxhetore prej: **57,422.50** euro.

- Baza Ligjore:
- *Regullorja Për Ngarkesa,Tarifa, Taksa dhe Gjoha Komunale* 01 Nr.5300 më 16. 02.2023 dhe

Të hyrat nga taksat komunale dhe pagesat tjera të evidentuara në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

- Gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2025 sipas evidencës që kemi në DUPH, nga taksat dhe pagesat tjera

- Ligjin Nr. 06/L-024 "Për Trajtimin e ndërtimeve pa leje ", Ligjit Nr. 08/ L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Për Trajtimin e ndërtimeve pa leje (Gazeta zyrtare Nr. 20 date 16 Gusht 2023).

Punë tjera

- Regjistrimin e Adresave zyrtare të qytetarëve të Komunës së Kamenicës
- Identifikimin e Adresave zyrtare ne Aris,
- Ofrimi i informacioneve dhe shërbimeve për qytetarët në lidhje me regjistrimin dhe ndryshimin e adresave.
- Mbatja e një baze të dhënash të integruar dhe të organizuar për sistemin e adresave.
- Raportimi mbi përpunimin dhe problematikat e identifikuara në lidhje me sistemin e adresave, ku deri më tani janë lëshuar 1847 certifikata të adresave dhe është bërë vendosja e 2 numrave të adresave në sistemin Aris.
- Përfundimi i raportit të shqyrtimit publik të PZHK-së dhe dorëzimi i tij bashkë me draftin përfundimtar të PZHK-së në MMPHI për aprovim.
- Maja e aprovimit të draftit përfundimtar të PZHK-së nga MMPHI, për votim në Kuvend Komunal, i cili u miratua në seancën e datës 31.07.2025.
- Vazhdimi i punës në hartimin e HZK-së.
- Fillimi i punës në hartimin e Masterplanit të Bahqes.

Inicimi i procedurave të prokurimit

- Nisja e procedurave të prokurimit për ndërtimin e Qendres së Kompostimit, ne kuader te maresvesfjes qe Komuna ka me CMSR-ne Slovene, per realizimin e ketij projekti.
- Inicimi i procedurave te rekrutimit te konsulentëve Arkitektë-Planerë, etj.

Kontratat që janë menaxhuar nga punëtorët e duph-së në 2025

Mehmet R.Thaci menaxhon-mblikëqyrë këto projekte:

- *Menaxher i kontrates "Rregullimi i rrugëve në Malësinë e Kamenicës – Asfaltimi i rrugës Feriqevë-Gjyrishec".*

Hasan Rapuca deri ne pesionim ka menaxhuan-mbikëqyrë këto projekte:

- *Menaxher i kontratës "Mirembajtja e kanalizimit dhe infrastrukturës te komunes se Kamenices".*
- *Menaxher i kontratës anëtar i ekipes menaxhuese per projektin "Ndertimi i ures ne Hodonoc"*
- *Menaxher i kontratës "Ndertimi i ures metalike ne Hajnoc",projekti perfunduar*

Mexhid Zyfliu deri ne pesionim ka menaxhuan -mbikëqyrë këto projekte:

- *Menaxhimi i kontratës : "Ndertimi i kanalizimit ne fshatra", Projekti në realizim.*
- *Menaxher i kontratës LOTI-1- "Ndertimi i parqeve në Kamenicë- Parku te qendra e vjeter -Ritenderim"*
- *Menaxher i kontratës anëtar i ekipes menaxhuese per projektin "Ndertimi i ures ne Hodonoc"*
- *z. Zyfliu ka dal ne pension te parakoshem ne muqin Prill 2025*

Muhamet Thaci ka mbikëqyrë këto projekte:

- *Mbikqyrës i drejtëpërdrejt i Menaxherii të kontratës me titull "Sherbimet e konsulences – Konsulent, per planifikim hapësitor"*

Iir Kastrioti ka menaxhuan këto projekte:

- *Menaxher i kontratës me titull "Sherbimet e konsulences – Konsulent, per planifikim hapësitor", Aktualisht përcjell punën e stafit mbështetës të angazhuar për periudhë të përkohshme: Sadije Deliu, Idriz Shala, Ibrahim Begiri të cilet janë të pagazhuar në procesin e Planifikimit Hapësitor.*

Besart Fejzullahu menaxhon-mbikëqyrë këto projekte:

- *Zgjerimi i rrjetit te ndricimit publik- Kjo kontratë është përmbyll brenda afatit ligjor, dhe është realizuar 93% e projektit.*
- *"Mirembajtja teknike e objekteve komunale" - Kontrata është në realizim e sipër, është kontratë kornizë, varësisht prej nevojave, afati i mbylljes eshte 05.2026. Vlera e realizuar deri më tani është 81%, mirëpo kemi ende pa paguar nga kjo pjesë.*

- "Furnizimi me material elektroenergetik- Riterderm"- Kjo kontratë është memorandum bashkëpunimi mes Komunës së Kamenicës dhe KEDS, ku një pjesë e punëve kanë qenë të deleguara për komunën, pjesa tjetër KEDS. Është realizuar vetëm pjesa tek L.Qamëria dhe Lugu i Verdhë, ndërsa Velëgjllava ka mbet për shkak të terrenit jo të përshtatshëm. Kontrata nuk është mbyll për shkak të pagesave që jemi mbrrapa, si dhe punëve nga ana KEDS që kanë mbetur pa përfunduar.
- "Ndërtimi i Bulevardit të Qytetit në Kamenicë - Punët e mbetura -- Riterderim - 3"- Jam pjesë e komisionit menaxhues të kontratës, deri tani është realizuar 46%
- "Ndërtimi i gerdhes ne Roganë"- Jam pjesë e komisionit menaxhues të kontratës, deri tani është realizuar 50%, ndërsa është paguar 35%
- "Ndërtimi i sallës së sporteve në Kamenicë"- Jam pjesë e komisionit menaxhues të kontratës, deri tani është realizuar 50%, kjo kontratë ka ngec për shkak të problemeve pronësore, ku deri më tani vetëm ~3-5% është realizuar.
- "Furnizimi dhe montimi me material energjetik per forcimin e transformatorit me pajisje perçjellëse"- Kjo kontratë është realizuar 100%, vetëm pagesat janë bërë me vonesë, për arsye të raportit të pranimit nga KEDS

Sylejman Kallaba menaxhor-mbikqyrë këto projekte:

Ndërtimi i trotuarit në Bosce-Stralicë

- Kemi kryer inspektim të rregullta të punimeve në këtë segment.
- Pas kërkësës për shlyrje të afatit, punimet kanë rifilluar dhe është realizuar asfaltimi I një pjesë të trotuarit me gjatësi 800 m.
- Pagesa e mbështetjes financiare nga Ministria është finalizuar në vlerë prej **50,000.00 €**
- Mbështetja nga Komuna ende nuk është realizuar dhe ka vlerë prej **24,000.00 €**.
-
- Ndërtimi i trotuarit nga Qyteti në fsh. Ruboc**
- Kemi kryer inspektim të rregullta të punimeve në këtë segment.
- Faza e parë e projektit është mbështetur nga MAPL me vlerë **97,594.09 €**.
- Faza e dytë është nën mbështetjen e Komunës (**99,096.37 €**).

• Në fazën e dytë punimet janë zhvilluar me ritëm të ngadalhtë për shkak të pengesave të banorëve, punimet kanë vazhduar vetëm në segmentet ku nuk ka pasur kundërshtime. • Afati I kontratës ka qenë deri më 08.10.2025 • Është paraqitur kërkesë për shpërbërjen e afatit të përfundimit të punimeve.	
• Qendra e Kompostimit • Kemi kryer inspektim të punimeve për monitorimin e ecurisë së punimeve. • Gjatë vizitave është kërkuar mbajtjen e intensitetit të punimeve në ritme të rregullta, në përputhje me planin dinamik të projektit. • Në përputhje me planin dinamik të projektit deri tani kemi realizuar dy situacione për pagesë në një vlerë prej 348,367.90 € ose rreth 50% të projektit, ndërsa kontrata skadon më 10.06.2026, • • Renovimi i sallës së kuvendit të Shtëpisë së Kulturës • Kemi kryer inspektim të vazhdueshme të punimeve për të monitoruar ecurinë e tyre dhe për të siguruar respektimin e specifikimeve teknike. • Pas realizimit të disa punimeve, është kryer pagesa për situacionin e parë në vlerë prej 11,944.50 €. Duke ndjekur më tej dinamikën e punimeve në këtë projekt, deri më tani nuk është paraqitur ndonjë situacion për pagesa të tjera. • Ky projekt ka afat përfundimi më 17.12.2025. • • Asfaltimi I Rrugëve Lot 2- Dragoc, Setllar, Kranidell • Kemi kryer inspektim të vazhdueshme të punimeve në të 3 segmentet e këtij loti, ku deri më tani janë realizuar pastrimi, gërmimi, si dhe mbushja me zhavor në segmentet 1 dhe 3, në kuadër të këtij projekti. • Është realizuar një situacion për pagesë në vlerë prej 194,580.35 €. • Ky projekt ka afat për përfundim prej 24 muajsh. •	

- **Asfaltimi I Rrugës Xhadjja e vjetër (Rruga fidanisha dhe Bugaçaj)** Pas testheqjes se Ali Berishes, nga menaxheri i projektin në këtë segment, ku gjatë kësaj kohe janë përfunduar rreth 80% e punimeve, gjatë inspektimit të punimeve në fazat e fundit të projektit është punuar kanali i hapur i ujërave atmosferike në rrugën Fidanisha duke përfunduar dhe shtimi i asfaltit. Ku është proceduar për pagesë dhe situatë e V në një vlerë prej 85,751.41€.
-
- **Asfaltimi I rrugëve lokale Lot-2- Asfaltimi i rrugëve në Karagjevë të Epërme, Karagjevë të poshtme, Novosellë, Kopërnice, Shipashnicë e epërme, Shipashnicë e Poshtme, Hodonoc dhe Rogacisë.**
- Kemi kryer inspektime të vazhdueshme të punimeve dhe ecurinë e tyre, sipas mjeteve të ndara në 3 lakacione janë kryer punimet në gërmim dhe mbushje me zhavor në Rrugët në Muçiverc, trotuari në Kopërnice dhe janë duke u zhvilluar punime në Karagjev. Ky projekt ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh.

Fjolla Dubova menaxhon këto punë:

- Pjesë e stafit mbështetës të angazhuar për periudhë të përkohëshme, menaxhon procesin e lëshimit të certifikatave të adresave dhe vendosjes së numrave të adresave në gjeoportali.

Idriz Shala i angazhuar në këto punë:

- Pjesë e stafit mbështetës të angazhuar për periudhë të përkohëshme, në procesin e Planifikimit Hapësiror, hartimin e Dokumenteve të planifikimit hapësiror HZK dhe Masterplanit i Balcës.
- **Sadije Deliu e angazhuar në këto punë:**
- Pjesë e stafit mbështetës të angazhuar për periudhë të përkohëshme, në procesin e Planifikimit Hapësiror, hartimin e Dokumenteve të planifikimit hapësiror HZK dhe Masterplanit i Balcës.

Ibrahim Begiri i angazhuar në këto punë:

- Pjesë e staftit mbështetës të angazhuar për periudhë të përkohëshme, në procesin e Planifikimit Hapësinor, hartimin e Dokumenteve të planifikimit hapësinor HZK dhe Masterplani i Bahqes.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme:

Gjendja Civile në Kamericë dhe dy degët e saj në Mitrovicë dhe Hogoshtë kanë lëshuar gjithsej 13107 dokumente.

LLOJI I DOKUMENTIT		
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	4766	
Certifikatë lindje	2551	
Certifikatë martesë	1250	
Certifikatë vdekje	863	
Aktvdekje	107	
Certifikatë vendbanimi	1727	
Certifikatë të bashkësisë familjare		856
Certifikatë të gjendje martesore	282	
Certifikatë shtetësie	82	
Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi	141	
Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës	45	

Konfirmime / Vërtetime	48
Pranim Atësie	0
Deklarata për kthim te mbiemrit brenda 6 muajve	3
Procedura mbi 18 vjet regjistrim	13
Persona mbi 90 vjet	5
Përgjigje Gjykatave	13
Përgjigje divizionit të Pensioneve	7
Aplikim për fitim të shtetësisë	74
Aplikim për lirin të shtetësisë	5
Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile dhe shërbim:	12518
Totali:	12838

Vepimet – Procedurat e zhvilluara administrative: lindjet, martesat, vdekjet dhe vendime

01.07.2025 – 27.11.2025

LLOJI I DOKUMENTIT	
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda vendit :	0
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, jashtë vendit :	111

Martestat e lidhura dhe rishkrim martese:	22
Shkurorëzimet :	11
Martestat me element të huaj :	24
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda vendit :	16
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit:	16
Mjete jetese	57
Vendime për korrigjime në emra personal :	6
Vendime për ndërrime në emra personal :	6
Totali:	269

Gjatë muajve Qershor–Nëntor, Qendra për Shërbime me Qytetarë ka pranuar gjithsej **21654 kërkesa**, ndërsa për drejtorinë e Administratës janë 15322 kërkesa.

Çdo kërkesë është trajtuar me prioritet të lartë. Në Qendrën për Shërbime me Qytetarë ka staf të njafueshëm dhe punët kryhen me efikasitet dhe në kohë të shkurtër

Në tabelën më poshtë mund t'i gjeni kërkesat për të gjitha drejtoritë.

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

01/06/2025 - 17/12/2025

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratur	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anulluar	Perfunduar	Totali
	NUK EXISTON si DEPARTMENT por ka Lende	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	0	1	1,601	0	0	0	0	17	13,703	15,322
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim	0	9	652	37	0	0	0	3	0	701
DBPZHR	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	0	9	118	0	2	0	0	0	0	129
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	0	18	997	4	0	0	0	1	0	1,020

DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	47	0	0	0	0	0	0	0	0	47
DPKGJ	Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi	0	20	195	2	0	0	0	0	3	0	220
DZHED	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë	0	18	12	0	0	0	0	0	0	0	30
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	0	429	17	1	0	0	0	0	3	0	450
DSHPAIE	Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë	1	108	199	87	0	0	0	2	0	0	397
DUPH	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor	0	108	128	5	0	26	0	1	0	0	268

DIK	Drejtoria për Investime Kapitale	0	163	0	0	0	0	0	0	0	0	163
KKK	Kuvendi Komunal	0	31	154	0	0	0	0	0	1	0	186
ZK	Zyra e Kryetarit	0	2,308	380	28	0	0	0	1	3	0	2,720
		1	3,270	4,453	164	2	26	3	32	13,703		21,654

Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur kërkesa të shumta për përdorimin e veturave zyrtare, të cilat janë menaxhuar në mënyrë efektive dhe, në shumicën e rasteve, janë aprovuar.

Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur gjithsej 251 kërkesa, prej të cilave 241 janë aprovuar.

Kërkesa për përdorimin e veturave zyrtare	251
Të aprovuara	241
Të anuluar	2
Të pa nenshkruara	8

Në tabelën më poshtë janë paraqitur kilometrat e veturave për muajin Qershor-Nëntor

Nr.	Vetura	Targat	Motori	Km.risje	Km.mbarim	Gjithsej	Litra	L/100km
1	Kombi	112-131-06	Dizell	0	0	0	0	0
2	Kombi	06Z-05-10	Dizell	0	0	0	0	0
3	Hynday i20	06Z-03-10	benzin	232 362	235300	2938	228	7.76
4	Shkoda	06Z-01-10	Dizell	/	/	PK	282	
5	Shkoda	06Z-18-10	Dizell	260895		PK	238	
6	Shkoda	06Z-17-10	Dizell	247392	255365	7973	493	6.18
7	Toyota Prado	06Z-16-10	Dizell	297562	303174	5612	727	12.95
8	Shkoda	06Z-15-10	Dizell	139025	142465	3440	165	4.79
9	Hynday i30	06Z-19-10	Dizell	291177	293309	2132	175	8.2
10	Amarok	06Z-20-10	Dizell	104306	109200	4894	579	11.83
11	Amarok	06Z-21-10	Dizell	110254			610	
12	Shkoll-kos	Shkollat	Di-Be	/			250	
13	Mitsubish	06Z-06-10	Dizell	servis			240	
14	Mitsubishi	06Z-13-10	Dizell	265784	265804	20	50	?

15	Cat-966	////////	Dizell		////		3022	/
16	Toyota Yaris	06Z-25-10	Benzin	39605	46397	6792	484	7.12
17	Toyota Yaris	06Z-26-10	Benzin	43313	54153	10840	751	6.92
18	Audi	06Z-29-10	Dizell	294269	299135	4866	380	7.8
19	Yaris	06Z-30-10	benzin	27007	37645	10638	739	6.94
20	Crafter	06Z-31-10	Dizell	459461	462402	2941	380	12.92
21	Mirimbajije	Qyteti	Dizell				1100	
22	Peugeot	06Z-33-10	dzell	12943	20793	7850	495	6.3
23	Peugeot	6Z-32-10	dizell	3021	5426	2405	182	7.56
24	Xheneratori	////////	Dizell	////			50	
25	Traktor-Jondir	////////	Dizell	////			155	
26	Traktor-Landini	////////	Dizell	////			105	

Zyrtari per pranimin e mallit:

- Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar pranimin e furnizimeve për të gjitha Drejtoritë Komunale në Komunën e Kamenicës.
- Gjatë kësaj muaji kemi pasur gjithsej **24 furnizime** nga furnitorë të ndryshëm.

- Kemi kryer verifikime në terren gjatë pranimit të mallrave, duke kontrolluar sasinë dhe kualitetin e tyre, si dhe duke shqyrtuar me kujdes kërkesat nga Drejtoritë Komunale. Në raste të caktuara, mallrat janë pranuar nga drejtoritë përkatëse dhe, në bazë të fakturës dhe fletëdërgesës, është bërë regjistrimi i hyrje-daljes.
- Kam bërë pranimin dhe protokollimin e të gjitha fakturave të telefonisë, internetit, ujit dhe higjienës, si dhe fakturave të tjera për të gjitha Drejtoritë Komunale, të cilat janë dërguar në Drejtorinë e Financave dhe Buxheut për procedura të mëtejshme të pagesës. (Gjithsej 967 faktura).
- Të gjitha furnizimet, pranimin e mallrave dhe shërbimeve i kemi të regjistruara në programin E-Pasuria (86 dalje dhe 36 transfere), si dhe në kopje fizike. Gjithashtu, për të gjitha lëndët e përgatitura për pagesë janë gjenerruar 406 raporte nga sistemi SIMFK – Free Balance, program për të cilin jam i certifikuar.

Raporti pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën kohore korrik – nëntor 2025 të zyrtares për të drejtat e fëmijëve, mbrojtje nga diskriminimi dhe njëkohësisht Koordinatorres së Njësise Komunale për të drejtat e njeriut (NJKDNJ).

Në këtë raport do t'i paraqesim aktivitetet, të dhënat dhe shënimet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin gjatë kësaj periudhe kohore, në kontekst të të drejtave të njeriut.

ORGANIZIMI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE TË KOORDINATORRES SË NJKDNJ-së

- *Hartimi i Raportit të Punës së Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje për periudhën: janar – qershor 2025.* Në përputhje me shkresën e Ministrisë së Drejtësisë dhe në mbështetje të Planit të Veprimi, Koordinatorja e NJKDNJ-së ka hartuar Raportin për periudhën janar–qershor 2025 të MKKDHF. Raporti ka për qëllim të informojë mbi aktivitetet e realizuara nga Komuna

e Kamenicës gjatë periudhës janar–qershor 2025 në kuadër të parandalimit të dhunës në familje, sipas Planit të Veprimit 2024–2026 (18 korrik 2025)

- *Bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Këshillit të Europës dhe Komunës së Kamenicës është kurorëzuar me shpalljen e Komunës së Kamenicës fituese të grantit të Këshillit të Evropës.* Komuna e Kamenicës ka përfutur nga projekti i KE në kuadër të iniciativës për forcimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e transparencës. Përfaqësuesja e Komunës, Lidionë Maroca, së bashku me personin kontaktues të projektit, Nazmije D.Kastrati, morën pjesë në ceremoninë zyrtare të nënshkrimit të marrëveshjes së grantit (15 gusht 2025)

- *Aktivitet ndërkommunitar në Kamenicë në kuadër të Zbatimit të Planit të Veprimit për Avancimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali* Koordinatorja e NIKDNJ-së, njëherësh edhe Kryesuese e Komitetit Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rome dhe Ashkali, së bashku me përfaqësuesen e komunitetit rom, znj. Bahrije Kryeziu, dhe me mbështetjen e OSBE-së – znj. Vjosa Emiri dhe z. Lutfi Hoxha – organizuan një aktivitet ndërkommunitar në Komunën e Kamenicës. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të zbatimit të Planit Lokal të Veprimit (PLV) për Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rome dhe Ashkali 2022-2026, si dhe Planit të Veprimit 2022-2026 (13 shtator 2025)

- *Njoftim Kryetarin e Komunës lidhur me projektin e Këshillit të Evropës.* Përmes këtij emaili Koordinatorja e NIKDNJ-së ka kërkuar që mos të vonohen procedurat sa i përket implementimit të këtij projekti sepse duhet të përfundoj deri në fund të muajit nëntor..Më pas Kryetari ka obliguar Drejtorinë e Administratës që të mirret me procedura administrative e më pas të shkojnë me procedurat e prokurimit public (25,26 shtator 2025)

- ***Komuna e Kamenicës organizon aktivitetin për Tetorin Rozë*** Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit kundër Kancerit të Gjirit – Tetorit Rozë, Komuna e Kamenicës, përmes Grupit të Grave, organizoi një marsh simbolik me qëllim të ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e parandalimit dhe zbulimit të hershëm të kësaj sëmundjeje. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe Koordinatorja e NIKDNJ-së dhe Zyrtarja për Barazi Gjimore Marshi filloi nga objekti i Komunës dhe vazhdoi përgjatë bulevardit të qytetit, duke tubuar qytetarë, nxënës, aktivistë e përfaqësues të institucioneve lokale. Gjatë ditës u shpërndanë edhe materiale informuese të përgatitura nga NIKDNJ, me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve për kujdesin ndaj shëndetit të gruas (1 tetor 2025)

- ***2 Tetori - Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës*** Koordinatorja e NIKDNJ-së, me rastin e kësaj dite ka përgatitur një videospot me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare për parandalimin e dhunës dhe promovimin e kulturës së respektit e dialogut. Këtë videospot e ka shpërndarë në rrjete të ndryshme sociale për ndërgjegjësimin e popullatës (2 tetor 2025)

- ***Muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit*** Me rastin e Muajit Rozë, Koordinatorja e NIKDNJ-së, ka përgatitur një videospot me qëllim ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e parandalimit dhe zbulimit të hershëm të Kancerit të Gjirit. Këtë videospot e ka shpërndarë në rrjete të ndryshme sociale për ndërgjegjësimin e popullatës (3 tetor 2025)

- ***18 Tetor – Dita Ndërkombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore*** Me rastin e shënimit të kësaj dite, Koordinatorja e NIKDNJ-së hap fushatën sensibilizuese kundër trafikimit me qenie njerëzore duke përgatitur dhe lansuar një videospot në rrjete të ndryshme sociale (18 tetor 2025)

- *Punëtoria “Format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtja nga dhuna kibernetike* Zyrtaria për Barazi Gjimore në bashkëpunim me Koordinatorin e NIKDNJ-së kanë organizuar një punëtori ndërgjegjëse me temën: “Format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtja nga dhuna kibernetike” Qëllimi i këtij aktiviteti është të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes dhe në krijimin e mjediseve të sigurt, gjithëpërfshirëse dhe të barabarta për të gjithë qytetarët e komunës (20 tetor 2025)
- *Bashkëpunim institucional për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore* Koordinatorja e NIKDNJ-së, së bashku me Zyrtaren për Barazi Gjimore, vizituan Zyren për Ndihmë Juridike Falas, ku u pritën nga Zyrtaria për Ndihmë Juridike Falas, Mirsije Ajvazi. Qëllimi i kësaj vizite ishte Fushata Sensibilizuese kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, si dhe me qëllim të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të kësaj fushate (20 tetor 2025)
- *Komuna e Kamenicës vazhdon Fushatën Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore* Në kuadër të Fushatës Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Komuna e Kamenicës, përmes Koordinatorës së Njësisë për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyrtares për Barazi Gjimore, ka vazhduar aktivitetet ndërgjegjëse për parandalimin e këtij fenomeni. Vizituan Stacionin Policor të Kamenicës, ku u pritën nga komandanti z. Basri Shkoda, si dhe bashkëpunëtorët e tij Mirsije Kastrati nga Sektori i Dhunës në Familje dhe Edona Godanci Demolli, zyrtare policore e Kimteknikës – Forenzikës (23 tetor 2025)
- *Gratë e komuniteteve në fokus të “Tetorit Rozë” në Kamenicë.* Në kuadër të Zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e Komuniteteve Rome dhe Ashkali (2022–2026) dhe për shënimin e Tetorit Rozë, në Komunën e Kamenicës u mbajt një ligjëratë vetëdijësuese për gratë e komunitetit rom. Ligjërata e organizuan Koordinatorja e NIKDNJ-së, së bashku me Zyrtaren për Barazi

Gjinore, me mbështetjen e OSBE-së, përfaqësuar nga znj. Vjosa Emmini. Një numër i konsiderueshëm i grave morën pjesë, duke treguar interesim të veçantë dhe duke ndarë përvoja mbi kujdesin shëndetësor. Me profesionalizëm dhe përkushtim, Dr. Eurona Hoda ua përcolli informacionet në mënyrë të thjeshtësuar dhe të kuptueshme, ndërsa Infermierja Sherife Veseli i informoi pjesëmarrëset se mamografia ofrohet në QKMF të Kamenicës dhe se çdo grua mbi 40-vjeç duhet të kryejë kontrollin, pasi kujdesi i hershëm është kyç për shëndetin (29 tetor 2025)

- **Ditë e hapur me qytetarë** - Në vazhdim të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut, një herë në muaj mbahet aktiviteti informues “Ditë e hapur me qytetarë” në Komunën e Kamenicës.

Qytetarët kanë mundësinë të takohen drejtpërdrejt me përfaqësuesit institucionalë, për të paraqitur ankesat, shqetësimet dhe rastet që lidhen me shkeljen e të drejtave të tyre. Në këtë aktivitet marrin pjesë Zyratari Ligjor i IAP-së, Shërbësin Mustafa, dhe Koordinatorja e NJKDNJ-së, të cilët ofrojnë informacione dhe këshilla profesionale për procedurat e raportimit dhe trajtimit të rasteve (11 nëntor 2025)

- **Ligjëratë ndër-institucionale për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore me nxënës të IAP “Andrea Durrësaku” në Kamenicë.** Në kuadër të Fushatës kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Koordinatorja e NJKDNJ-së, në bashkëpunim me Këshillin Komunal të Nxënësve, Drejtorja Komunale e Arsimit, Institucioni i Avokatit të Popullit, Stacioni Policor në Kamenicë, Qendra për Punë Sociale dhe OJQ Dardana Press, ka mbajtur një ligjëratë-bashkëbisedim me nxënësit e klasave XII-ta të shkollës IAP “Andrea Durrësaku” në Kamenicë, në ambientet e Qendrës së Kartierës. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues nga Policia e Kosovës, QPS, Institucioni i Avokatit të Popullit, Dardana Press.

Ky aktivitet u realizua me qëllim rritjen e vetëdijes së nxënësve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe parandalimin e trafikimit me gjenie njerëzore në Komunën e Kamenicës (14 nëntor 2025).

PJESËMARRJE NË TAKIME, TRYEZA DISKUTIMESH E PROGRAME TË NDRYSHME

- *Punëtorja mbi lokalizimin e qeverisjes së hapur.* Koordinatorja e NIKDNJ-së, mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, në kuadër të projektit “Forcimi i qeverisjes shumënivëlëshe dhe demokracisë pjesëmarrëse”. Punëtorja kishte për qëllim mbështetjen e komunave në lokalizimin e 12 Parimeve të Qeverisjes së Mirë Demokratike, duke theksuar transparencën, pjesëmarrjen demokratike, etikën publike dhe llogaridhënien – elemente thelbësore të qeverisjes së hapur.

- *Punëtorja: Informimin dhe qasje e barabartë në të drejtat pronësore* Koordinatorja e NIKDNJ-së, së bashku me Zyrtaren për Barazi Gjinore, morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Instituti KLGJ në kuadër të projektit “Nisma për të Drejtën e Pronës (NDP)”. Punëtorja synonte fuqizimin e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse, transparente dhe me qasje të drejtë në të drejtat pronësore.

- *Punëtori mes komuniteteve fetare, anëtarëve të KKS-B-së dhe Policisë së Kosovës mbi parandalimin e incidenteve të sigurisë.* Koordinatorja e NIKDNJ-së, Zyrtaria për Barazi Gjinore, si dhe anëtarë të tjerë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga Kamënica e Gjlano, morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë me temën: “Punëtori mes komuniteteve fetare, anëtarëve të KKS-B-së dhe Policisë së Kosovës mbi parandalimin e incidenteve të sigurisë” (4 shtator 2025)

- *Takimi i dytë i Këshillit për Arsim ma t'mirë – KAM* Koordinatorja e NJKDNJ-së, bashkë me Zyrтарen për Barazi Gjimore, morën pjesë në takimim e dytë të Këshillit për Arsim ma t'mirë – KAM, një platformë gjithëpërfshirëse që mbledh institucione, shkolla, prindër, nxënës dhe organizata lokale për të ndërtuar bashkëpunim dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit në nivel local (9 shtator 2025)

- *Vlerësimi i Ndërmjetëm i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026* Koordinatorja e NJKDNJ-së, bashkë me Zyrтарen për Barazi Gjimore, morën pjesë në Takimin për Validimin e Gjetjeve nga Vlerësimi i Ndërmjetëm i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026

Qllimi i takimi, ishte që të mbledh përfaqësues nga institucione qendrore dhe lokale për të diskutuar gjetjet e deritani shme mbi zbatimin e strategjisë, situatën aktuale në nivel lokal, si dhe funksionimin e Mekanizmave Koordinues Komunal (18 shtator 2025)

- *Muaji Rozë – Art, vetëdije dhe solidaritet në QKMF në Kamenicë* Koordinatorja e NJKDNJ-së dhe Zyrтарja për Barazi Gjimore, morën pjesë në ekspozitën e organizuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Shaban Geci” në Kamenicë, në kuadër të Muajit Rozë – muajit të ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të gjirit. Ekspozita u realizua nga nxënëset e “International School of Prishtina”, nën udhëheqjen e profesoreshës së artit figurativ Merita Sijarina Ismajli, në bashkëpunim me Sherife Veseli Berisha (BSc në infermierë) nga Kamenica. Njëpërmjet punimeve artistike, vajzat përcollën mesazhe të fuqishme dashurie, shprese dhe guximi për të gjitha gratë që përballen me sfida të kancerit të gjirit.

- ***Bashkëpunimi për sigurinë shkollë.*** Koordinatorja e NIKDNI-së, mori pjesë në takimin e përbashkët të organizuar nga Gjimnazi “Ismail Qemali” dhe IAAP “Andrea Dursaku”, me përfaqësues të Këshillave të Prindërve, KDSh-së dhe Policisë së Kosovës.

Takimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, prindërve dhe Policisë, për të siguruar një ambient më të qetë dhe më të sigurt për nxënësit.

U diskutua për rolin e secilës palë në parandalimin e dukurive negative dhe për nxitjen e përgjegjësisë së përbashkët në mbrojtjen e fëmijëve (5 nëntor 2025)

- ***Komuna e Kamenicës pjesëmarrëse në punëtorinë e Këshillit të Evropës për forcimin e qeverisjes lokale dhe raportimin efektiv.*** Koordinatorja e NIKDNI-së, njëherit edhe person kontaktues i projektit të Këshillit të Evropës “Forcimi i Qeverisjes Shumënivëlëshe dhe Demokracisë Pjesëmarrëse”, mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Këshilli i Evropës me përfaqësues nga pesë komuna fituese të granteve: Hani i Elezit, Klina, Kamënica, Lipjani dhe Prizreni. Punëtorja kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve të komunave në raportimin narrativ dhe financiar të bazuar në rezultate, duke siguruar transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm në proceset komunale (14 nëntor 2025)

- ***Konferenca e Këshillit të Nxënësve me temën “Nxënësit, Paja dhe Siguria. Me ftesë të OJQ KYC Kosova,*** Koordinatorja e NIKDNI-së mori pjesë në Konferencën NPS. Në këtë konferencë u mbledhën përfaqësues të nxënësve nga e gjithë Kosova për të diskutuar rreth pages, sigurisë dhe avokimit të të rinjve në shkollat e mesme (17 nëntor 2025)

- *Lausimi i Fushatës Vetëdijësuese për Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.* Koordinatorja NIKDNI-së, ishte pjesë e panelit të diskutimit, ku paraqiti praktika të mira dhe shembuj konkretë të përkushtimit të komunës në avancimin e të drejtave të njeriut, në përmirësimin e qasjes së komuniteteve në shërbime publike dhe në ngritjen e mekanizmave lokalë për parandalimin e diskriminimit.

Në kuadër të prezantimit të saj, ajo paraqiti edhe videon sensibilizuese “Bashkë Kundër Diskriminimit”, e cila përcjell mesazhe të qarta për barazi, respekt, gjithëpërfshirje dhe reagim të përbashkët kundër çdo forme të diskriminimit (18 nëntor 2025).

Verifikimi i palës së këtyer në teren (ZKKK)- Zyrtarja për Rinintegrim që këtë poziti e mban si detyrë, ka bërë verifikimin e palës në terren se bashku me zyrtarët nga Ministria e Punëve të Brendshme Departamenti i Rinintegritit dhe zyrtarët nga Qendra për punë sociale. Pala pas verifikimit udhëzohet që të vazhdojë me procedurat e tjera dhe sjelljen e dokumenteve pas vlerësimit paraprak të nevojave për personat e riadhesuar.

Vlerësimi i nivelit të Rinintegritit dhe ndihmës së ofruar për personat e riadhesuar. Keshillimi i palës e cila është këtyer dhe fiton statusin e të riadhesuarit, plotësimi i raportit për vlerësimin e nevojave. Pala është njoftuar për së afërmi për kushtet dhe ndihmen e cila mund të ofrohet pas fitimit të statusit si përfson i riadhesuar.

Plani i Veprimit për Barazi Gjimore në fokus të Komunës së Kamenicës- Në kuadër të angazhimit për të avancuar barazinë gjimore përmes monitorimit dhe llogaridhënies së ndjeshme ndaj gjinisë, Zyra për Barazi Gjimore në Komunën e Kamenicës ka organizuar një takim me përfaqësues të Iniciativës Rimorë për të Drejtat e Njeriut (YIHR), në kuadër të projektit “Monitorimi dhe llogaridhënia me

ndjeshmëri gjinore”, i mbështetur nga UN Women dhe i zbatuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) në partneritet me YIHR, me financim nga Bashkimi Evropian.

Verifikimi i palës së këtyr në terren(ZKKK)- Zyrtarja për Riintegrim që këtë pozitë e mban si detyrë shtesë të caktuar ka bërë verifikimin e palës në terren se bashku me zyrtarët nga Ministria e Punëve të Brendshme Departamenti i Riintegritimit dhe zyrtarët nga Qendra për punë sociale. Pala pas verifikimit udhëzohet që të vazhdojë me procedurat e tjera dhe sjelljen e dokumenteve pas vlerësimit paraprirak të nevojave për personat e riadhesuar.

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ka mbajtur një takim koordinues me Zyrtarët për Barazi Gjinore- Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ka mbajtur një takim koordinues me Zyrtarët për Barazi Gjinore nga niveli lokal dhe qendror, pjesë e së cilit ishte edhe zyrtarja për Barazi Gjinore nga komuna e Kamenicës, takimi kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit dhe planifikimin e aktiviteteve deri në fund të vitit. Në bazë të këtij takimi u bë plani për aktivitetet e 6 muajit të fundit të këtij viti, duke përfshirë fushatën e 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

Komuna e Kamenicës organizon aktivitetin për Tetorin Rozë- Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit kundër Kancerit të Gjirit – Tetorit Rozë, Komuna e Kamenicës, përmes Grupit të Grave, organizoi sot një marsh simbolik me qëllim të ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e parandalimit dhe zbulimit të hershëm të kësaj sëmundjeje. Marshi filloi nga objekti i Komunës dhe vazhdoi përgjatë bulevardit të qytetit, duke tubuar qytetarë, nxënës, aktiviste e përfaqësues të institucioneve lokale. Sheshi i qytetit u zbulua me ombrellat rozë, duke dhënë një mesazh të fuqishëm: “Bashkë për gratë, bashkë për ndërgjegjësim!”

Gjatë ditës u shpërndanë edhe materiale informuese të përgatitura nga Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut, DHE Zyra për Barazi Gjinore, me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve për kujdesin ndaj shëndetit të gruas.

Ky aktivitetet nuk është vetëm një marsh, por një thirrje për forcë e shpresë për të gjitha gratë që po përballen me kancerin e gjirit.

Ju nuk jeni vetëm!

Bashkë jemi më të forta, bashkë ecim drejt shërimit dhe jetës së shëndetshme.

Mbahet punëtorja “Format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtja nga dhuna kibernetike”- Komuna e Kamenicës, përmes Zyrtës për Barazi Gjinore dhe në bashkëpunim me Koordinatorën e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut, ka organizuar një punëtori ndërjegjësjesë me temën: “Format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtja nga dhuna kibernetike”.

Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore, me mbështetjen e projektit “Gender Equality Facility”, i financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga UN Women, dhe me përkrahjen e Cactus Education. Punëtorja është udhëhequr nga trajnerja e UN Women, Mirjeta Nagavci, e cila përmes diskutimeve, ushtrimeve praktike dhe reflektimeve, ka trajnuar format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore, me fokus të veçantë të dhuna digjitale dhe mbrojtja nga sulmet kibernetike.

Në mesin e pjesëmarrësve ishte edhe pedagogu i shkollës së mesme të lartë në Komunën e Kamenicës, Afrim Hoda.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes dhe në krijimin e mjediseve të sigurt, gjithëpërfshirë dhe të barabarta për të gjithë qytetarët e komunës.

Komuna e Kamenicës vazhdon Fushatën Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore- Në kuadër të Fushatës Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Komuna e Kamenicës, përmes Koordinatorës së Njësisë për të Drejtat e Njeriut, znj. Nazmije Demolli-Kastrati, dhe Zyrtarës për Barazi Gjinore, znj. Kosovare Maroca Berisha, ka vazhduar aktivitetet ndërjegjësjesë për parandalimin e këtij fenomeni.

Sot, vizituan Stacionin Policor të Kamenicës, ku u priën nga komandanti z. Basi Shkodra, si dhe bashkëpunëtorët e tij znj. Mirsije Kastrati nga Sektori i Dhunës në Familje dhe znj. Edona Godanci Demolli, zyrtare policore e Krimteknikës – Forenzikës. Komandanti i Stacionit Policor, z. Shkodra, shprehu gatishmërinë e vazhdueshme të policisë për të mbështetur nismat e tilla, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në të mirë të qytetarëve.

Gjithashtu, në ambientet e Stacionit Policor të Kamenicës janë vendosur postera informues kundër trafikimit me qenie njerëzore, me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për parandalimin e këtij fenomeni.

Muaji Rozë – Art, vetëdije dhe solidaritet në QKMF në Kamenicë- Ekspozitë e organizuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Shaban Geci” në Kamenicë, në kuadër të Muajit Rozë – muajit të ndërgjegjësimi për parandalimin e kancerit të gjirit.

Ekspozita u realizua nga nxënëset e “International School of Prishtina”, nën udhëheqjen e profesoreshës së artit figurativ Merita Sijarina Ismajli, në bashkëpunim me Sherifë Veseli Berisha (BSc në infermeri) nga Kamenica. Njëpënjtj punimeve artistike, vajzat përcollën mesazhe të fuqishme dashurie, shprese dhe guximi për të gjitha gratë që përballen me sfidën e kancerit të gjirit. Ky aktivitet kishte për qëllim të trisë vetëdijen e grave dhe vajzave për rëndësinë e kontroleve të rregullta mjekësore, si dhe të promovojë mbështetjen, kujdesin dhe solidaritetin në komunitet. Në ekspozitë morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme komunale, stafi shëndetësor, ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës, si dhe gra të mbijetuara nga kanceri i gjirit, të cilat ndanë përvoja të tyre frymëzuese.

Gratë e komuniteteve në fokus të “Tetorit Rozë” në Kamenicë- Në kuadër të Zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e Komuniteteve Rome dhe Ashkali (2022–2026) dhe për shënimin e Tetorit Rozë, në Komunën e Kamenicës u mbajt një ligjëratë vetëdijësuese për gratë e komunitetit rom. Ligjëratën e organizuan Koordinatorja e NJKDNJ-së, Nazmije Demolli Kastirati, së bashku me Zyratën për Barazi Gjimore, Kosovare Maroca Berisha, me mbështetjen e OSBE-së, përfaqësuar nga znj. Vjosa Emiri. Një numër i konsiderueshëm i grave morën pjesë, duke treguar interesim të veçantë dhe duke ndarë përvoja mbi kujdesin shëndetësor.

Me profesionalizëm dhe përkushtim, Dr. Euna Hoda ua përcoll informacionet në mënyrë të thjeshtësuar dhe të kuptueshme, ndërsa Infermierja Sherifë Veseli i informoi pjesëmarrësit se manografia ofrohet në QKMF të Kamenicës dhe se çdo grua mbi 40-vjeç duhet të kryejë kontrollin, pasi kujdesi i hershëm është kyç për shëndetin.

Vazhdon Fushata Ndërgjegjëse për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore-

Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Koordinatorja e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut pranë DPA-së në Kamenicë, bashkë me Zyrtaren për Barazi Gjimore, dhe në bashkëpunim me DKA-në, zhvilluan një sesion informues me nxënës të shkollës fillore “Dëshmorët e Kombit” në Kamenicë. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Psikologu i shkollës, z. Fitim Bucolli, i cili kontribuoi me perspektivën profesionale mbi rëndësinë e edukimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga mezigjet e trafikimit. Zyrtarja për Barazi Gjimore nga ana e saj, foli për rëndësinë e barazisë gjimore si një komponent kyç në parandalimin e formave të ndryshme të dhunës dhe shfrytëzimit.

Takim informues për sesione trajnimi për mësimmdhënësit dhe nxënësit në Komunën e Kamenicës- U mbajti takim informues i organizuar nga Zyra për Barazi Gjimore, në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjimore (ABGI) dhe SIT – Qendrën për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime.

Takimi kishte për qëllim prezantimin e programit dhe planit të trajnimeve me mësimmdhënësit dhe nxënësit, si pjesë e projektit “Empowering youth and educators to build inclusive, nonviolent school communities through peace education and peer-led action”, të mbështetur nga UNFPA. Në takim morën pjesë përfaqësues nga organizata SIT, Koordinatorja e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut, znj. Nazmiye Demoli Kastrioti, Zyrtarja për Barazi Gjimore e Komunës së Kamenicës, znj. Kosovare Maroca, drejtoresha e shkollës, znj. Mirete Hoxha. Në kuadër të këtij projekti do të zhvillohen një sërë trajnimesh në katër shkolla publike të tri komunave multietnike të Kosovës – duke përfshirë edhe komunën e Kamenicës. Qëllimi i trajnimeve është të fuqizohen nxënësit dhe mësimmdhënësit për të ndërtuar mjedise shkollore gjithëpërfshirëse, të sigurt dhe pa dhunë, përmes metodologjisë së Y-Peer dhe edukimit për paqe.



Trajnimet do të fokusohen në:

- zhvillimin e aftësive të nxënësve për empati, bashkëpunimin dhe zgjidhje paqësore të konflikteve;
- nxitjen e reagimit të përgjegjshëm ndaj bullizmit, diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes;
- forcimin e rolit të mësimeve në krijimin e një klime të sigurt dhe gjithëpërfshirëse në shkollë;
- zbatimin e punësive “bashkëmoshatarë për bashkëmoshatarë”, ku nxënësit e trajnuar do të zhvillojnë aktivitete praktike me fokus në lidership pozitiv dhe përfshirje sociale.

Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt promovimit të paqes, dialogut dhe respektit në mjediset shkollore, duke forcuar rolin e arsimit në ndërtimin e komuniteteve më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Zyrtaria për Kuvend

Gjatë periudhës raportuese për muajt **Korrik- Nëntor 2025**, si Zyrtare e Kuvendit Komunal në kuadër të **Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme**, kam realizuar një sërë detyrash dhe obligimesh të cilat ndërliken me organizimin dhe mbarevajtjen e punës së Kuvendit, si në vijim:

- Përgatitja dhe sistemi i materialeve për mbledhjet e Kuvendit të Komunes;
- Shpërndarjen e ftesës, rendin e ditës dhe materialin përcjellës tek Asambleja komunale,

- Hartimi dhe protokollimi i dokumenteve që rrjedhin nga Kuvendi Komunal,
- Përgatitja dhe sistemimi i procesverbalit të mbledhjes sipas procedurave zyrtare,
- Përpilimin dhe sistemimin e vendimeve të miratuara gjatë mbledhjes,
- Nënshkrimin dhe protokollimin e akteve sipas procedurës ligjore,
- Dërgimin e akteve të miratuara në MAPL, në afatet ligjore të parapara, për shqyrtim-verifikim të ligjshmërisë.

Zyrtari i TI-së ka kryer punët dhe detyrat si vijojnë:

- Montimi, Formatimi, Instalime, Rregullime dhe intervenime të kompjuterëve 46 raste,
- Rregullime, intervenime në rrjetin qeveritar dhe lokal; 8 intervenime,
- Intervenime në rrjetin VPN, Hogosht, Muqiverc dhe eKiosk; 5 intervenime,
- Hapja, rregullimi, rritja e kapacitetit dhe resetimi i passëordit të e-mail zyrtar; 68 email,
- Instalimi dhe rregullimi i printerëve, Fotokopje dhe Skaner; 34 raste
- Montimi, instalimi ndërtimi i emrit në telefon VoIP; 14
- Pjesëmarrje në hapje të tenderëve; 9 raste

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

AKTIVITETET I PARAPARË	REZULTATET E ARRITURA	KOHA E FILLIMIT	A ËSHTË MBYLLUR AKTIVITETI?	PERSONI/AT PËRGJEGJËS	MBËSHTETJA E NEVOJITUR
Mbikëqyrja e punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe bashkëpunimi me njësinë	- Takime të rregullta pune me menaxhmentin e QKMF-së dhe akterët e tjerë relevantë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase në kujdesin parësor-shëndetësor për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës pa dallim, përkatësisht, realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së; - Urdhëresë për Menaxhmentin e QKMF-së, për respektimin e orarit të punës nga stafi, njoftimin zyrtar nga personeli lidhur me kërkesat për trajnimet apo edukimin e vazhdueshëm profesional, si dhe planifikimin e pushimeve vjetore, në funksion të përmbushjes së Rekomandimeve të Inspektoratit Shëndetësor në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh).	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2. Dr. Latif Sylaj 3. Këshilli Drejtues i QKMF-së	Bashkëpunimi ndër-kolegial
Mbikëqyrja e Qendrës për Punë Sociale dhe	- Takime të rregullta pune me Drejtorin e QPS-së, Udhëheqësen e Shërbimeve Sociale dhe Udhëheqësin e Asistencës Sociale, në më qëllim	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2. Rifat Hajdari	Bashkëpunimi ndër-kolegial

bashkëpunimi me njësinë	të ofrimit të shërbimeve efikase sociale, familjare dhe të asistencës sociale, në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Kamenicës, rrijedhimisht realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së.				
Mblikëqyrja e Shtëpisë së Komunitetit në Kamenicë dhe bashkëpunimi me njësinë	- Takime të rregullta pune me Udhëheqësin e ShKK-së, në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase rezidenciale, për personat me aftësi të kufizuar mendore – ngecje në zhvillim mendor, sipas kërkesave të parashtruara nga organet përkatëse. - Takime pune në kuadër të Panelit për Strehim Rezidencial në nivel lokal, me qëllim të shqyrtimit dhe vendosjes në Kërkesat e parashtruar nga QPS-Kamenicë dhe QPS-Gjilan, si dhe hartimi i Pëlqimeve nga ky Panel, me qëllim të vazhdimit të qëndrimit të klientëve-rezidentëve në ShKK.	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2. Hajdin Krivaga 3. Paneli për Strehim Rezidencial në nivel lokal	Bashkëpunimi nëndër-institucional
Bashkëpunimi me Zyrën e Kryetarit, Kuvendin Komunal dhe Drejtoritë e tjera në kuadër të komunës	-Takime pune me Kryetarin e Komunës, Nënkyetarin e Komunës, Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerzore, Shefin e Kabinetit, Drejtorët e Drejtorive Komunale etj. - Parashitimi i Kërkesës Nr.21/2025 të datës 17.07.2025 pranë Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorisë së Financave për krijimin e Fondit Emergjent në QPS;	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2. Zyra e Kryetarit 3. Drejtorët e Drejtorive 4. MMPHI	Bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës, Njesisë e Auditimit të Brendshëm, MMPHI-në, si dhe aktorët e tjerë relevantë

	- Hartimi i Përgjigjes Nr.22/2025 të datës 02.09.2025 në Kërkesën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm të datës 06.08.2025; - Shqyrtimi, analizimi dhe koordinimi i aktiviteteve në funksion të Thirrjes për aplikim për nën-projektin “Rinovimi i njësisë ekzistuese të banimit social” në kuadër të projektit Banimi Social Adekuat; - Shqyrtimi, analizimi dhe koordinimi i aktiviteteve në funksion të Thirrjes për aplikim për nën-projektet “Rinovimi/Rindërtimi i shtëpive private për familjet e ceneshme” në kuadër të projektit të Banimit Social Adekuat; - Asistencë profesionale, teknike dhe administrative ndaj palëve për plotësimin e aplikacioneve për Renovimin apo Rindërtimin e shtëpive private për familjet e ceneshme”; - Pjesëmarrje në Punëtorinë e organizuar nga MAMPPI për implementimin e projektit të Banimit Social Adekuat, si dhe për deyrat dhe përgjegjësitë e Njësimit Implementues të Projektit				
--	--	--	--	--	--

Informata dhe sqarime për Aplikim për Ndihmë financiare	-Offimi i informatave për palë dhe asistencës për aplikim për ndihmë financiare, e cila ndahet nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve nga lëmi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, i cili vepron pranë ZKA-së.	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2. Stafi i DShMS-së	Bashkëpunimi me stafin e DShMS-së
Investime kapitale	- Invertarizimi i Ambulantës së Mjekësisë Familjare në fshatin Shipashnicë të Epërme, Busavatë dhe Topanicë; - Invertarizimi i Kuzhinës Popullore - Sigurimi i një (1) Autoambulance	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2. Donatori Ahmet ul KUËARI - Kuvajti 3. Shogata “Jetimat e Ballkanit”	Bashkëpunim me stafin e DShMS-së, Zyren e Kryetarit dhe Donatorët
Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), AQH-në	- Implementimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2024 – Bashkë Pagesat për Shërbimet Shëndetësore, si dhe informimi i Administratës së QKMF-së për Udhëzimin në fjalë; - Pranimi dhe shqyrtimi i Raportit Nr.05-1686 të datës 26.09.2025 të Inspektimit sipas parashitresës në QKMF “Dr.Shaban Geci” në Kamenicë nga Inspektorati Shëndetësor në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, me theks të veçantë shqyrtimi i Rekomandimeve; - Hartimi i Raportit Nr.23/2025 mbi Rekomandimet e Inspektoratit Shëndetësor,	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi 2.Latif Sylaj 3.Inspektorati Shëndetësor/MSh	Bashkëpunim ndër-kolegjal dhe ndër-institucional

	sipas Referencës Nr.05-1686 të datës 26.09.2025.			
Bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve (MFPT)	-Kordinimi dhe bashkëpunimi i rregullt i njësive të DShMS-së me MFPT-në; - Mblidhjet e implementimit të pilotimit të skemës sociale sipas ligjit të ri, përmes sistemit elektronik e-Kosova; - Shqyrtimi i e-mailit – Letrës Qarkore nga z.Blerim Shabani, Udhëheqës në Departamentin për Politika Sociale dhe familjare, me qëllim të krijimit të Fondit Emergjent për nevojat e viktimave të dhunës në familje	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi
				Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional
Realizimi i kontrollave sistematike për nxënës në shkollat e Komunës së Kamenicës	- Shpërndarja e 193 pakove higjienike në shkollën “Skënderbeu” në Hogosht, si dhe paralelen e ndarë në Kopernicë, si vazhdimësi e projektit “Realizimi i kontrollave sistematike të nxënësve në shkollat e Komunës së Kamenicës”;	Korrik-Dhjetor		1. Valmire Maliqi 2. Latif Sylaj
				Bashkëpunim ndër-kolegial
Ushtrimi i kompetencave dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e vecanta, Statuti i	Në koordinim me stafin e DShMS-së, në mënyrë kontinuele i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në kuadrin e kompetencave tona, në funksion të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi në realizimin e misionit dhe objektivave të	Korrik-Dhjetor	/	1. Valmire Maliqi
				Bashkëpunim me stafin e DShMS-së dhe Udhëheqësit e Njësive të DShMS-së

Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror	Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Hartimi i akteve juridike të cilat dalin nga fushëveprimtaria e drejtorisë në bazë të procedurave të përcaktuara dhe sipas legjislacionit në fuqi, e të cilat janë si në vijim: 1. Planifikimi i stafit; 2. Hartime të vendimeve; 3. Shqyrtimi i kërkesave; 4. Formimi i Komisioneve; 5. Iniciimi i procedurave të ndryshme; 6. Adiministrimi dhe përpunimi i lëndëve për pranimin e donacioneve; 7. Hartimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit; 8. Implementimi i Rekomandimeve nga Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorës Kombëtare kundër Dhunës në Familje, e cila i është drejtuar Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës; 8. Krijimi i Databazës së të dhënave nga Kontrollat sistematike të viti të kaluar dhe përditësimi me të dhënat të cilat do të administrojnë nga ky projekt;				
Aktivitetet tjera	- Planifikimi, hartimi dhe koordinimi i Agjendës Ditore dhe Muajore për muajin Tetor, i njohur si “Muaji rozë”, - Muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit.	Kortik-Dhjetor	Po	1. Valmire Maliqi 2. Staffi i DshMS-së	Bashkëpunimi ndër-institucional

	- Koordinimi dhe organizimi i Ligjeratës sensibilizuese për kancerin e gjirit, në kuadër të muajit Tetor – Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit; - Organizimi i aktivitetit tjetër në kuadër të muajit Tetor – Dhurimi i gjakut, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e gjakut; - Organizimi i aktivitetit të organizuar në sheshin e Kamenicës në bashkëpunim me AQH-në; - Pjesëmarrje në trajnime të tjera, punëtori dhe tryeza diskutimi me qëllim të ngritjes profesionale. - Koordinim i vazhdueshëm edhe Udhëheqësit e njësisë të DShMS-së dhe Zyrtarë Financiare në DShMS, për hartimin dhe procedimin e kërkesave financiare të cilat janë në korrelacion me DShMS-në dhe njësitë e saj.				
--	--	--	--	--	--

DSHMJS						
Plani Buxhetit total për vitin 2025						
Nr.	Drejtoria QPS	Viti 2024 Buxheti	Viti 2025 Vlerësuar	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar	
1	Paga dhe Meditje		34,809.52	36,925.00	38,955.88	
2	Malira dhe shërbime		45,000.00	40,000.00	40,000.00	
3	Shpenzime komunale					
4	Subvencione dhe transfere					
5	Shpenzime kapitale					
	Totali		0.00	79,809.52	76,925.00	78,955.88

Draft Plani Buxhetit për vitin 2025 në bazë të Planit Kontabël (kategorive dhe kodeve ekonomike)				
Nr.	2025		Data	Kodi i programit
	DSHMS		21.05.2025	73038
	Mallra dhe Shërbime		45,000.00 €	
			Planifikuar	
1	Para xhepi/meditjet udh. zyrtare jashtë vendit		500.00	
2	Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jashtë vendit		500.00	
3	Shërbimet e ndryshme shëndetësore		500.00	
4	Shërbime kontraktuese tjera		2,000.00	
5	Shërbimet teknike		10,000.00	
6	Komputera (më pak se 1000€)		500.00	
7	Furnizimet për zyre		1,000.00	
8	Furnizimet mjekësore		30,000.00	
Totali			45,000.00 €	

Furnizime - Zotime

Nr	2025	Data	Kodi i programit	Zotuar	Hidroing - Epoksit Lori Group - Pelet ARF - broshura ARF - Stukersa Barna per pensionist	45,000.00	Vlera	Mbeteja Z.		
									Shpenzuar	€
	DSHMS									
	Malra dhe Sherbime									
2	Mirmbajtja e ndertesave	19.02.2025	1,680.00			669.90	11.04.2025	1,010.10		
3	Drut dhe prodhimet e drurit	20.03.2025	2,598.00			2,598.00	21.03.2025	0.00		
4	Sherbimet e shtypjes botimi	12.05.2025	500.00			500.00	23.05.2025	0.00		
5	Sherbimet e shtypjes botimi	12.05.2025	70.00			70.00	23.05.2025	0.00		
6	Furnizimet mjekesore	22.05.2025	30,000.00			22,560.40	28.10.2025	7,439.60		
7	Sherbimet e shtypjes botimi	15.07.2025	45.00		ARF - Mirenjoltje	45.00	18.07.2025	0.00		
8								0.00		
9								0.00		
10								0.00		
11	Vendime gjyqesore	13.05.2025	7,000.00			7,000.00		0.00		
12	Vendime gjyqesore	13.05.2025	849.49			849.49		0.00		
	Totali		42,742.49		0.00	34,292.79	0.00	8,449.70		
		TOTALI / MBETJA								
		2,257.51								

DSHMS		Zotuar		€	Shpenzuar	€	Mbeteja
Te hyrat vetanake							
2	Ndertesat administrative	28.04.2025	17,381.00	Kuzhina Popullore - Jemiat e Ballkanit	17,381.00	05.05.2025	0.00
3	Ndertesat administrative	20.05.2025	20,000.00	Kuzhina Popullore - Jemiat e Ballkanit	20,000.00	22.05.2025	0.00
4							0.00
5							0.00

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Kamenicë me njësitë përbërëse të saj në periudhën Janar-Nëntor 2025 ka kryer veprimtarinë saj, që përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që kemi si institucion i nivelit parësor shëndetësor.

- Më 03.09.2025 është mbajtur takim me AQH, në QKMF Gjilan, ku temë diskutimi ishte shkëmbimi i përvojave me komunat e reja që kanë hyrë në fazën e partneritetit me AQH lidhur me SMC-në.
- Më 03.09.2025 është mbajtur takim me drejtoreshën e DSHMS-së znj. Valmire Maliqi e cila u njoftua me orarin dhe punën që ofrojnë QKMF, QMF-te dhe AMF-të e komunës sonë.
- Më 22.09.2025 vizitë në QKMF Prishtinë si dhe takim me Dr. Bajram Maxhunin nga AQH.
- Më 02.10.2025 në Hotel Emerald në Prishtinë kemi marrë pjesë në një punëtori tërëditore e organizuar nga AQH me temë: Plani vjetor dhe prioritetet në rifjen e cilësisë së shërbimeve në KPSH.

- Më 09.10.2025 është mbajtur karvani shëndetësor në sheshin e komunës së Kamenicës e organizuar nga OJQ Mundësia, e mbështetur nga AQH në bashkëpunim me QKMF, ku staf shëndetësor i QKMF-së kanë bërë shumë aktivitete si psh: matjen e tensionit arterial, glikeminë, si dhe është bërë edukim dhe promovim shëndetësor dhe janë dhënë broshura me përmbajtje edukative shëndetësore që ju kanë dhënë gjetarëve për t'u njohur me sëmundje kronike jo ngjitëse.
- Më 09.10.2025 në hotel Brezovica në Brezovicë është mbajtur punëtorja dy ditore, tema ke genë Kujdesi në grup për prindërim. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë Vezire Rexha dhe Nurije Llozani.
- Më datën 13-14.10.2025 është mbajtur një trajnim në qendren e zhvillimit të mjekësisë familjare në Prishinë, tema ishte: Shëndeti seksual dhe riprodhues i personave me aftësi të kufizuara. Në këtë trajnim morën pjesë Dr. Latif Sylaj dhe inf. Ferdeze Kastrioti.
- Më datën 15.10.2025 është mbajtur mbledhja e Këshillit Drejtues, ku temë diskutimi në këtë takim ishte: Raportimi i sëmundjeve ngjitëse si dhe raportimi i sëmundjeve kronike jo ngjitëse. Në këtë takim kishte ankesa edhe nga ana e mjekëve se sistemi nuk po funksionon siq duhet.
- Më datën 21.10.2025 është mbajtur një sesion informues për prezantimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, barazia gjinore si dhe të drejtat e gjetarëve, në këtë takim kanë marrë pjesë Dr. Latif Sylaj-drejtor, Dr. Ferid Beqiraj – kryeshf, Dr. Asllan Dërmaku-Koordinator për cilësi, Natije Ajvazi-kryeinfermiere dhe Ferdeze Kastrioti-Koordinatore për EVP.
- Më datën 23-24.10.2025 është mbajtur një punëtori e organizuar nga AMC, akisoni për nëna dhe fëmijë në koordinim me KPSH, temë diskutimi ishte Prindërimi, në këtë punëtori kanë marrë pjesë Vezire Rexha dhe Mevlide Thaqi.
- Më datën 24.10.2025 kanë marrë pjesë në kongresin vjetor të Nefrologjisë, e akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, tema: Sëmundjet kronike të veshkave dhe sëmundjet minerale koeke.
- Më 03.11.2025 është mbajtur një trajnim në Prishinë, tema ishte: Matja e kënaqshmërisë së pacientëve në tri nivelet e kujdesit shëndetësor, në këtë trajnim kanë marrë pjesë drejtori Dr. Latif Sylaj, koordinatori i cilësisë Dr. Asllan Dërmakur dhe zyrtari i TI-së Ahmet Ahmeti.

- Më 17-21.11.2025 në QKMF Gjilan është mbajë trajnim 5 ditor për infermieret, tema: Fuqizimi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë nga moshë 0-3 vjeç, në këtë trajnim kanë marrë pjesë 5 infermiere (Fatushë Berisha, Labinota Ramnabajë, Blertina Zyfliti, Xhevahire Kryeziu dhe Emine Mehmeti).
- Më 25.11.2025 kryinfermierja e QKMF-se ka marrë pjesë në një takim pune të grupit joformal të grave të Kamenicës, tema ishte: 16 ditë e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILIARE
GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
"Dr. Shaban Geci" KAMENICË

OKMF-KAMENICË Raport Statistikor i kontrollave shërb.shëndetsore për vitin 2025

№	Lloji i shërbimit	Mjekësia familjare	Urgjencia	Sherb. Pediat.	Punktet shëndet.sore	Vizitat shtëpiak 0-3-vjet	Sherb. Stomat.	Sherb.e Vaksin.	Mamografi	Gjinekoloqia	Uroloqia	Sherb. R.T.G	Sherb. Labor.	Klasa për nëna	Totali
1	Kontrollim mjekësor	37187	14828	8116	29027		3246	4018	4382	975	3575				105354
2	Sherbimet medical	39305	53317	5248	28932	1837	12722	14425	5858	1340	3946	6255	128918	314	302417
3	Vizita shtëpiak		1465		292										1757
4	Sherbimet shtëpiak		5912		1534										7446
Total		76492	75522	13364	59785	1837	15968	18443	10240	2315	7521	6255	128918	314	416974

Të ref. jasht OKMF
Të trajtuar serb
Të trajtuar rom
Të huaj

5048
2209
575
2

Kordinatores
 Setvete Isufi
 BSc.Nafije Aljazi

Drejtori i OKMF-së
 Dr.Lotif Syta

Rapporti mbi vizitat sipas departamenteve-sherbimeve per periudhen Vjetore-2025

**Institucioni Shendetesor:
Vendi-Kamenicë**

[illegible]

RAPORT STATISTIKOR I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NË QKMF-së QMF AMF-së vjetor:2025

Llojet e shërbimeve	M.Familja	Urgjenc	Pediatria	Punkti shënd	Vaksinatimi	V.Shërbime O-3yjet	Mamografi	Gjinekologji	Urologji	Lab-Kamioni	Lab-Rd	Lab-Hog	RTG-Kabineti	S.Kam	RTG-Stoma	S.Rog	S.Hog	Klasa Ekipa	nt	Totali
Kontrollim mjekësor	37188	14828	6066	29027	4018		4362	975	3575					2524		543	149			103255
Shërbimet medicinale	39306	53317	5248	28932	14425	1837	5858	1340	3946	75119	49251	4538	6255	8712	713	2134	813	314		302058
V.Shërbimet		744		292															721	1757
Shërbimet mjekësore		2246		1534															3666	7446
Totali	76494	71135	11314	59785	18443	1837	10220	2315	7521	75119	49251	4538	6255	11236	713	2677	962	314	4387	414516
Llojet e shërbimeve	Rogana	Hogoshi	Karagavë	Korelin	Topan	Shërbimet	Desiv	Mudive	Strezov	Koperr	Kallëvë	Turbë	Busave	Lisoc	Poll					Totali
Kontrollim mjekësor	26153	2874																		29027
Shërbimet medicinale	23418	5021		493																28932
Vizitat	288	4																		292
Shërbimet mjekësore	1480	57																		1537
Totali	51339	7956	0	493	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	59788
Nc	Mjekësia	Pediatra	Urgjenc	stomatia																
1.shërb	1652	61	387	152																
2.trom	290	84	164	37																
3.të huaj	2	0	0	0																
4.udhëzuar	3582	407	1241	8																

[illegible]

SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025, në Shërbimet Sociale janë pranuar gjithsej tregjindpesëdhjetë (353) kërkesa të reja, nga individ dhe institucione, të cilëve u janë ofruar shërbime profesionale nga ana e zyrtarëve të shërbimit social. Po ashtu përveç rasteve të reja të paraqitura, për shkak të natyrës së punës sociale, në shërbim keni punuar edhe me raste të vjetra të bartura nga periudha e kaluar, por edhe nga vitet tjera paraprake.

Më poshtë do të paraqesim në mënyrë tabelore të gjitha rastet e reja të paraqitura sipas kategorive:

Tabela nr.1.

Nr.ren	Kategoria e klientëve	Numri i rasteve të reja
1	Fëmijë pa kujdes prindëror	2
2	Fëmijë të keqtrajtuar	5
3	Të miturit në konflikt me ligjin	14
4	Fëmijët me sjellje asociale	8
5	Fëmijët me aftësi të kufizuara	1
6	Çrregullime të marrëdhënieve bashkëshortore	8
8	Rastet e dhunës në familje	23
9	Kërkesa për vërtetim për fëmijë shtetësie	92

10	Kërkesa për vërtetim për lënien e shtetësisë	6
11	Kërkesa për vërtetime për zotësi veprimi	180
12	Konstatime/Pëlqime	7
13	Të tjera	7
14	Total	353

Komente; Në krahasim me periudhën e kaluar (gjysma e parë e vitit) kemi ngritje të konsiderueshme të numrit të kërkesave (mbi 100 më shumë), ku numri më i madh i rasteve ka qenë nga kategoria administrative, vërtetimet.

Përveç rasteve të reja, nga shërbimi janë trajtuar edhe rastet e bartura nga vilet paraprahe nga të gjitha kategoritë ku në përgjithësi janë kryer këto shërbime:

- **Fëmijët pa kujdes prindëror.** Nga kjo kategori në këtë periudhë shërbime janë ofruar për gjashtëmbëdhjetë (16) fëmijë të vënë nën kujdestari, prej tyre dymbëdhjetë (12) janë të strehuar tek të afërmit e tyre, dy (2) fëmijë janë të vendosur në strehim familjar jashtë farefisit dhe për dy raste aplikohet vetëm kujdestaria.

*Fëmijët e strehuar tek të afërmit janë vizituar në familje dhe kemi pasur kontakte me kujdestarët e tyre ligjor, ku kemi përcjellë edhe vijimin e shkollimit si dhe kemi ndërhyrë në dy raste me probleme në vijimin e shkollës.

*Fëmijët e vendosur në familje strehuese janë vizituar në familje, kemi mbajtur kontakte të kohëpaskohshme me familjet edhe përmes telefonit për ta përcjellë gjendjen e tyre dhe për njërin rast i cili është me nevoja të veçanta, kemi aplikuar për subvencionim të familjes për nevojat e tij shëndetësore, ku nga komisioni përkatës jemi informuar se është aprovuar kërkesa por ende nuk janë ekzekutuar mjetet. Ky fëmijë është potencial për adoptim, është propozuar në disa familje jashtë vendit ku është refuzuar, tani së fundmi është kryer një

vlerësim i ri i gjendjes shëndetësore dhe kemi përgatit një Letër Qarkore për të gjitha QPS-të e Kosovës, me kërkesën nëse sa ndonjë familje të interesuar për adoptions.

Nga kategoria e fëmijëve pa kujdes prindëror, vlen të ceket se gjatë kësaj periudhe kemi pasur dy raste të reja, njëri prej tyre fëmijë i braktisur pas lindjes në spital, e tjetri i prindërve të penguar në kryerjen e detyrave prindërore. Që të dy fëmijët janë vënë nën kujdestari, i pari është vendosur në strehim familjar jashtë farefisit ndërsa i dyti tek farefisi i tij.

- **Te delikuenca e të miturve** gjatë kësaj periudhe kemi pranuar katërmbëdhjetë (14) raste të reja të të miturve në konflikt me ligjin, prej tyre tetë (8) të paraqitura nga prokuroria për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprave penale nga të miturit dhe gjashtë (6) nga gjykata për shkak të kryerjes së kundërvajtjeve, kryesisht në komunikacion.

Rastet e dyshuara për vepra penale janë vizituar në familje ku zyrtarët e shërbimit kanë kontaktuar me të miturit dhe prindërit e tyre me qëllim këshillimi dhe udhëzimi për përmirësim të sjelljeve. Po ashtu kemi asistuar edhe me rastin e intervistimit të tyre në stacionin policor.

Rastet që kanë kryer kundërvajtje po ashtu janë vizituar në familje ku janë këshilluar të miturit dhe familjet, dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme janë përgatit raportet hetuese sociale për gjykatë. Prej tyre shumica kanë qenë meshkuj, ndërsa tri femra, sipas grup moshave, njëmbëdhjetë raste kanë qenë të grup moshës 16-18 vjeç, ndërsa tri raste të grup moshës 14-16 vjeç, shumica shqiptar, vetëm një rom.

- Kemi pas tetë (8) raste të reja të **fëmijëve me sjellje asociale**, shumica e rasteve të raportuara nga policia për shkak se janë nën moshën e përgjegjësisë penale, e të cilët është dashur të intervistohen nga QPS. Po ashtu disa prej tyre kanë qenë të raportuar nga shkolla për shkak të problemeve sociale të shfaqura në ambientet shkollore si dhe mungesave të shumta dhe tendencës për braktisje të shkollimit fillor të obliguar.

Sipas gjimisë shumica kanë qenë djem, vetëm një vajzë, sipas nacionalitetit, që të gjithë shqiptar.

Që të gjithë këta fëmijë, janë vizituar nga shërbimi, kemi punuar me familjet e tyre me qëllim përmirësimi të sjelljeve të fëmijëve, kemi bashkëpunuar me shkollat dhe policinë dhe kemi përgatit raporte me shkrim për nevoja procedurale të policisë.

- Te kategoria e **fëmijëve me aftësi të kufizuara**, kemi pranuar vetëm një (1) kërkesa të re nga familja që kujdeset për fëmijën e tyre me aftësi të kufizuara.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është mbajtur një seancë e vlerësimit nga Komisioni Mjekësor i shkallës së parë, ku janë prezantuar dy (2) lëndë/kërkesa, prej tyre njëri është aprovuar, ndërsa tjetri ka mbetur me plotësim dokumentacioni për seancën e radhës.

Rasti i aprovuar, është regjistruar në bazë, është nxjerrë vendimi dhe është përfshirë në pagesë. Aktualisht në pagesë i kemi pesëdhjetepesë (55) raste aktive.

Gjatë kësaj periudhe, kemi pasur kontakte me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, raste aktive të bartura nga e kaluara, shumica e rasteve aktive janë vizituar në familje me qëllim përcjellje të gjendjes.

- Nga kategoria e **fëmijëve të keqtrajtuar** kemi punuar në pesë (5) raste, prej tyre, katër të ndodhura në rrethin familjar dhe një ngacnim jashtë familjes.

Të gjitha rastet janë vizituar, intervistuar dhe janë ofruar shërbime të nevojshme, ku edhe kemi përgatit raporte me shkrim për policinë dhe prokurorinë.

- Në kategorinë e **çrregullimeve bashkëshortore**, kemi pranuar tetë (8) raste të reja, gjatë kërkesa nga gjykata për ndërmarrje të verimeve të tentim pajtimi dhe dhënie të mendimit për besim të fëmijëve, një rast i raportuar nga QPS Fushë Kosovë dhe një rast i raportuar nga policia.

Rastet janë vizituar, intervistuar dhe këshilluar dhe janë përgatit mendimet për besim të fëmijëve në gjykatë.

Po ashtu kemi punuar edhe në raste tjera të bartura nga periudha e kaluar, ku kryesisht kemi prezantuar nëpër seanca gjyqësore, duke elaboruar mendimet e dërguara paraprakisht në gjykatë.

Vlen të ceket se nga rastet e trajtuara, dy prej tyre i kanë sanuar raportet bashkëshortore dhe kanë vazhduar jetën së bashku.

- Kemi punuar në njëzetetë (23) raste të reja të **dhunës në familje**, kryesisht janë raportuar nga policia, përmes raportit ditor të dhunës familjare. Që të gjitha rastet janë vizituar dhe këshilluar nga ana e shërbimit, janë vlerësuar nevojat e tyre dhe janë përgatit raporte me shkrim për policinë dhe prokurorinë.

Po ashtu në raste të caktuara, kemi marrë pjesë në seanca gjyqësore, ku kemi dhënë mendimin profesional, në procedurë sipas kërkesës për urdhër mbrojtje.

Prej të gjitha rasteve katërmëdhjetë viktima janë femra dhe nëntë meshkuj. Për nga nacionaliteti, njëzet raste janë shqiptar dhe tre rom.

- Në kategorinë e **kontakteve fëmijë prind** kemi punuar në dymbëdhjetë (12) raste, shumica raste të vjetra, të bartura nga perioda paraprake, ndërsa katër raste të reja rrjedhimisht nga rastet aktive të dhunës dhe çrregullimit bashkëshortor.

Gjashtë raste i kanë mbajtur kontaktet në ambiente të QPS, të përcjellura me vështirësi të kohëpaskohshme, por kryesisht të tejkalueshme përmes intervenimit të zyrtarëve të shërbimit, të ngarkuar me menaxhim të rasteve.

Katër raste kontaktet i mbajnë jashtë QPS, gjatë vikendeve por pranimit dhe dorëzimi i fëmijëve bëhet përmes QPS.

Në dy raste kemi qenë vazhdimisht në proces të ndërmjetësimit mes palëve për të realizuar kontaktet e që mbahen jashtë QPS.

Në këtë kategori bashkëpunim kemi pasur me policinë dhe gjykatën, ku në raste të caktuara sipas nevojës, kemi prezantuar në seanca gjyqësore dhe kemi dhënë mendime profesionale lidhur me procesin e kontaktimit.

- Në kategorinë **personave me retardime mendore** kemi vizituar klientët tanë që ndodhen të strehuar në Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Afësi të Kufizuara në Kamericë, si dhe klientët që kemi të strehuar në Institutin Special në Shitumë, ku jemi njoftuar me gjendjen e tyre të përgjithshme. Për të gjitha këto raste, kemi paraqit propozime për vazhdim qëndrimi në strehim rezidencial në Panelin për Strehim Rezidencial në nivel lokal dhe në Panelin për Strehim Rezidencial në nivel qendror. Pas marrjes së Pëlqimeve nga Panelet e cekura më lartë, kemi sjell vendimet për vazhdim qëndrimi dhe marrëveshjet me institucionet rezidenciale.

- Lidhur me një rast i cili si i minur është strehuar në ISSH, pas arritjes së moshës madhore të tij, kemi iniciuar procedurën për heqje të zotësisë së veprimit në gjykatë, ku janë kryer të gjitha aktivitetet procedurale sipas kompetencës së Organit të Kujdestarisë.

- Në kategorinë e personave me **sëmundje mendore**, kemi punuar në disa raste, kryesisht të vjetra të bartura nga perioda paraprake, e të cilëve u janë ofruar shërbime varësisht nga nevoja.

- Në kategorinë e **personave të moshuar**, kemi bashkëpunuar me zyrtar të SHPMPF, ku kemi përcjellë gjendjen e rezidentëve tonë të strehuar në këtë institucion. Edhe nga kjo kategori janë kryer të gjitha procedurat me qëllim vazhdimi të strehimit rezidencial përmes paraqitjes së propozimit për Panel, marrjes së Pëlqimit, nxjerrjes së vendimit dhe përgatitjes së marrëveshjes.

Kemi ofruar shërbime edhe për klient të tjerë sipas nevojës e që jetojnë në shtëpi të tyre. Janë vizituar me qëllim përcjelljeje të gjendjes dhe janë ofruar shërbime si referime në institucione publike apo OJQ.

- Kemi lëshuar katër (4) **Konstatime Zyrtare** me kërkesë të palëve kryesisht për rregullim dokumentacioni jashtë vendit, me qëllim bashkimi familjar të personave të moshuar me familjar/bijtë në diasporë.
- Kemi lëshuar tre(3) **Pëlqime** për pajisje me pasaportë dhe udhëtim jashtë vendit për fëmijë të prindërve të ndarë/shkurorëzuar.
- Shërbime kemi ofruar edhe për raste të tjera, me kërkesë të palëve si; Dhënie e informacioneve lidhur me procedurën e adoptimit, shërbime për nëna vetushqyese, nënë e cila potencialisht do ta braktiste fëmijën, leje për igruesim të pronës së fëmijëve, pjesëmarrje në procedurë gjyqësore për kontaktim të faktit të vdekjes, etj.
- Shërbimi ka kryer edhe punë administrative; dhënie të vërtetimeve me kërkesë të klientëve, ku gjithsej janë lëshuar dyqindeshtatëdhjetetë (278) **vërtetime**, nëntëdhjetedy (92) për fitim shtetësie, gjashtë (6) për lirim nga shtetësia dhe njëqindetëdhjetë (180) për posedim të zotësisë së veprimit.
- Shërbimi ka administruar të dhënat në bazat e të dhënave, si; Baza e të Dhënave për Shërbime Sociale, Baza e të Dhënave për Fëmijët me Nevoja të Veçanta, Baza e të Dhënave për Fëmijët në Strehim Familjar dhe Baza e të Dhënave për Viktimat e Dhunës në Familje, ku janë regjistruar me kohë rastet, intervenimet dhe janë dërguar me kohë të dhënat në DSHSMF/MD, për administrim të pagesave dhe përcjellje të dukurive të shprehura në komunën tonë.

- Kemi mbajtur lidhje të rregullta me DPSHSF/MD-në duke dërguar, regjistrat e pagesave për fëmijët që ndodhen në strehim tek të afërmit si dhe regjistrat për Panel për fëmijët potencial për strehim e adoptim dhe familjet potenciale strehuese e adoptuese në komunën tonë.
- Pjesëmarrje në takime të rregullta të Panelit për Adoptime në kuadër të Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare/Ministria e Drejtësisë.
- Pjesëmarrje në grupe punuese e komisione komunale si: Komisioni për ndarje të subvencioneve në lëmin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komisioni për ndarje të subvencioneve për të porsalindurit, Komisioni për monitorim të projekteve të bizneseve dhe OJQ-ve, që kanë përfituar grante dhe subvencione nga komuna, Komisioni për matje të performances komunale, Komisioni për arkivim të lëndëve, Komisionet për rekrutim të shërbësve civil, Komisioni për inventarizim të aseteve komunale , etj.
- Janë kryer punë administrative, si pranim i kërkesave, caktim i menaxherëve dhe ndihmësve të rastit për secilin rast të pranuar, kompletimi i lëndëve me forma profesionale të punës, evidentim nëpër regjistrat etj.
- Organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve në terren dhe pjesëmarrje në terren, qoftë si menaxher rasti, apo si ndihmës i kolegeve.
- Organizim (pjesëmarrje) i takimeve dhe mbledhjeve të rregullta mujore të sektorit.
- Punë e vazhdueshme me palë, ku janë dhënë këshilla dhe udhëzime varësisht nga nevojat dhe problematika e shfaqur. Janë asistuar të njëjtit me rastin e hapjes së profilit në platformën elektronike e-Kosova, ku ju kemi ndihmuar për të aplikuar për shtesa për fëmijë, për pagesat për lehona , për aplikim për subvencionim të mrymës, aplikim për furnizim me libra dhe material shkollorë, etj.
- Pjesëmarrje në takime, trajnime e punëtori, të organizuara nga shoqata dhe institucione të nivelit qendror dhe lokal.
- Kemi mbajtur kujdesarinë pasive njëzetekatër orëshe ku i jemi përgjigjur thirrjeve të policisë pas orarit të rregullt të punës.
- Kemi përgatitur me kohë raportet javore, mujore dhe periodike dhe planet mujore të punës të cilat janë dorëzuar tek udhëheqësi i drejtpërdrejtë.

- Kemi bashkëpunuar me institucionet tjera si me policinë, gjykatat, prokurorinë/ZMNV-në, Shërbimin Sprovues, Institucionin e Avokatit të Popullit, QPS-të homologe , QKMF-në, shkollat, QSHM-në, OJQ dhe institucionet tjera komunale

SEKTORI I NDIHMAVE SOCIALE

Në Shërbimin e Sektorit të Ndlhmave Sociale në QPS-së Kamenicë, punojnë 2 zyrtarë të Asistencës Sociale dhe Udhëheqsi i ShSNS. Në këtë shërbim punët dhe shërbimet për shfrytëzuesite ndihmës sociale kryhen konform Ligjit mbi Skemën e ndihmës sociale 2003/15, Rregulloren implementuese të këtij ligji, Ligjin nr.04/L-096 për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit 2003/15 për SNS , Udhëzimeve dhe Urdhëresave Administrative të nxjerra nga MPMS respektivisht DPSF-ja. Gjithashtu dhe Pilot Projekti i SAS-it të ri Ligji për ndihma sociale për vitin 2024 sipas udhëzimeve të MFPT. Për të parë dhe analizuar punën e SHSNS dhe për të dhënë komente duhet ti parqesim në mënyrë tabelare shenimet:

 Numri i kërkesave të reja dhe të ripërsëritura.

Muajt e Vitit2025	Kërkesat e reja		Ripërsëritje- Riaktivizim		Të pranuar		Të refuzuar		Komente Shtesë
	Kategoria		Kategoria		Kategoria		Kategoria		
	I	II	I	II	I	II	I	II	
Janar									

Shkurt									
Mars									
Prill									
Maj									
Qershor									
Korrik	1	1	1	1	1	1	14 KM	1	
Gusht	1	0	0	1	0	0	8 KM	0	
Shtator	0	0	1	0	0	0	6 KM	0	
Tetor	1	0	3	0	0	0	18 KM	0	
Nëntor	3	0	2	1	0	0	17 KM	0	
Dhjetor	0	0	0	0	0	0	0	0	
Gjithësejt	6	1	7	3	1	1	63	1	

Km – komisioni mjekësor (shkurtesat)

☐ Numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale dhe shuma e pageses.

Muajt e vitit 2025	Nr.familjeve	Antarët familjes	Pagesa Mjatore	Komente shitesë
Janar				
Shkurt				

Mars				
Prill				
Maj				
Qershor				
Korrik	280	990	32.610 Euro	
Gusht	277	979	32.260 Euro	
Shtator	271	959	31.610Euro	
Tetor	276	973	38.628Euro	
Nëntor	274	973	38.352 Euro	
Dhjetor				
Gjithësejt				

☑ Nderprerja e ndihmave Sociale si dhe lendet që kanë qenë në komision mjekësor për këtë periudë.

Muajt e	Nderprerja e ndihmës sociale		Lëndët në Komision mjekësor në Gjilan	Komente shtesë
	Kategoria			
	Kategoria I			

Viti 2025	I-rë	II-të		poz	neg	rishqyr	
Janar						0	
Shkurt						0	
Mars						0	
Prill						0	
Maj						0	
Qershor						0	
Korrik	2	3		14		0	
Gusht		1		8		0	
Shtator	2	3		6		0	
Tetor	1	2		18		0	
Nëntor	2	1		17		0	
Dhjetor						0	
Gjithësejt	7	10		63		0	

Shkurtesat : ATK – Agjensioni Tatimor i Kosovës, K M –Komisioni mjekësor

Ushtrimi i ankesave në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë Komisioni i ankesave pranë DMS-së.

Muajt e Vitit 2025	Ankesat në shkallë I-rë USNS-së		Sa janë aprovuar		Sa janë refuzuar		Ankesat në shkallë II-të	
	kategoria		kategoria		kategoria		kategoria	
	I	II	I	II	I	II	I	II
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0
	Riaplikimi i kryer me kohë				Komente shitesë			
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0
	Kategoria e gjerë							
Mars	0	0	0	0	0	0	0	0
Muajt e vitit 2025								
Prill	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	0	0	0	0	0	0	0	0
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	0	0	0	0	0	0	0	0
Gusht	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtator	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	0	0	0	0	0	0	0	0
Tetor	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	0	0	0	0	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0	0	0	0	0
Gusht	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithësej	0	0	0	0	0	0	0	0

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur Ankesa të paraqitura në shkallën e dytë.

☒ Riaplikimi i kryer me dokumente të nevojshme.

Shtator	21 familje	11/1 dhe 9/2
Tetor	23 familje	11/1 dhe 12/2
Nëntor	39 familje	23/1 dhe 16/2
Dhjetor		
Gjithësejt	144 familje	144 lëndë/ familje

Nëse u referohemi tabelave të sipërshtuara shihet se po zvogëlohet numri i familjeve në ndihmë sociale dhe kreu kjo është si rezultat i kriterëve për ndihmë sociale të Ligjit në fuqi dhe disa familje që kanë qenë në Asistencë Sociale kanë krijuar marrëdhënie pune duke krijuar gjendje më të mire ekonomike.

Ne synojmë që të identifikojmë familjet që nuk kanë informacion lidhur me mbështetjen sociale nga Republika e Kosovës që këto familje që kanë gjendjen e rëndë ekonomike të jenë përfutuese në Asistencë Sociale.

Numri i kërkesave do të ishte edhe më i lartë, por me rastin e njoftimit nga NNS për kushtet dhe kriteret egzistuese ligjore një pjesë e tyre bëjnë dorë dhe nuk aplikojnë.

Kemi edhe disa kërkesa të riperseritura nga ish shfrytëzuesit e ndihmave sociale kjo ka ardhur si rezultat i mos gjetjes së ndonjë zgjidhje tjetër për sigurimin e egzistencës së familjes dhe përmirësimit të gjendjes ekonomike familjare.

Riaplikimi kryhet me kohë dhe me dokumentacion të parapartë me ligj, kontrollonhet dokumentacioni nga ana e NNS si dhe nga USHSNS-së e pastaj futen shenimet në bazën e të dhënave.

Bashkëpunimi me Zyrtën Komunale të Punësimit për kategorinë e II-të të shfrytëzuesve të ndihmave sociale për çdo muaj lidhur me mundësinë e trajnimeve në QAP në Gjiilan për mundësitë e ofruara për aftësim profesional dhe për SAS Pilot.

Kërkesat për ndihma të njëhershme nuk kemi pasur për DNS-MFPT në Prishtinë përmes QPS-së.

Kthimi i mjeteve të ndihmave sociale sipas ATK-së nga aplikantët : 10 raste ku 6 raste kanë qenë të gjetura nga Raporti i Auditimit për periudhën 2024 dhe 4 raste për periudhën e raportimit dhe janë kthyer mjetet sipas procedurave Administrative të DNS- MFPT dhe 1 rast është në procedurë.

Kthimi i mjeteve të ndihmës sociale sipas Gjykatës Themelore dega në Kamenicë nuk kemi pasur raste të paraqitura për periudhën e raportit.

Kërkesa për Vërtetime:24 persona / familje.

Bashkëpunimi me ETC dhe përpilimi i listës, shpërndarja e pakeve ushqimore 20 familje në Asistencë Sociale .

Përpilimi i listës për familjet sociale për shpërndarjen e çantave shkollore me rasiin e fillimit të vitit shkollor 2025/2026 .

Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in , Puntori e mbajtur në: Prishtinë , Gjiilan .

Aplikimi në E-Kosova , ndihmë aplikantëve nga NNS: Ismaj Demaj , dhe NNS të tjerë

Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin Korrik 2025 përfutues janë 66 familje të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga stafi i SHSNS .

Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin Gusht 2025 përfutues janë 70 familje , të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga stafi i SHSNS .

Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin Shtator 2025 përfutues janë 82 familje, të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga stafi i SHSNS.

Pilot projekti i SAS-it – Ligji i ri për SAS-in për muajin Tetor 2025 përfutues janë 82 familje, të kontaktuara me telefon dhe të vizituara në teren nga stafi i SHSNS.

